



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 275 Akti

Nr. 275 Vendimi
Tiranë, më 20.7.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Brunilda Bekteshi	Relatore
Suela Zhegu	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, në datën 14.7.2020, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Enkeleda Osmani (Xhengo)**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, përfaqësuar personalisht.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj).

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka zhvilluar shortin në datën 15.3.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Brunilda Bekteshi dhe Alma Faskaj (Vokopola). Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.

4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 21.3.2019, të trupit gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Enkeleda Osmani (Xhengo), si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioner Roland Ilia. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

5. Në datën 18.4.2019, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, në datën 19.4.2019, deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit.

6. Në datën 6.11.2019 Komisioni me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), vetëm për kriterin e pasurisë; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe të paraqesë pretendimet brenda 12 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 7.11.2019, subjektit të rivlerësimit iu njoftuan rezultatet e hetimit, për të cilat konfirmoi në datën 11.11.2019 marrjen e provave mbi të cilat ishte kryer hetimi administrativ

dhe njëkohësisht kërkoi një afat shtyrje prej minimalisht 10 ditë për të depozituar shpjegimet dhe provat, me argumentin se dokumentacioni ishte voluminoz.

8. Në datën 12.11.2019, Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit se pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të pranojë kërkesën duke caktuar datën 25.11.2019, si afat të fundit për të dërguar shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ.

9. Subjekti i rivlerësimit në datën 25.11.2019, brenda afatit të përcaktuar nga Komisioni, depozitoi parashtrimet, kërkesën për riçelje të hetimit administrativ me qëllim vijimin e hetimit administrativ për kriterin e pasurisë, duke depozituar edhe prova shkresore, si dhe kryerjen e hetimit edhe për dy kriteret e tjera, përkatësisht, vlerësimin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Në kërkesën për riçelje, subjekti kërkoi edhe pyetjen e shtetasit A. N. me cilësinë e dëshmitarit, si punëdhënës i bashkëshortit, për një periudhë kohe të caktuar.

10. Komisioni, pas shqyrtimit të kërkesës së subjektit, si dhe njohjes me provat e depozituara, vendosi të pranojë kërkesën për rihapje të hetimit administrativ, të pranojë kërkesën për të pyetur shtetasin A. N. me cilësinë e dëshmitarit, si dhe të vijojë me hetime të mëtejshme mbi kriterin e rivlerësimit të parashikuara në nenin 4, të ligjit nr. 84/2016.

11. Trupi gjykues, pas analizimit të kërkesave të subjektit, me vendimin nr. 3, datë 3.12.2019, me anë të postës elektronike në datën 5.12.2019: (i) informoi subjektin, se ka administruar të gjithë dokumentacionin e paraqitur prej saj; (ii) referuar kërkesës për rihapjen e hetimit për vijimin e kriterit të pasurisë dhe për dy kriteret e tjera: kontrollin e figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, njoftoi subjektin mbi pranimin e saj; (iii) referuar kërkesës për të pyetur shtetasin A. N. me cilësinë e dëshmitarit, njoftoi subjektin mbi pranimin e saj dhe në vijim; (iii) informoi subjektin se do të njoftohej për rezultatet e hetimit administrativ pas riçeljes së hetimit.

12. Në datën 28.2.2020, Komisioni, me vendimin nr. 4, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ pas riçeljes, për të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin figurës; dhe vlerësimin e aftësive profesionale; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit; (iii) mbi paraqitjen e pretendimeve brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

13. Në zbatim të vendimit të sipërcituar, në datën 28.2.2020, subjektit të rivlerësimit iu njoftuan rezultatet e hetimit shtesë dhe në datën 6.3.2020 subjekti dërgoi prapësimet në mënyrë elektronike dhe zyrtare së bashku me dokumentacionin shoqërues mbështetës.

14. Komisioni në datën 9.3.2020, njoftoi subjektin e rivlerësimit se me vendimin nr. ***, datë 9.3.2020, vendosi rishortimin e anëtarit zëvendësues të trupit gjykues, znj. Alma Faskaj (Vokopola) për shkak se kishte njoftuar mungesën e saj për një kohë të gjatë për arsye shëndetësore dhe për pasojë u caktua komisionere Suela Zhegu e cila deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit. Në vijim, Komisioni i ka kërkuar subjektit të deklarojë mbi konfliktin e interesit lidhur me anëtarin e ri të shortuar të trupit gjykues. Subjekti, po në këtë datë, ka

njoftuar mospasjen e konfliktit të interesit me anëtarin zëvendësues, komisioneren Suela Zhegu.

15. Komisioni me vendimin nr. 5, datë 10.3.2020, ka vendosur rihapjen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), për shkak të ndryshimit të anëtarit të trupit gjykues, si dhe vendosjen në dispozicion të saj të rezultateve të hetimit administrativ dhe çdo dokumentacioni të dosjes anëtarit zëvendësues duke e bërë me dije edhe subjektin e rivlerësimit në këtë datë.

16. Më tej, në referim të njoftimit publik të Komisionit¹, në kuadër të përshkallëzimit të masave mbrojtëse nga Covid-19, në datën 19.3.2020, Komisioni pezulloi vijimin e aktivitetit të punës deri në një njoftim të dytë.

17. Në zbatim të Aktit Normativ nr. 21, miratuar nga Këshilli i Ministrave, datë 27.5.2020, i publikuar në fletoren zyrtare nr. 98, datë 29.5.2020, për disa ndryshime në Aktin Normativ nr. 9, datë 25.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë”, Komisioni rifilloi funksionimin e punës.

18. Në datën 6.7.2020, Komisioni, me vendimin nr. 6, vendosi: të përfundojë hetimin administrativ pas rihapjes për të tria kriteret e rivlerësimit, përkatësisht: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe të ftojë subjektin në seancë dëgjimore në datën 14.7.2020, ora 10:00.

II. SEANCA DËGJIMORE

19. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma. Subjekti i rivlerësimit ishte prezent në seancën dëgjimore, ku shpjegoi lidhur me rezultatet e hetimit dhe barrën e provës. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

20. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), dhe të ndërpresë seancën dëgjimore të datës 14.7.2020, për të rifilluar në datën 20.7.2020, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

21. Znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

¹Në kuadër të përshkallëzimit të masave mbrojtëse nga Covid-19, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton kufizimin e mëtejshëm të veprimtarisë institucionale dhe dërgimin e punonjësve në shtëpi deri në një njoftim të dytë zyrtar. Duke filluar nga data 13.3.2020, veprimtaria e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit do të vazhdojë të kryhet në ato funksione/detyra/njësi organizative që mund ta përmbushin në kushtet e banesës, nëpërmjet komunikimit elektronik dhe telefonik zyrtar. Gjithashtu, duke filluar nga data 13.3.2020, pezullohen afatet për të gjitha vendimet dhe seancat dëgjimore për subjektet e rivlerësimit të publikuara për t'u zhvilluar, do të shtyhen deri në një njoftim të dytë zyrtar.

IV. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

22. ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për dosjen nr. IND ***, me shkresën nr. *** prot., datë 21.2.2019, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personin e lidhur për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, sipas neneve 30 – 33, të ligjit nr. 84/2016, ku konstatohet:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- dokumentacion jo i plotë ligjor për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

23. Nga verifikimi i datës së dorëzimit të deklaratës së pasurisë *Vetting*, në zbatim të nenit 31/1, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 26.1.2017 (duke përfshirë personin e lidhur), në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, fakt ky që konfirmohet nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Për sa më sipër, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003.

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

24. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, deklaratimet e subjektit gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; (e) deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI; (ë) analizën financiare të bërë nga Njësia Ligjore e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Nga shqyrtimi i provave të administruara nga Komisioni, për secilën nga pasuritë dhe të ardhurat e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur rezulton, si vijon:

Mbi pasuritë e deklaruar në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2), të datës 26.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi ka rezultuar, si vijon:

1. Apartament banimi, Golem-Kavajë, me sipërfaqe 45.6 m². Blerë me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.4.2011, nga shtetasi A. N. (bashkëlidhur kontrata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.4.2011). Burimi i krijimit: kursime nga të ardhurat nga pagat. Vlera: 1.837.305 lekë. Pjesa takuese: 50 %. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente².

Faktet e konstatuara gjatë hetimit administrativ

1.1 Nga deklaratat periodike vjetore, Komisionit i ka rezultuar se kjo pasuri është deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 me përshkrimin – *apartament në Golem-Kavajë me sipërfaqe 45.6 m², në vlerën 1.837.305 lekë.*

1.2 Pasuria konfirmohet me kontratën e shitblerjes³ nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.4.2011, me palë shitëse A. N. dhe palë blerëse K. O. . Vlera e apartamentit është 1.837.305 lekë, shumë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

1.3 Agjencia Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Vendore Kavajë⁴ e konfirmon këtë pasuri të regjistruar në emër të shtetasit K. R. O., bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.

1.4 Subjekti deklaron si burim krijimi për këtë pasuri *kursime nga të ardhurat nga pagat.*

1.4.i Për subjektin e rivlerësimit, të ardhurat, konfirmohen nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

1.4.ii Bashkëshorti i subjektit, në bazë të deklarimeve periodike vjetore të bëra nga subjekti, rezulton se ka qenë i punësuar në shoqëri private. Për këto punësime subjekti ka depozituar vërtetime punësimi ose kontratat⁵ e punës.

1.4.iii Komisionit i ka rezultuar se subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore për vitin 2011 (kohë kur është blerë pasuria) se bashkëshorti ka qenë i punësuar pranë:

- “E. S.⁶ (përfaqësuar nga shtetasi E. M.), me të ardhura vjetore 1.200.000 lekë;
- E.-C.⁷ sh.p.k., me të ardhura vjetore 528.000 lekë.

1.5 Komisioni hetoi mbi marrëdhënien e punësimit të bashkëshortit në dy shoqëritë punëdhënëse, pasojë e të cilave ishte krijimi i të ardhurave të deklaruara si burim krijimi për këtë pasuri.

²Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.4.2011, nënshkruar ndërmjet palës shitëse A. N. dhe palës blerëse K. O. për blerje apartamenti me sip. 45.6 m² në Durrës, në vlerën 1.837.305 lekë. Shuma është likuiduar jashtë zyrës noteriale; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 11.6.2010, për pasurinë “apartament” me sipërfaqe totale 45.6 m², regjistruar me nr. ***, në pronësi të shtetasit A.N., shoqëruar me hartën treguese të regjistrimit të pasurisë, si dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 19.4.2011, për pasurinë e “apartament” me sipërfaqe totale 45.6 m², regjistruar me nr. ***, në pronësi të z. K. O., shoqëruar me hartën treguese të regjistrimit të pasurisë; vërtetim nr. *** rep., datë 13.10.2016, për njësimin me origjinalin të dokumentacionit të mësipërm (Aneks nr. 4/1, në dosjen e ILDKPKI-së).

³ Aneks nr. 4/1, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 13.6.2019.

⁵ Detajuar dhe argumentuar dokumentacioni në pikën 9 të rezultateve të hetimit.

⁶ Për këtë marrëdhënie punësimi subjekti nuk ka deklaruar marrëdhënie kontraktore në deklaratën periodike për vitin 2011.

⁷ Për këtë marrëdhënie punësimi, subjekti ka deklaruar kontratën e punës në deklaratën periodike të vitit 2011.

1.5.i Në lidhje me punësimin e bashkëshortit të subjektit në shoqërinë “E. – S. E. M.”, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte deklaruar në deklaratën *Vetting* se për vitet 2008 – 2012, kishte përfiturar nga kjo shoqëri, të ardhura në shumën 5.500.000 lekë.

1.5.i.a Për të provuar marrëdhënien e punësimit subjekti ka depozituar kontratë pune individuale të nënshkruar me këtë shoqëri.

1.5.i.b Komisioni vlerësoi të analizojë kontratën e punës në përputhje me legjislacionin e punës. Ndër të tjerë parashikime ligjore, bazuar në germën “h”, të pikës 3, të nenit 21, të Kodit të Punës, ku përcaktohen elementët që duhet të përmbajë një kontratë pune, u vërejt se në kontratë ishte parashikuar pagesa mujore në favor të punëmarrësit z. K. O., në shumën 100.000 lekë për kohë pune të pjesshme, si dhe ishte parashikuar koha e marrjes së saj, një herë në muaj në datën 5 të çdo muaji, por nuk ishte parashikuar mënyra e pagesës si një ndër elementët e tjerë përbërës të pagës (në referencë të nenit 118 të Kodit të Punës). Kontrata e punës ishte lidhur për një afat 10-vjeçar duke filluar zbatimin i saj për periudhën 2.8.2008 – 2.8.2018, por që në fakt, gjatë hetimit rezultoi se kontrata i kishte shtrirë efektet e saj për një periudhë 4-vjeçare. Në kontratë ishte parashikuar se pagimi i të gjithë detyrimeve tatimore ishte marrë përsipër nga punëdhënësi.

Subjekti për të provuar se për vitin 2011 është paguar me një tjetër pagë, për shkak të orëve shtesë nga koha normale e punës e parashikuar në kontratë, ka depozituar vërtetimin datë 5.12.2016 të nënshkruar për llogari të kësaj shoqërie, nga shtetasi E. M. .

Sipas këtij vërtetimi konfirmohet se z. K. O. ka punuar në këtë shoqëri me kohë të pjesshme për periudhën 1.8.2008 – 31.12.2012 me pagë në vlerën 100.000 lekë/muaj, ndërsa për periudhën janar 2011- dhjetor 2011 ka marrë pagesën vjetore prej 1.500.000 lekësh⁸, për efekt të orëve shtesë. Komisioni nga korrespondenca e mbajtur me bankat ka vërejtur se pagat nuk kishin kaluar nëpërmjet këtyre të fundit, apo me një nga mënyrat e parashikuara në nenin 118 të Kodit të Punës.

Sipas të dhënave nga ISSh-ja dhe verifikimit të bërë në dokumentacionin e depozituar, vërtetohet se bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. K. O., nuk i figuronte emri në listëpagesa. Gjithashtu, nga *aksesi* në QKB, kjo shoqëri figuronte me statusin “*pezulluar*”.

Komisioni hetoi mbi vërtetësinë e krijimit të këtyre të ardhurave, duke qenë se informacioni i pasqyruar në vërtetimet e punësimit nuk ishte i plotë. Komisioni iu drejtua ISSh-së për të konfirmuar punësimin në secilën shoqëri dhe tatimet e paguara për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit.

ISSh-ja, Drejtoria e Arkivit Qendror⁹ për punëdhënësin shoqërinë “E. S.”, me NIPT ***, ka informuar se: “*Për periudhat janar - qershor 2011, janar - qershor 2012, tetor - dhjetor 2012, nuk i figuron emri në listëpagesa. Për periudhën korrik - dhjetor 2011, korrik - shtator 2012, deri tani administrojmë të dhëna*”.

⁸Aneks nr. 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 12.9.2019.

1.5.ii Në lidhje me burimin tjetër të krijimit të të ardhurave nga punësimi i bashkëshortit dhe konkretisht me marrëdhënien e punësimit të tij në shoqërinë “E.C. G.” sh.p.k., Komisionit nga hetimi i rezultoi, si vijon:

Subjekti ka deklaruar se për vitet 2010 – 2011, ka përfituar nga shoqëria “E. C. G.” sh.p.k., të ardhura në shumën 576.000 lekë dhe për këtë ka depozituar kontratë pune nr. *** rep., nr. ***kol., datë 3.11.2010, me afat të caktuar, 5 vjet, duke filluar nga data 3.11.2010 deri më 2.11.2015.

Nga analiza e kontratës u vërejt se nuk ishte parashikuar paga në favor të punëmarrësit, ndërsa thuhej se: *“Palët kanë përcaktuar se paga mujore e punëmarrësit do të përcaktohet nga palët konformë ligjeve në fuqi”*, dhe se detyrimet tatimore ndaj shtetit do të përballohen sipas ligjeve në fuqi.

Sipas konfirmimit të bërë në vërtetimin e lëshuar nga administratori i kësaj shoqërie, shtetasja E. Gj., kontrata noteriale i kishte shtrirë efektet e saj për një periudhë një vjeçare nga nënshkrimi i saj. Në këtë vërtetim të depozituar nga subjekti, të nënshkruar dhe vulosur nga administratori i shoqërisë, konfirmohet se paga mujore në favor të punëmarrësit, për periudhën një vjeçare, ka qenë në shumën 50.000 lekë/muaj. Nga aksesi në QKB kjo shoqëri ka rezultuar me statusin *“aktiv”*.

Sipas të dhënave nga ISSh-ja Drejtoria Rajonale Shkodër¹⁰ dhe verifikimit të dokumentacionit të depozituar nga kjo e fundit, vërtetohet se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit z. K. O., figuronte i siguruar për periudhën dhjetor 2010 – korrik 2011, me pagë bruto 48.000 lekë, shumë e cila nuk përputhet me pagën e deklaruar në vërtetimin e shoqërisë prej 50.000 lekësh.

Sipas përlllogaritjeve, referuar legjislacionit të kohës¹¹, të ardhurat *neto* rezultojnë në shumën 302.592 lekë.

1.6 Në renditje dhe pasqyrim të fakteve të mësipërme, Komisioni kreu analizën¹² mbi mundësinë financiare të subjektit për të investuar në këtë pasuri duke u bazuar në të ardhurat e konfirmuara nga institucionet përkatëse.

1.7 Nga analiza financiare: (i) dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 1.603.951 lekë, sipas deklarimeve të kryera në deklaratat periodike vjetore, për të investuar në blerjen e kësaj pasurie; (ii) dukej se kishte mospërputhje të deklaramit të subjektit në vitin 2011, në lidhje me të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti, me dokumentacionin e lëshuar nga shoqëritë “E. S.” sh.p.k. dhe “E. C.” sh.p.k., ku kishte punuar me informacionin dhe dokumentacionin e depozituar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe, për pasojë, subjektit iu kalua barra e provës¹³ për të provuar të kundërtën.

¹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 14.10.2019.

¹¹ Ligji nr. 10070, datë 5.2.2009, dhe ligji nr. 9766, datë 9.7.2007.

¹² Shihni rezultatet e hetimit.

¹³ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafët 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

1.8 Për sa i përket mospërputhjes së konstatuar midis deklaramentit në vitin 2011, në lidhje me të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti me dokumentacionin e lëshuar nga subjektet tregtare “E.S.” sh.p.k., dhe “E. C.” sh.p.k., ku ka punuar me informacionin dhe dokumentacionin e depozituar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, si pasojë e të cilës ka rezultuar edhe balanca negative, subjekti në prapësime ka parashtruar se ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar të gjitha pasuritë sipas përcaktimeve të gërmës “a”, të pikës 1, të nenit 59 dhe se vlerësimi për dy kriteret, kontrollin e figurës dhe aftësitë profesionale çmohet i domosdoshëm për procesin e rivlerësimit dhe për pasojë ka kërkuar edhe riçeljen e hetimit. Për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të krijuara nga punësimi në shoqërinë “E. S.” sh.p.k., në shumën 5.000.000 lekë, subjekti ka shpjeguar se të ardhurat ishin nga kryerja e shërbimit të realizuar nga bashkëshorti i subjektit, në subjektin “E. M.”/Person Fizik me NIPT ***, si inxhinier projektues. Subjekti ka depozituar shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë me nr. *** prot., datë 11.11.2019, duke qartësuar se sipas kësaj shkrese rezulton se prej Personit Fizik “E.M.” me NIPT ***, është paguar tatim në burim për bashkëshortin e saj, z. K.O., përkatësisht:

- në vitin 2008 për detyrimin *principal* në shumën 22.000 lekë;
- në vitin 2009 detyrimi *principal* në shumën 126.035 lekë;
- në vitin 2010 detyrim *principal* në shumën 123.339 lekë;
- në vitin 2011 detyrim *principal* në shumën 165.090 lekë;
- në vitin 2012 detyrimi *principal* në shumën 132.943 lekë, që në total shoqëria E.M. me NIPT *** ka derdhur në total 569.607 lekë detyrime, në zërin tatim në burim për kontratë të lidhur me z. K. O. .

1.9 Në lidhje me shoqërinë “E. C.” sh.p.k., subjekti ka parashtruar se ka rënë në dijeni të faktit të mospagimit të detyrimeve tatimore dhe kontributeve përkatëse për periudhën një vjeçare që ka shtrirë efektet kontrata, vetëm nga zhvillimi i procesit të rivlerësimit, si dhe me të rënë në dijeni të këtij fakti ka vënë në lëvizje gjykatën me kërkesë padi, me objekt detyrimin e punëdhënësit të paguajë kontributet sipas legjislacionit dhe parashikimeve kontraktuale, duke depozituar padinë dhe vërtetimin e lëshuar nga gjyqësori mbi regjistrimin e saj.

1.10 Subjekti, bazuar në këto prova shkresore, kërkoj riçeljen e hetimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Në lidhje me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për riçelje të hetimit

Komisioni, pasi administroi provat e reja të depozituara nga subjekti lidhur me pagimin e tatimit në burim për shërbimin e kryer nga bashkëshorti i saj te Personi Fizik “E. – S.”. e përfaqësuar nga z. E. M., për periudhën 2008 – 2012, si dhe padinë objekt gjykimi ndaj shoqërisë “E. C.” sh.p.k., me qëllim kryerjen e plotë dhe me objektivitet të hetimit administrativ, vlerësoi vijimin e hetimit për kriterin e pasurisë mbi të dhënat e pasqyruara në aktet përkatëse, analizimin ligjor të tyre, pasi çdo konkluzion i arritur do të impaktonte drejtpërdrejtë provueshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, si dhe duke mbajtur në konsideratë faktin se burimi i krijimit të kësaj pasurie ishin pikërisht të ardhurat e përfituara nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortit, pra, nga punësimet e tyre.

Nën këtë kontekst, pas riçeljes së hetimit, Komisioni vijon me hetimin administrativ dhe më konkretisht me shkresën nr. ***prot., datë 7.1.2020, rikërkoj në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, dokumentacionin mbështetës në lidhje me pagesat e kryera nga Personi Fizik “E. M.” dhe FDP-të përkatëse, për tatimin në burim, sikurse ishte përshkruar në shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, të cituar më sipër, depozituar nga subjekti.

Po ashtu, iu kërkua edhe bankave¹⁴ të nivelit të dytë konfirmim mbi pagesat e kryera nga Personi Fizik “E. M.” me NIPT***.

Nga dokumentacioni bankar nuk u vërejtën transaksione të kryera nga Personi Fizik “E. M.” për llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, me përshkrimin përkatës për këtë detyrim tatimor.

Ndërsa, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 6.2.2020, konfirmoi se: *“Për periudhën 2008 – 2012 për FDP-të e Tatimit në Burim të dhënat janë mbajtur jashtë sistemit Informatik Tatimor (SIT) dhe nuk ka pasur deklarime për këtë zë tatimor... në regjistrat e kontabilitetit ka rekorde për transaksione në bankë nga personi fizik E. M. me NIPT ***, Tatim në Burim në Llogarinë e Tatimeve të tjera, në shumën 569.507 lekë.”*

Kjo drejtori së bashku me informacionin e përcjellë ka depozituar edhe një format të printuar në datën 18.8.2014, ku, ndër të tjera, konstatohet se nuk pasqyrohet emri i bankave në të cilat janë bërë pagesat përkatëse.

Komisioni, në informacionin e përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, vërejtjti se shuma prej 569.507 lekësh ishte paguar në vitet 2008, 2011 dhe 2012.

Gjithashtu, është pyetur subjekti i rivlerësimit dhe në përgjigjen e dhënë ka konfirmuar se i ishte drejtuar me shkresë Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë, nga ku iu rikonfirmua përgjigjja e dhënë me shkresën nr. *** prot., datë 11.11.2019.

Me gjithë shpjegimet e subjektit, Komisioni në analizë të dokumentacionit të administruar ka konkluduar se dukej se nuk provohej me dokumentacion bankar kryerja e pagesave për tatimin në burim, pasi në shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, nuk konfirmohej banka në të cilën ishte kryer transaksioni dhe për këtë shkak i ka kaluar subjektit barrën e provës¹⁵ për të provuar të kundërtën.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni, pas riçeljes së hetimit

1.11 Ndër të tjera, subjekti në prapësime ka parashtruar se për periudhën që është paguar tatimi në burim në vitet 2008 – 2012, procedura e ndjekur për të kryer një pagesë për këtë lloj tatimi nga subjektet ka qenë në dy mënyra:

- a) Shuma e llogaritur për tatimin në burim paguhej nga llogaria rrjedhëse e subjektit dhe ky transaksion pasqyrohej në *statement*-in e bankës që kishte kryer pagesën.
- b) Për tatimpaguesit që i kryenin pjesërisht pagesat nga llogaria e biznesit, pagesa bëhej

¹⁴ Referojuni korrespondencës nr. *** prot., datë 10.12.2019, nr. *** prot., datë 7.1.2020, të KPK-së dhe nr. *** prot., datë 31.12.2019, të BKT-së, nr. *** prot., datë 10.1.2020, të BKT-së; nr. ***prot, datë 8.1.2020 të “Raiffeisen Bank”, nr. *** , të OTP Bank, nr. *** prot., datë 30.12.2019, të “Credins Bank”, në dosjen e Komisionit.

¹⁵ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafët 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

nëpërmjet paraqitjes pranë sportelit të arkës së bankës apo edhe postës shqiptare duke i kërkuar punonjësit të arkës të kryente veprimin e pagesës së tatimit në burim për llogari të një tatimpaguesi sipas përshkrimit që personi urdhërues i kërkonte punonjësit të bankës të shkruante në urdhër xhirim. Në të shumtën e rasteve, procedura e dytë ndiqej nga tatimpaguesit, llogaritë e të cilëve mbaheshin nga ekonomistë të jashtëm.

Tatimpaguesit, pasi kishin llogaritur dhe mbajtur shumën e tatimit në burim që duhej paguar, i jepnin shumën e të hollave ekonomistit apo një personi tjetër i cili paraqitej në bankë ose postë dhe kryente pagesën në *cash* të tatimit në burim për llogari të tatimpaguesit dhe me përshkrimin e urdhëruar prej tij pranë sportelit të bankës.

Subjekti, në lidhje me shtetasin E.M. për çështjet e sipërpërmendura, ka konfirmuar që pagesat e tatimit në burim janë kryer, por nuk kujton nëse këto pagesa janë kryer nga ekonomistët e jashtëm apo personalisht prej tij në sportel, pasi gjithmonë një pjesë e pagesave që lidheshin me tatimet kryheshin ose nga ekonomistët e jashtëm, ose nga vetë ai apo edhe nga persona të tjerë në bankë.

Nga DRT-ja Tiranë është konfirmuar fakti se për këtë periudhë kohe nuk ka FDP për këtë zë tatimor, pra, tatim në burim referuar sistemit të asaj kohe (*..të dhënat janë mbajtur jashtë sistemit Informatik Tatimor dhe nuk ka pasur deklarime për këtë zë tatimor*).

Referuar kartelës analitike për tatimpaguesin “E. M.” me NIPT *** rezulton se janë kryer gjithsej pesë pagesa dhe datat e pagesës se vlefshme në kartelën analitike konkretisht janë datat 31.12.2008, 30.3.2009, 31.12.2010, 30.3.2011 dhe 31.12.2012. Citimi se prej DRT-së Tiranë është depozituar një fletë formati e printuar në datën 18.8.2014 në vlerësimin e subjektit, nuk përputhet me të dhënat e kartelës analitike, pasi printimi i datës 18.8.2014 ka lidhje me faqen ***, pra, është pjesë e mënyrës se si mbahen të dhënat nga ky institucion.

Subjekti ka parashtruar edhe referencat ligjore për të mbështetur argumentet e saj. Në vijim subjekti ka shpjeguar edhe lidhur me hyrjen në fuqi të formularit të deklarimit dhe pagesës (FDP), duke cituar se ky akt ka hyrë në fuqi për herë të parë në lidhje me deklarimin e tatimit në burim me hyrjen në fuqi të sistemit të ri tatimor *C@TS*. Deklarimi për herë të parë i këtij formulari ka qenë në dhjetor të vitit 2014. Deri përpara këtij momenti kohor nuk ka pasur formular të deklarimit dhe pagesës për tatimin në burim dhe pagesa për këtë lloj tatimi realizohej sipas dy mënyrave të sqaruara më sipër. Me Udhëzimin nr. 14, datë 23.5.2014, të ministrit të Financave është miratuar për herë të parë modeli i formularit të deklarimit dhe pagesës për tatimin në burim. Për periudhën 2008 – 2012 nuk ka FDP jashtë sistemit, pasi të gjitha FDP-të për çfarëdo lloj tatimi janë në sistem dhe deklarimi i tyre bëhej sipas rubrikave të përcaktuara në sistem manual. Mbi këtë shpjegim subjekti i është referuar edhe standardit të mbajtur nga Kolegji¹⁶ i Posaçëm i Apelimit në vendimet e dhëna. Po ashtu, ka cituar se në rastin e bashkëshortit tatimi në burim ka qenë padeklarim. Kjo marrëdhënie ekonomike nuk normohej nga ligjvënësi në këtë periudhë kohe me FDP-të, por parashikohej pagesa që nënkuptonte deklarimin në sportelet përkatëse të bankave apo filialeve të postës shqiptare pa u shoqëruar me deklaratë individuale.

¹⁶ Vendimet nr. 15, datë 17.7.2019; nr. 19, datë 26.7.2019; si dhe nr.12, datë 17.12.2018.

Për rastin e subjektit “E. M.” me NIPT ***, tatimi në burim ishte tatim padeklarim dhe pagesa kryhej në llogarinë e “tatimeve të tjera” dhe si është sqaruar, mund të kryhej nga çdo person duke përshtetur tatimpaguesin për të cilin kryhej pagesa me përshteturin përkatës. Subjekti për të provuar të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti, në shërbimin që i ka ofruar subjektit “E. M.” me NIPT *** ka depozituar dokumentacionin¹⁷ provues lidhur me projektet e hartuara, miratuara dhe zbatuara nga bashkëshorti dhe subjekti “E.M.”.

Në vijim, subjekti është shprehur se dokumentacioni provon tërësisht, tej çdo dyshimi, se këto projekte janë hartuar nga bashkëshorti (për to janë miratuar edhe lejet e ndërtimit përkatëse), pra, burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave të cilat janë deklaruar rregullisht prej saj, në deklaratat vjetore periodike të dorëzuara në ILDKPKI, si dhe në deklaratën *Vetting* të cilat edhe janë tatuar sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi. Ky fakt është konfirmuar nga DRT-ja Tiranë me shkresat nr***prot., datë 11.11.2019, për mua si subjekt dhe shkresën nr. ***prot., datë 6.2.2020, drejtuar Komisionit. Të dyja këto shkresa janë prova, referuar nënve 253 dhe 257 të Kodit të Procedurave Civile, që përbëjnë akt zyrtar me fuqi të plotë provuese dhe kanë forcë juridike jo vetëm për palët, por edhe për të gjithë subjektet publikë dhe privatë që u drejtohet. Pra, në rastin e subjektit, provohen tërësisht të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti dhe se nga Komisioni duhet të konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptim të sanksionimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Subjekti ka sqaruar se as bashkëshorti dhe as ajo, në asnjë moment, nuk kanë poseduar dokumente bankare apo dokumente të tjera të cilët pasqyrojnë faktin e pagimit të detyrimeve tatimore, pasi subjekti deklarues ka qenë “E. M.” me NIPT ***, si dhe janë bërë përpjekjet maksimale për sigurimin e këtyre dokumenteve qoftë nëpërmjet komunikimit me shtetasin E. M. (komunikim elektronik dhe deklaratën e tij e kanë dorëzuar me cilësinë e provës), ashtu edhe nëpërmjet kërkesës në DRT-në Tiranë.

Në kushtet kur prej tyre nuk janë vënë në dispozicion këto dokumente ka shpjeguar se është më se e qartë që janë në pamundësi absolute të sigurimit të tyre dhe për pasojë nuk mund të ngarkohen me barrë prove në lidhje me këtë fakt, kur nuk janë tatimpagues dhe për më tepër kur legjislacioni parashikon detyrimin e tatimpaguesit për ruajtjen e dokumenteve për një periudhë kohore maksimale 5-vjeçare referuar pikës 2, të nenit 48 të ligjit nr. 9920/2008.

Në lidhje me punësimin e bashkëshortit në shoqërinë “E.-C. G.” sh.p.k., subjekti ka qartësuar mbi padinë e ngritur dhe vendimin nr. ***, datë 6.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor mbi moskompetencën tokësore të shpallur, si dhe dërgimin e çështjes civile për kompetencë tokësore Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, si gjykatë kompetente për gjykimin e kësaj

¹⁷ Nr. ***prot., datë 25.6.2019 e Bashkisë Himarë ku provohet shërbimi i ofruar nga bashkëshorti i saj K. O. për Personin Fizik “E. M.” në lidhje me projektet për të cilat është miratuar leja e ndërtimit; nr. *** prot., datë 10.6.2019 e Bashkisë Kukës, ku provohet shërbimi i ofruar nga bashkëshorti i saj K.O. për Personin Fizik “E.M.” në lidhje me projektet për të cilat është miratuar leja e ndërtimit; nr ***prot., datë 19.6.2019 e Bashkisë Durrës, ku provohet shërbimi i ofruar nga bashkëshorti i saj K. O.për Personin Fizik “E.M.” në lidhje me projektet për të cilat është miratuar leja e ndërtimit; nr. ***. prot., datë 19.6.2019 e Njësisë Administrative Dajt, ku provohet shërbimi i ofruar nga bashkëshorti i saj K. O. për Personin Fizik “E.M.” në lidhje me projektet për të cilat është miratuar leja e ndërtimit; nr. ***prot., datë 25.6.2019 e Njësisë Administrative Kashar-Tiranë, ku provohet shërbimi i ofruar nga bashkëshorti i saj K. O. për Personin Fizik “E. M.” në lidhje me projektet për të cilat është miratuar leja e ndërtimit; nr***prot., datë 15.11.2019, i shoqërisë “K.” sh.p.k. me NIPT ***, ku bashkëlidhur ndodhet edhe projekti konstruktiv për objektin “godinë banimi dhe shërbimi 7+9-kate me një kat bodrum” Komuna Kashar-Tiranë, ku inxhinierë konstruktorë janë shtetasit E.M. dhe K. O. .

çështjeje. Subjekti ka depozituar vërtetimin nr. *** prot., datë 3.3.2020, mbi regjistrimin e çështjes civile me nr. regj. *** (***), ku padia i ka kaluar për shqyrtim gjyqtares I. R. . Subjekti ka qartësuar se nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit për shkak të mos funksionimit të Gjykatës së Lartë dhe me qëllimin e vetëm për të zgjidhur shpejtë problemin dhe jo për të bërë një padi “fiktive”.

Gjithashtu, subjekti ka qartësuar se këto shoqëri nuk kanë prishur kontratën e punës dhe, njëkohësisht, nuk kanë kërkuar dhe deklaruar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Licencimit largimin si drejtues teknik të bashkëshortit të subjektit dhe në të njëjtën kohë edhe bashkëshorti i saj (është shprehur subjekti) nuk ka kryer asnjë veprim për largimin nga Drejtuesi Teknik në këto shoqëri, siç provohet edhe nga shkresa e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ky fakt provon qartë se përmbushet njëri nga dy kushtet kumulative në respektim të pikës 3, të nenit D, të Kushtetutës që tregon se titulli juridik i krijimit të pasurisë është i ligjshëm (veprim juridik i lejuar nga ligji) dhe kushti i dytë pagimi i detyrimeve tatimore edhe pse nuk është përmbushur është përgjegjësi tërësisht e punëdhënësve sipas opinionit ligjor të DPT-së.

Subjekti ka vënë në dispozicion vërtetimet¹⁸ gjyqësore, kërkesat, fletë-thirrje, komunikime për të qartësuar marrëdhënien me organet e gjyqësorit, pra, mbi paditë e ngritura dhe ecuritë e tyre.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues në lidhje me vërtetësinë dhe saktësinë e deklaramëve të subjektit, për këtë pasuri, në raport me provat e administruara dhe ligjin e zbatueshëm, arsyeton si vijon:

Pasuria objekt hetimi administrativ është rezultat i një marrëdhënie kontraktore nënshkruar mes shoqërisë ndërtimore, subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit.

Këtë marrëdhënie subjekti e ka deklaruar me saktësi në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratën periodike dhe, njëkohësisht, ka deklaruar komfor kërkesave të ligjit nr. 84/2016 dhe nr. *** , i ndryshuar, në deklaratat periodike përkatëse edhe burimin e krijimit të saj.

Në lidhje me ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, bazuar në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, sipas të cilit, pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar tatimet, nga analiza financiare, fillimisht për shkak të: (i) moskonfirmimit të detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga punësimi i bashkëshortit pranë punëdhënësit “E. – S.” përfaqësuar nga z. E. M.; dhe (ii) konfirmimit të mospagimit të plotë të detyrimit tatimor apo kontributeve nga punëdhënësi “E. C.” sh.p.k., por në një masë që nuk ligjëronte plotësisht pagën e deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike

¹⁸ Vërtetim nr. ***prot., datë 3.3.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; vërtetim datë 2.3.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me të paditur shoqërinë “A. R.” sh.p.k.; vërtetim datë 2.3.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me të paditur shoqërinë “A.-S.” sh.p.k.; vendim nr***datë, 4.2.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vërtetim datë 2.3.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për kthimin e padisë me të paditur shoqërinë “N.” sh.p.k.; kërkesë e datës 31.1.2020 drejtuar gjyqtares M.Xh.nga av. E. M. (U.); dëftesë komunikimi me nr***, datë 28.2.2020, ku kemi marrë dijeni në datën 3.3.2020; fletë-thirrje e datës 19.2.2020 me nr. *** akti të gjyqtares F. O.; vendim nr. *** Akti, datë 6.12.2019; kërkesëpadia e datës 5.3.2020, e depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me paditës K. O. dhe të paditur shoqërinë “N.” sh.p.k.; ekstrakt i QKB-së për subjektin “N.” sh.p.k.

vjetore për vitin 2011, në shumën 50.000 lekë/muaj, subjekti rezultoi në pamundësi financiare për investimin e kësaj pasurie. Në situatën faktike të kësaj çështjeje, trupi gjykues ka analizuar faktet dhe rrethanat lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga punësimi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në dy shoqëritë punëdhënëse, për periudhën deri në krijimin e kësaj pasurie, prill 2011 në raport me: (i) pretendimet e subjektit se në burimin e kësaj pasurie duhet përfshirë edhe shuma 1.000.000 lekë, si gjendje *cash* e mbartur nga viti 2010, për të cilën deklaroi se provueshmëria e të ardhurave të ligjshme të punësimit të bashkëshortit në të dy shoqëritë, impakton drejtpërdrejtë ligjshmërinë e krijimit të gjendjes *cash*; dhe (ii) pretendimin tjetër të subjektit, se në analizë financiare për këtë pasuri duhet të përfshihen edhe të ardhurat shtesë të përfituara nga punësimi i bashkëshortit të saj në shoqërinë “E. – S.” përfaqësuar nga z. E.M., në vitin 2011 (në ndryshim nga të ardhurat e përfituara në vitet e tjera), të cilat kryesisht janë përfituar në fillim të këtij viti. Për këtë subjekti ka depozituar edhe vërtetimin e shoqërisë që pasqyron pretendimin e saj, si dhe i referohet tatimit në burim të paguar për këtë vit kalendarik, i pasqyruar në vlera më të larta se në vitet e tjera.

a. Mbi këtë kronologji, trupi gjykues fillimisht në lidhje me punësimin e bashkëshortit të subjektit, në dy shoqëritë punëdhënëse, ka vërejtur gjatë hetimit dhe verifikimit të të gjithë provave të administruara, faktin se subjekti ka deklaruar saktësisht në deklaratat periodike¹⁹, marrëdhëniet e punësimit me këto shoqëri duke identifikuar ekzaktësisht emërtesat e tyre, ka deklaruar në kohë reale pagën vjetore të përfituar nga “E. – S.” të përfaqësuar nga z. E.M., në shumën 1.200.000 lekë dhe nga shoqëria “E.C.” sh.p.k., në shumën 528.000 lekë.

Po ashtu, një tjetër fakt i pakontestueshëm i konstatuar, është edhe deklarimi i subjektit në deklaratën *Vetting*, por edhe ato periodike, i mënyrës së fitimit të të ardhurave nga bashkëshorti nga këto dy punëdhënës, konkretisht duke deklaruar edhe marrëdhëniet kontraktore përkatëse për secilin punëdhënës, por edhe duke depozituar kontratat përkatëse të punësimit. Në rrethana të tilla, trupi gjykues ka konstatuar se faktet e cituara sa më sipër provojnë ekzistencën dhe përfitimin e të ardhurave të përfituara nga bashkëshorti i subjektit, sikurse ato janë deklaruar. Ndërsa, kriteri bazë, por jo i vetëm, që provon ligjërimin e tyre, me pasojë ligjërimin e pasurisë në përputhje me kërkesat e nenit të D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, ishte pagesa e detyrimeve tatimore.

Komisioni, në konsideratë të verifikimeve të elementëve të ligjshmërisë së burimit të kësaj pasurie, si në pikëpamjen e ligjshmërisë së marrëdhënies së punësimit dhe asaj të të ardhurave, jo pa qëllim trajtoi në rezultatet e hetimit administrativ kontratat e punësimit, për të parë përmbushjen e elementëve të tyre, si pasqyrimin e pagave që do të përfitonte punëmarrësi/bashkëshorti i subjektit, mënyrën e pagesës, si dhe të drejtat dhe detyrimet mes palëve, sikurse arsyeton:

Në kontratën e punësimit të bashkëshortit të subjektit, si person i lidhur, në shoqërinë “E. – S.” përfaqësuar nga E. M., konfirmohej paga e punëmarrësit në të njëjtën shumë 100.000 lekë (në muaj, deklaruar të ardhura vjetore në shumën 1.200.000 lekë), sikurse subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratat periodike.

Gjithashtu, sipas parashikimeve në këtë kontratë, detyrimin e pagimit të tatimit apo të kontributeve e mbarte punëdhënësi.

¹⁹ Të cilat sipas nenit 32/5 të ligjit nr.84/2016, marrin cilësinë e provës në hetimin administrativ.

Komisioni, për faktin se nuk konstatoi pagesa të pagave në favor të bashkëshortit të subjektit, nëpërmjet sistemit bankar, nuk konstatoi pagesa të kontributeve në favor të këtij të fundit, pasi ISSh-ja informonte se nuk pasqyrohej emri i tij në listëpagesa, ngriti dyshime mbi ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara që në total ishin deklaruar në shumën 5.500.000 lekë, për periudhën 2008 – 2012, kohë në të cilën kishte shtrirë efektet kontrata e punës. Ajo që do të konkurronte në këtë rast dhe do të favorizonte subjektin për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave, duke qenë se nuk kishte gjurmë bankare²⁰, duhet të ishte pagesa e detyrimeve tatimore ose kontributeve përkatëse.

Në kushtet kur subjekti me riçeljen e hetimit administrativ, depozitoi shkresën nr. *** prot., datë 11.11.2019, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, mbi pagesat e tatimit në burim, për të ardhurat e përfituara nga punësimi në këtë punëdhënëse, trupi gjykues vlerësoi se kjo provë rrezonte dyshimet e ngritura nga Komisioni për këtë çështje për arsye se dokumenti i DRT-së Tiranë, i administruar nga Komisioni në cilësinë e provës, nga njëra anë jo vetëm që konfirmonte pagesën e tatimit në burim me specifikimin “për llogari të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit K. O.”, por nga ana tjetër provohej se, pikërisht, shuma që përbënte detyrimin tatimor të paguar në total prej 569.607 lekësh, ishte në raport të drejtë me të ardhurat e përfituara nga subjekti në shumën rreth 5.000.000 lekë për katër vitet kalendarike (2008 – 2012), të ardhura të cilat sikurse u theksua edhe më sipër në arsyetim janë deklaruar në kohë reale nga subjekti.

Fakti që informacioni i ardhur nga DRT-ja Tiranë shoqërohej, gjithashtu, edhe me një printim në format *excel*, të vitit 2014, ku pasqyroheshin pagesat e detyrimeve tatimore nëpërmjet sistemit bankar, por pa identifikuar bankën përkatëse, bënte të nevojshme qartësimin e prezencës së këtij formati bashkëshoqërues me gjithë konfirmimin e pagesës së detyrimeve tatimore.

Në përgjigje të këtij konstatimi, subjekti ka sqaruar se duke iu referuar legjislacionit tatimor, më konkretisht Udhëzimit Nr. 14, datë 23.5.2014, të ministrit të Financave kur dhe është miratuar për herë të parë modeli i formularit të deklarimit dhe pagesës për tatimin në burim, si dhe faktit se për periudhën 2008 – 2012, të gjitha FDP-të për çfarëdolloj tatimi kanë qenë në sistem dhe deklarimi i tyre bëhej sipas rubrikave të përcaktuara në sistem manual, qartësohet se FDP-ja është një format i ligjësuar vetëm në vitin 2014. Gjithashtu, subjekti ka konfirmuar se këto pagesa për tatimin në burim janë kryer nga shoqëria “E. S.” më përfaqësues E. M., në arkat e bankave të nivelit të dytë duke i derdhur *cash*.

Trupi gjykues vlerëson në harmoni të gjithë faktet e pakontestueshme që përbëjnë burimin e ligjshëm të të ardhurave të krijuara nga bashkëshorti i subjektit si i punësuar pranë shoqërisë “E. – S.”, ku renditen: (i) pagesat e tatimit në burim të bëra në vitet kur edhe janë përfituar të ardhurat, pra, nga viti 2008 – 2012; (ii) shuma e tatimit në burim rakordon me të ardhurat e përfituara; (iii) pagesa përbën tatimin që shteti taton individin/subjektin në masën prej 10 % të shumës së të ardhurave dhe se në këtë rast tatimi i paguar konfirmohet në total për detyrimin *principal* prej 5.695.260 lekësh; si dhe (iv) faktin se pagesat e bëra janë bërë në përputhje me parashikimin kontraktor, ku citohet se bashkëshorti i subjektit ka qenë i punësuar me kohë të

²⁰ Që sipas nenit 118 të Kodit të Punës, referuar kohës në të cilën ka ndodhur veprimi, kalimi i pagës nuk ishte detyrim ligjor.

pjeshme, çka nënkupton se ka ofruar shërbime të caktuara, përforcuar kjo edhe me përshkrimin e bërë në shkresën e DRT-ja Tiranë, ku citohet se pagesat janë kryer për llogari të z. K. O. me të cilin ka qenë lidhur kontratë nga punëdhënësi Person Fizik “E.M.”.

Për të gjithë arsyet e lartpërmendura, trupi gjykues çmon se subjekti ka deklaruar me vërtetësi të ardhurat e përfituara nga punëdhënësi shoqëria “E. – S.”, në shumën rreth 5.000.000 lekë.

Trupi gjykues vlerëson të nënvizojë në këtë arsyetim edhe një herë marrëdhënien kontraktore të punësimit me shoqërinë “E. – S.”, duke qenë se detyrimet tatimore i janë referuar kontratës së shërbimit.

Trupi gjykues konsideron deklarin e bërë në kohë reale nga subjekti lidhur me marrëdhënien juridike të punësimit të bashkëshortit të saj, si dhe vlerëson faktin që kjo marrëdhënie ka funksionuar, ka prodhuar dhe shtrirë efektet e saj në mënyrë të ndërsjellë mes palëve, ku njëra palë ka përfituar të ardhurat dhe pala tjetër në kohë reale ka paguar tatimin në burim, pa pasur dhe krijuar mosmarrëveshje. Forma e zgjedhur mbi tatimin e paguar, nuk bën me faj punëmarrësin, për sa kohë detyrimi për t’u paguar tatimet ka qenë përgjegjësi e punëdhënësit. Në këtë rast tatimi i paguar ka ligjruar të ardhurat si një marrëdhënie shërbimi, duke konkurruar në këtë mënyrë kontratën individuale të punës e cila në tërësi rezulton pa pasoja, për sa kohë i punësuar ka përfituar të ardhura dhe për këto të ardhura janë bërë deklarinet në organin tatimor në një nga format që legjislacioni i fushës e njeh.

b. Ndërsa, në lidhje me të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në shoqërinë “E. C. G.” sh.p.k., trupi gjykues ka konstatuar të njëjtin kujdes të treguar nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me deklarin e bërë mbi marrëdhënien e punësimit, në deklarinat periodike dhe deklarinatën *Vetting*, ku bazuar në kontratën e punës, ka deklaruar të ardhurat e përfituara në shumën 50.000 lekë/muaj. Po ashtu, rezultoi se punëdhënësi kishte përfshirë punëmarrësin në listëpagesat dhe për pasojë kishte paguar edhe kontributet përkatëse. Por, ajo që vërehet është fakti se kontributet e paguara nuk përputhen me pagën *neto* të deklaruar nga subjekti.

Subjekti pretendimin e saj e bazon edhe në padinë e depozituar në gjykatë përmes së cilës kërkon pikërisht pagesat e kontributeve të plota nga pala e paditur, punëdhënësi “E. C.G.” sh.p.k. Nisur nga fakti se pagat nga ky punëdhënësi janë dhënë nëpërmjet bankës, trupi gjykues vlerëson se bashkëshorti i subjektit ka qenë në dijeni të shumës së marrë dhe në një logjikë të thjeshtë edhe të kontributit të paguar dhe që për pasojë kjo bën që përlllogaritjet të përfshijnë në mënyrë të përpiktë, për qëllim të këtij vlerësimi, të ardhurat për aq sa janë paguar kontributet përkatëse. Kjo nuk do të thotë që padia gjyqësore varet nga kjo logjikë interpretimi, për sa kohë zgjidhja në gjykatë funksionon mes dy palëve ndërgjyqëse ku mund të shfaqen rrethana dhe prova të reja të cilat nuk i përkasin këtij hetimi administrativ.

c. Në lidhje me impaktin që sjellin të ardhurat e ligjruara në analizën financiare për vitin 2011 (kohë në të cilën është blerë kjo pasuri), gjendja *cash* në shumën 1.000.000 lekë, e krijuar dhe e deklaruar në vitin 2010, trupi gjykues vëren se:

Në balancën negative të konstatuar në rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka kontestuar mospërfshirjen e kursimeve në shumën 1.000.000 lekë si gjendje *cash* e deklaruar në DVP-në e vitit 2010 dhe, për rrjedhojë, të mbartur në vitin 2011. Subjekti ka qartësuar se kjo shumë ka

qenë e deklaruar me burim krijimi, kursimet nga të ardhurat nga paga e bashkëshortëve, njëkohësisht edhe pasuria e blerë në prill të vitit 2011, është deklaruar me burim, kursime nga pagat e bashkëshortëve. Subjekti ka pretenduar se në këtë pasuri përgjithësisht janë investuar kursimet nga të ardhurat nga pagat e tyre dhe në këtë kontekst pretendon edhe përfshirjen e kursimeve (*cash*) të vitit 2010 në blerjen e saj.

Nisur nga fakti që u provua ligjshmëria e të ardhurave të bashkëshortit të subjektit, të siguruara për vitet 2008 – 2012, nga punësimi në shoqërinë “E. – S. – E. M.”, provohet edhe mundësia e krijimit të gjendjes *cash* një vit më parë. Në këto kushte trupi gjykues e gjen me vend logjikën e përdorur nga subjekti se për sa kohë është provuar se shuma 1.000.000 lekë ka qenë e mundur të kursehet nga bashkëshortët, kjo shumë lehtësisht mund të jetë investuar në blerjen e kësaj pasurie, duke qenë se në çdo rrethanë bie në sy fakti që si burim krijimi janë përdorur vetëm të ardhura të realizuara nga pagat e bashkëshortëve dhe në këtë drejtim blerja e pasurisë në muajin prill 2011, pranon përfshirjen e kursimeve të fillim vitit dhe të atyre të mbartura nga një vit më parë.

Nën këtë analizë logjiko - juridike, por edhe matematikore, trupi gjykues çmon se subjekti ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie.

d. Në vijim të provueshmërisë së burimit të ligjshëm të kësaj pasurie, për sa i përket pretendimit të subjektit për të përfshirë në analizën financiare të vitit 2011 deri në kohën e blerjes së kësaj pasurie, të ardhurat shtesë krahas pagës fikse, të përfituara nga bashkëshorti i subjektit në shoqërinë “E. S. - E. M.”, trupi gjykues mban në konsideratë disa faktorë të cilët mbështesin pretendimin e subjektit. Më konkretisht nga kontrata e punës me këtë shoqëri lehtësisht kuptohet që punëmarrësi gëzonte të drejtën e përfitimit të pagës shtesë krahas asaj të cituar si e përmuajshme. Po ashtu, shkresa e DRT-së Tiranë ka konfirmuar se për vitin 2011 tatimi në burim është paguar në shuma më të larta se vitet e tjera, çka dukshëm lë të kuptohet se punëmarrësi është paguar përtej pagës fikse. Fillimisht ky konfirmim të imponon që shtesën e pagës së këtij viti kalendarik ta përpjesëtosh në mënyrë të barabartë për të 12 muajt e vitit, pasi edhe tatimi i paguar është në total për vitin kalendarik 2011. Por trupi gjykues nisur nga këta dy komponentë, jo pak të rëndësishëm, pra, nga parashikimi kontraktor se punëmarrësi gëzonte të drejtën e shtesës mbi pagë dhe se detyrimet tatimore janë paguar në raport me një pagë më të lartë për këtë vit, konsideroi me fuqinë e provës shkresore edhe vërtetimin e lëshuar nga punëdhënësi në datë 5.12.2016 (depozituar me dorëzimin e deklaratës *Vetting*), ku pasqyrohet fakti se punëmarrësi K.O. për periudhën janar – dhjetor 2011 është paguar me pagë vjetore në vlerën prej 1.500.000 lekësh për efekt të orëve shtesë jashtë orarit të punës, si dhe dy pasqyrat e llogarisë personale të lëshuara nga z. E.M., për punëmarrësin K. O., përkatësisht: (i) të datës 10.1.2011, ku përshkruhet se punëmarrësi ka përfituar shtesë në vlerën prej 400.000 lekësh për shërbimin e kryer për klientin e shoqërisë “K.” sh.p.k.; dhe (ii) të datës 13.4.2011, me përshkrimin koha e shërbimit 5 muaj, tërheqje paradhënie në vlerën 500.000 lekë. Në kushtet kur konfirmohen shumë të dhëna shkresërisht prej depozitimit në deklaratën *Vetting* dhe zyrtarisht prej organit tatimor, trupi gjykues çmon se qëndron pretendimi i subjektit lidhur me përfshirjen në analizën financiare të vlerës prej 400.000 lekësh përshkruar dhe përfituar sipas pasqyrës së llogarisë personale lëshuar në datën 10.1.2011.

Nën argumentimet e mësipërme, përfitimi i të ardhurave nga bashkëshorti i subjektit për aq sa u konkludua, ligjëron burimin e krijimit të pasurisë dhe, për rrjedhojë, impakton analizën financiare, që nga rillogaritjet subjekti rezulton me balancë pozitive.

- Për të konkretizuar analizën financiare, pavarësisht shpjegimit narrativ të lartpërmendur, trupi gjykues identifikon, si vijon:

Njësia e Shërbimit Ligjor, rillogariti të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit si i punësuar në shoqëritë “E. S. – E. M.” dhe “E. C.”, të cilat për vitin 2011 rezultuan në shumën *neto* 1.749.768 lekë. Kjo shumë vjetore është mbledhja e të ardhurave të përfituara nga punëmarrësi në të dy shoqëritë punëdhënëse, përkatësisht 1.485.000 lekë nga “E. S.- E. M.” dhe 264.768 lekë nga “E. C.”.

Gjithashtu, pavarësisht se subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* shumën prej 5.500.000 lekësh të ardhura të përfituara për vitet 2008 – 2012 nga marrëdhënia e punësimit me shoqërinë “E. S. E.M.”, shuma neto e përfituar pas pagimit të detyrimeve tatimore rezulton në vlerën 5.125.734 lekë, vlerë pothuajse e përafërt me deklarinimin periodik.

Si rezultat, analiza financiare deri në datën 11.4.2011, duke përfshirë të ardhurat nga paga nga dy punëdhënësit, shuma shtesë prej 400.000 lekësh, si dhe gjendjen *cash* në shumën 1.000.000 lekë, rezulton në balancë pozitive për krijimin e kësaj pasurie dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera.

Në përfundim, për sa u analizua më sipër, bazuar në prova dhe fakte, trupi gjykues çmon se subjekti:

- i. Ka shpjeguar bindshëm dhe ka faktuar me prova burimin e krijimit të shumës 5.125.734 lekë, shumë e krijuar nga të ardhurat e përfituara nga punësimi i bashkëshortit në shoqërinë “E.– S., E. M.”.
- ii. Ka bërë deklarinim të mjaftueshëm në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Kushtetutës.
- iii. Rezulton në balancë pozitive për krijimin e kësaj pasurie.

Në lidhje me gjendjen *cash*

Duke qenë se pasuria më sipër është blerë në vitin 2011 dhe subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në fund të vitit 2010, shumën 1.000.000 lekë, Komisioni ka vlerësuar që të arsyetojë problematikën e rezultuar mbi gjendjen *cash* të deklaruar nga subjekti për këtë vit, por edhe për vitet e tjera, sipas tabelës si vijon:

Pasqyrimi i gjendjes *cash* sipas DPV-ve

Viti	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Shuma	1,000,000	1,000,000	306,399	306,399	306,399	306,399	306,399

- Komisionit i ka rezultuar se në vitin 2010 subjekti kishte deklaruar në DVP, gjendje *cash* në shumën 1.000.000 lekë.
- Në vitin 2011 subjekti nuk kishte deklaruar ndryshime të gjendjes *cash*, si rrjedhim, në fund të vitit gjendja e *cash* mbetet e njëjtë me atë të vitit të kaluar.
- Në vitin 2012 subjekti kishte deklaruar kursime në shumën 700.000 lekë, ku një pjesë e tyre ndodheshin në bankë dhe diferenca *cash* në shtëpi. Nga korrespondenca e Komisionit me bankat rezultoi se në sistemin bankar kursimet ishin në shumën 393.601 lekë.
- Për vitet në vazhdim nga 2013 – 2016, subjekti nuk ka deklaruar asnjë ndryshim, pakësim apo shtim të gjendjes *cash*, çka nënkupton se gjendja *cash* e vitit 2012 mbartet përgjatë viteve pasardhëse.
- Në vijim, Komisionit i rezultoi se subjekti në pyetësorin nr. 2, datë 2.10.2019, në përgjigjen e pyetjes nr. 7, deklaronte të tjera vlera të gjendjes *cash* nga ato të deklaruara në deklaratat periodike vjetore. Më konkretisht në këtë pyetësor, subjekti ka deklaruar pakësime të gjendjes *cash* për vitin 2011 në shumën 200.000 lekë, si dhe vlera të tjera për vitet pasardhëse. Për të qartësuar deklaratimet e bëra, Komisioni e ka pyetur subjektin, i cili ka deklaruar të dhënat sipas tabelës më poshtë:
- Deklarimi nga subjekti i gjendjes *cash* sipas pyetësorët nr. 2, datë 2.10.2019 dhe të pyetësorit nr. 4, datë 16.10.2019.

Viti	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Shuma	1,000,000	800,000	800,000	350,000	350,000	-	-

Për sa më sipër, nisur nga faktet e renditura, Komisioni konstatoi se dukej se kishte mospërputhje midis vlerave të gjendjes *cash* të deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike vjetore dhe deklaratimeve të bëra në pyetësorët nr. 2, datë 2.10.2019 dhe nr. 4, datë 16.10.2019, për të cilat subjektit iu kërkua të japë shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti në parashtrimet e saj ka pretenduar se gjendja *cash* në fund të çdo viti është ajo e deklaruar në pyetësorët 2 dhe 4 dhe se Komisioni duhet t'i referohet deklaratimeve dhe provave të paraqitura prej saj në analizën financiare të kryer për vitet përkatëse.

Më saktësisht ka shpjeguar se kursimet *cash* në shumën 1.000.000 lekë të deklaruara në deklaratën për vitin 2010, por edhe në deklaratën *Vetting* ishin pakësuar për blerjen e apartamentit në Golem dhe se në fund të vitit 2011 nga paga dhe të ardhurat e bashkëshortit kishin kursyer shumën 800.000 lekë.

Po ashtu, ka qartësuar se vërtet në deklaratën individuale vjetore të vitit 2011 nuk kishte deklaruar pakësim të gjendjes *cash* në shumën 200.000 lekë, por ndodhur në këto rrethana, çmonte se situata faktike, ndonëse nuk ishte deklaruar saktë, duhej lexuar dhe kuptuar në linjën logjike që kishte paraqitur në përgjigjet e pyetësorëve 2 dhe 4, për sa kohë që pavarësisht paqartësisë në deklaratim, nuk kishte pasur mundësi të kursente më shumë se 800.000 lekë pas investimeve në blerjen e pasurisë apartament, ndodhur në Golem dhe automjetit tip “Audi A2”.

Ka parashtruar mbi pakësimet e gjendjes *cash* në vitin 2013, nga 800.000 lekë në 350.000 lekë në fund të vitit 2013 dhe se përveçse kishte bërë investime në blerjen e apartamentit dhe automjetit në vitin 2011, kishte shlyer një pjesë të huas në vitin 2012, duke menduar të krijonte një depozitë kursimi për çdo moment të papritur që mund të kishin në të ardhmen familjarisht.

Subjekti ka bërë prezent situatën përpara se të krijonte depozitën në shumën 500.000 lekë duke sqaruar se kishte pasur në llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, në datën 20.11.2013, gjendje në vlerën prej 727.402.37 lekësh. Subjekti ka mbështetur pretendimet e saj mbi gjendjen *cash*, duke qartësuar se ka shpenzuar edhe për udhëtime.

Gjithashtu, ka kundërshtuar konstatimin e Komisionit lidhur me përfundimin e gjendjes *cash* në shumën 306.399 lekë në fund të vitit 2016, ndërkohë që nuk kishte deklaruar gjendje *cash* dhe për pasojë në vlerësimin e saj konstatimi ishte i pasaktë dhe i pambështetur në prova.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të deklaramëve të subjektit në deklaratat periodike, pretendimeve se shumën prej 1.000.000 lekësh të mbartur *cash* nga viti 2010 e kishte shpenzuar për blerjen e pasurisë nr. 1, deklaramëve të bëra në dy pyetësorët nr. 2 dhe nr. 4, legjislacionit mbi deklarimin e ndryshimeve të pasurisë, shtesa dhe pakësime, ku përfshihet edhe gjendja *cash* e krijuar vit pas viti, lidhur me këtë çështje, arsyeton si vijon:

Fakti që subjekti ka përdorur gjendjen *cash* të vitit 2010 për blerjen e pasurisë nr. 1 (siç është shpjeguar edhe në arsyetimin e pasurisë nr. 1) nuk nënkupton që ky shpenzim të ketë penguar subjektin për të krijuar të njëjtën gjendje *cash* për vitin 2011, për sa kohë në deklaratat periodike vit pas viti nuk ka deklaruar ndryshime të këtij zëri, si shtesa apo pakësime. Trupi gjykues, i orientuar nga qëndrimi i mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit lidhur me gjendjen *cash*, vlerëson se këto kursime jashtë sistemit bankar, shtesat dhe pakësimet e tyre, konsiderohen sipas deklaramëve të subjektit në deklaratat periodike vjetore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe jo sipas deklaramëve të subjektit në pyetësor. Por, duke vërejtur se në përlllogaritjet financiare nuk gjenerohen balanca negative nën ndikimin e gjendjes *cash*, duke i përfshirë si në variantin e deklaruar në deklaratat periodike vjetore, ashtu edhe në deklaramet në pyetësor, trupi gjykues çmon se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratat periodike vjetore lidhur me gjendjen *cash* të pretenduar, veprim që në vlerësimin tërësor të kësaj vendimmarrjeje nuk merr peshë.

2. Apartament banimi, me sip. 111.87 m², ndodhur në Kashar, Tiranë. Vlera: 50.341 euro. Pjesa takuese: 50 %. Blerë me kontratën e sipërmarrjes (porosisë) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.11.2006, nga shoqëria “M.” sh.p.k. Burimi i krijimit: kursime nga të ardhurat nga paga; hua në shumën 10.000 euro nga prindërit e bashkëshortit të subjektit, A. dhe R.O.; si dhe shumata 6.000 euro dhuratë nga motra e bashkëshortit të subjektit, znj. A.O. .

2.1 Subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore se në datën e nënshkrimit të kontratës është paguar shumata 25.000 euro, nga të cilat 9.000 euro ishin kursime nga paga, ndërsa pjesa prej 16.000 euro ishin dhurata nga kunata dhe huaja nga vjehri dhe vjehrra. Pjesa tjetër prej 25.341 euro është paguar më pas me disa pagesa, të cilat kanë përfunduar në vitin 2009 (10.000 euro në vitin 2007, 8.000 euro në vitin 2008 dhe 7.000 euro në vitin 2009). Nga huaja prej

10.000 euro e marrë nga prindërit e bashkëshortit është shlyer një pjesë prej 5.000 euro dhe ka mbetur pa shlyer pjesa prej 5.000 euro [bashkëlidhur kontratë sipërmarrje/porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.11.2006, deklaratë noteriale nr. ***rep., nr. ***kol., datë 9.12.2012, si dhe vërtetim i datës 16.11.2016, i ***sh.a., për shtetasen A. C. (O.)].

2.2 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin përkatës²¹.

2.3 Konkluzioni i ILDKPKI-së:

- Lidhur me burimin e të ardhurave për shlyerjen e këstit të parë prej 25.000 euro për blerjen e apartamentit, dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë lidhur me burimin e të ardhurave të prindërve të bashkëshortit për të mundësuar huadhënien e shumës prej 10.000 euro.
- Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor lidhur me marrëdhënien juridike për dhurimin e shumës 6.000 euro nga motra e bashkëshortit.
- Dokumentacion jo i plotë lidhur me huan në shumën 10.000 euro nga prindërit e bashkëshortit të subjektit dhe dhurimin e shumës 6.000 euro nga motra e bashkëshortit, shuma të cilat kanë shërbyer për pagesën e këstit të parë për blerjen e apartamentit në Kashar, Tiranë.

2.4 Nga hetimi i Komisionit, për këtë pasuri, ka rezultuar se subjekti e deklaron pasurinë:

- në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2006, me përshkrim “apartament me sip. 112 m², porositur sipas kontratës së porosisë nr. ***rep., nr. *** kol., datë 15.11.2006, me vlerë totale 50.000 euro, paguar shuma 25.000 euro”;
- në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2007, me përshkrim “pagesë të kryer në muajin dhjetor ndaj shoqërisë ‘M.’, në shumën 10.000 euro, sipas kontratës së porosisë nr***rep., nr. ***kol., datë 15.11.2006”;
- në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2008, me përshkrim “pagesë ndaj shoqërisë ‘M.’, në shumën 8.000 euro”;
- në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2009, me përshkrim “pagesë ndaj shoqërisë ‘M.’, në shumën 7.000 euro”.

2.5 Kjo pasuri konfirmohet nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes/porosisë²² nr***rep., nr. ***kol., datë 15.11.2006, me sipërmarrës shoqëria “M.” sh.p.k., dhe porositës K.O.dhe Enkeleda Osmani (Xhengo).

2.5.i Agjencia Shtetërore e Kadastrës, konkretisht: Drejtoria Vendore Kamëz, Vorë²³; Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1²⁴; Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2²⁵; Drejtoria Vendore Tirana

²¹Kontratë sipërmarrje/porosie nr***rep., nr. ***kol., datë 15.11.2006; dokumentacioni i pronësisë së apartamentit në emër të shoqërisë “M.” sh.p.k., sipas vërtetimit në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 19.7.2007; vërtetim nr. *** rep., datë 13.10.2016, për njehsimin me origjinalin të dokumentacionit të mësipërm; vërtetim datë 20.1.2017, nga shoqëria “M.” sh.p.k., datë 20.1.2017, për shtetasin K. O., i cili ka porositur apartament banimi sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.11.2006, në vlerën 50.341 euro; deklaratë noteriale nr. *** rep., datë 9.10.2012; vërtetim datë 16.11.2016 (Aneks nr. 4/2, në dosjen e ILDKPKI-së).

²² Aneks nr. 4/2, në dosjen e ILDKPKI-së.

²³ Shkresë nr. *** prot., datë 6.6.2019.

²⁴ Shkresë nr. ***prot., datë 14.6.2019.

²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 18.6.2019.

Veri²⁶ dhe si Drejtoria Vendore Tirana Jug²⁷ nuk konfirmojnë pasuri në emër të subjektit të rivlerësimit apo bashkëshortit të saj.

2.5.ii Sipas kontratës së porosisë vlera e përgjithshme e apartamentit është 50.341 euro dhe likuidimi me këste është parashikuar, si vijon:

- kësti i parë, i paguar në datën 15.11.2006, në shumën prej 50 % të vlerës së kontratës;
- kësti i dytë do të paguhet në datën 15.5.2007, në vlerën 25 %;
- kësti i tretë do të paguhet në datën 15.8.2007, si pjesë e mbetur.

2.6 Komisioni hetoi për likuidimet e kryera nga subjekti²⁸ dhe sipas vërtetimit të shoqërisë “M.” sh.p.k., rezultoi se pagesat nuk janë kryer sipas parashikimeve kontraktore, por janë kryer, si vijon:

Tabela nr. 1

	Shuma në euro	Data
Me nënshkrimin e kontratës	25,000	15.11.2006
Mandatarkëtimi	10,000	20.12.2007
Depozitim në arkë në “Tirana Bank”	3,000	15.7.2008
Mandatarkëtimi	5,000	15.12.2008
Mandatarkëtimi	7,000	9.11.2009
Total	50,000	

2.7 Subjekti ka deklaruar si burim krijimi për këtë pasuri:

- a) kursime nga pagat;
- b) hua në shumën 10.000 euro nga prindërit e bashkëshortit A. dhe R.O.;
- c) shumën 6.000 euro, dhuratë nga motra e bashkëshortit A.Ç. (O.).

2.8 Komisioni hetoi për secilin nga burimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

2.8.i Për kursimet nga pagat, Komisioni hetoi mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave nga punësimi për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit.

2.8.ii Kjo pasuri është likuiduar përgjatë viteve 2006 – 2009.

2.8.iii Për vitet 2006 – 2009 subjekti ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore se bashkëshorti ka qenë i punësuar pranë 4 shoqërive dhe ka siguruar të ardhura, si vijon:

Tabela nr. 2

	2006	2007	2008	2009
“P. A.” sh.p.k.	960,000	960,000	640,000	
“N.” sh.p.k.		360,000	480,000	150,000
“E.S.” sh.p.k.			200,000	1,200,000
“A. S.” sh.p.k.				250,000

²⁶ Shkresat nr. ***prot., datë 17.6.2019 dhe nr. ***prot., datë 19.6.2019.

²⁷ Shkresë nr. ***prot., datë 15.7.2019.

²⁸ Pyetësor nr. 2, datë 2.4.2019 dhe dokumentacioni i depozituar në dosjen e Komisionit.

2.9 Nga korrespondenca e mbajtur nga Komisioni me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Arkivin Qendror dhe Drejtoritë Rajonale rezulton se bashkëshorti i subjektit ose nuk figuron në listëpagesa, ose është siguruar për një pagë shumë herë më të vogël nga ajo e deklaruar në deklaramet periodike vjetore ose vërtetimet e punës së depozituar në ILDKPKI.

2.9.i Gjithashtu, Komisioni kërkoi informacion edhe nga 4 shoqëri punëdhënëse (duke iu drejtuar në adresat e pasqyruara në QKB), për të cilat ka administruar kthimin²⁹ e kërkesës me postë me shënimet, përkatësisht “objekt i pakërkuar”, “adresë e pamjaftueshme”, “i panjohur” dhe “adresë e pasaktë”.

2.10. Të ardhurat që rezultojnë sipas konfirmimit zyrtar pasqyrohen në tabelën si vijon:

Tabela nr. 3

	2005	2006	2007	2008	2009
“P.A.” sh.p.k.	106,072	119,042	86,333		
“N.” sh.p.k.					
E. S.					
“A. S.” sh.p.k.					

2.11 Drejtoria e Arkivit Qendror³⁰ :

2.11.1 Për punëdhënësin “P.A.” sh.p.k., konfirmon se shtetasi K. O.ka qenë i siguruar për vitet 2003 – 2007 me pagë *bruto* nga 9.403 lekë deri në 48.611 lekë, sipas vërtetimit bashkëngjitur shkresës. Ndërsa, për periudhat ku nuk figuron shprehet se: *“Për periudhën korrik 2002 deri tani nuk administrojmë listëpagesa. Për periudhën gusht - dhjetor 2002 nuk i figuron emri në listëpagesë. Për periudhat janar - shkurt 2007, maj 2007 - gusht 2008 deri tani nuk administrojmë listëpagesa”*.

2.11.2 Për punëdhënësin “N.” sh.p.k. shprehet se: *“Nuk i figuron emri për periudhën qershor 2007 - maj 2009. Për muajin maj 2007 deri tani nuk disponojmë listëpagesa”*.

2.11.3 Për punëdhënësin E. S. shprehet se: *“Janar - Qershor 211, Janar - Qershor 2012, Tetor - Dhjetor 2012 nuk i figuron emri në listëpagesa. Për periudhën Korrik - Dhjetor 2011, Korrik - Shtator 2012, deri tani administrojmë të dhëna”*.

2.11.4 Për punëdhënësin “A.-S.” sh.p.k., shprehet se: *“Nuk administrojmë të dhëna. U verifikua edhe në sistem dhe nuk ka derdhje kontributesh”*.

2.11.1.i Komisioni ka verifikuar dhe analizuar marrëdhënien e punësimit të ndërtuar mes punëdhënësve, shoqërisë “P.A.” sh.p.k., “N.” sh.p.k., dhe “A.-S.” sh.p.k, pasi për punëdhënësin, shoqërinë “E.S.”, ka parashtruar hetimin e kryer në pasurinë e parë të arsyetuar në këtë vendimmarrje.

Në lidhje me punëdhënësin “P. A.” sh.p.k., Komisionit i rezultoi si vijon:

²⁹ Prot. i Komisionit nr. ***, datë 24.10.2019, për shoqërinë “P. A.” nr. ***, datë 24.10.2019, për shoqërinë “N.” sh.p.k., nr. ***, datë 24.10.2019, për E. M., nr***, datë 24.10.2019, për “A.-S.” sh.p.k.

³⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 12.9.2019, në dosjen e Komisionit.

- Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për vitet 2005 – 2008 ka përfituar nga shoqëria “P.A.” sh.p.k., të ardhura në shumën 3.520.000 lekë.

- Subjekti ka depozituar vërtetimin (s’ka datë) e kësaj shoqërie ku, ndër të tjera, deklarohet: “Z. K. O.ka punuar pranë shoqërisë sonë, me profesion inxhinier ndërtimi, nga periudha korrik 2002 deri në gusht 2008 dhe se është angazhuar me kohë të plotë me detyra të ndryshme me pagë mujore 80.000 lekë”. Vërtetimi rezulton i nënshkruar dhe i vulosur nga administratori i shoqërisë z. A. N. . Aktualisht kjo shoqëri rezulton të ketë në QKB statusin “Shoqëri në likuidim e sipër”. Sikurse konstatohet, pretendohet për vërtetësinë e një marrëdhënieje relativisht të gjatë në kohë mes palëve punëdhënës dhe punëmarrës. Konstatohet se për këtë marrëdhënie punësimi nuk ka ekzistuar një kontratë me shkrim, sipas parashikimeve të neneve 12 dhe 21 (kryesisht pika 4), etj., të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.

- Sipas të dhënave nga ISSh-ja rezulton se punëdhënësi ka paguar detyrime tatimore për punëmarrësin gjatë viteve 2003 – 2007 (me shkëputje) për paga *bruto* që variojnë nga 9.403 lekë deri në 48.611 lekë, shuma të cilat nuk përputhen me pagën mujore prej 80.000 lekësh të deklaruar në vërtetimin e shoqërisë. Sipas përlllogaritjeve të ardhurat *neto* rezultojnë në shumën 311.446 lekë. Nuk konfirmohet që këto pagesa të kenë kaluar nëpërmjet sistemit bankar, apo me një nga mënyrat e parashikuara në nenin 118 të Kodit të Punës.

2.11.2.i Në lidhje me punëdhënësin “N.” sh.p.k., Komisionit i rezultoi si vijon:

- Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për vitet 2007 – 2009 ka përfituar nga shoqëria “N.” sh.p.k., të ardhura në shumën 990.000 lekë.

- Subjekti ka depozituar kontratë pune nr. *** rep., nr. (s’ka) kol., datë 10.5.2007, të redaktuar përpara noterit. Sipas pikës 3, të nenit 21, të Kodit të Punës, ku përcaktohen elementët që duhet të përmbajë një kontratë pune, ndër të tjera, në germën “h” është parashikuar elementi përbërës i pagës dhe data e dhënies së saj. Në përmbushje të këtij detyrimi në kontratë është parashikuar pagesa mujore në favor të punëmarrësit z. K. O., në shumën 50.000 lekë dhe njëkohësisht edhe koha e marrjes së saj, gjithnjë në fillim të muajit pasardhës. Kontrata e punës është lidhur për një afat dyvjeçar, duke filluar zbatimin për periudhën 10.5.2007 – 10.5.2009. Në kontratë është parashikuar se pagimi i kontributeve shoqërore dhe shëndetësore është detyrim i punëdhënësit. Aktualisht kjo shoqëri rezulton të ketë në QKB statusin “aktiv”. Sipas të dhënave nga ISSh-ja dhe verifikimit të dokumentacionit të depozituar nga kjo e fundit, vërtetohet se bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit z. K. O., nuk i figuron emri për periudhën qershor 2007 – maj 2009. Për muajin maj të vitit 2007 deri aktualisht, sipas ISSh-së, nuk administrohen listëpagesa. Nuk konfirmohet që pagesat të kenë kaluar nëpërmjet sistemit bankar, apo me një nga mënyrat e parashikuara në nenin 118 të Kodit të Punës.

2.11.4.i Në lidhje me punëdhënësin “A.-S.” sh.p.k., Komisionit i rezultoi si vijon:

- Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për vitet 2009-2010 ka përfituar nga shoqëria “A. – S.” sh.p.k., të ardhura në shumën 450.000 lekë.

- Subjekti ka depozituar kontratë pune nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.7.2009. të redaktuar përpara noterit. Sipas pikës 3, të nenit 21, të Kodit të Punës, ku përcaktohen elementët që duhet të përmbajë një kontratë pune, ndër të tjera, në germën “h” është parashikuar elementi përbërës i pagës dhe data e dhënies së saj. Në përmbushje të këtij detyrimi në kontratë është parashikuar

pagesa mujore në favor të punëmarrësit z. K. O., në shumën 50.000 lekë, por nuk është parashikuar koha e marrjes së saj dhe as mënyra e pagesës. Kontrata e punës është lidhur për një afat dyvjeçar, duke filluar zbatimin e saj nga data 1.8.2009 – 1.8.2011. Në kontratë është parashikuar se pagimi i sigurimeve shoqërore përballohet nga vetë punëdhënësi. Aktualisht kjo shoqëri rezulton të ketë në QKB statusin “aktiv”. ISSh-ja ka konfirmuar se sipas verifikimit të dokumentacionit, për z. K. O.: “Nuk administrojmë të dhëna. U verifikua dhe në sistem e nuk ka derdhje kontributesh”.

- Nuk konfirmohet që pagesat të kenë kaluar nëpërmjet sistemit bankar, apo me një nga mënyrat e parashikuara në nenin 118 të Kodit të Punës.

2.12 Në lidhje me dy burimet e tjera të kësaj pasurie: hua në shumën 10.000 euro, dhënë nga prindërit e bashkëshortit të subjektit A. dhe R. O.; dhe dhurimi i shumës 6.000 euro nga motra e bashkëshortit A.O. .

Komisioni i ka analizuar së bashku këto dy burime (hua dhe dhurim) sepse sipas deklarimeve të subjektit bashkëshorti i saj deri në momentin e lidhjes së martesës në vitin 2005 (30.12.2015) ka qenë në një ekonomi familjare të përbashkët me prindërit dhe motrat.

Komisioni e ka pyetur subjektin³¹ për burimin e ligjshëm të huas prej 10.000 euro të dhënë nga prindërit e bashkëshortit dhe dhuratën 6.000 euro nga kunata. Përveç sqarimeve, subjekti ka depozituar edhe dokumentacion³² justifikues mbi punësimin e familjarëve të bashkëshortit.

Gjithashtu, subjekti ka depozituar edhe deklaratë noteriale³³ nr. ***, datë 9.10.2012, ku shtetasi R. O. deklaron se ai dhe bashkëshortja A. O. i kanë dhënë hua djalit të tyre K. O. (bashkëshorti i subjektit), në datën 4.4.2006, shumën 10.000 euro për ta ndihmuar për blerje banese.

Meqenëse prindërit e bashkëshortit të subjektit, sipas kontratës së shitblerjes³⁴ nr. ***rep., nr. *** kol., datë 24.1.2002, kanë blerë një apartament në Tiranë në shumën 1.950.000 lekë, Komisioni vlerësoi që ta nisë analizën mbi mundësinë e kursimit të shumave të dhëna hua dhe dhuratë pas kësaj date deri në vitin 2006.

✓ Trupit gjykues, pas analizimit të dokumentacionit të sipërcituar, nuk i rezultuan problematika mbi burimin e ligjshëm të shumës 10.000 euro, të dhënë hua nga prindërit e bashkëshortit të subjektit dhe shumës 6.000 euro, dhuratë nga kunata A. O., dhe, për pasojë, konkludon se subjekti ka kryer deklaram të saktë në lidhje me këto dy burime krijimi.

2.13 Komisioni, pasi hetoi ligjshmërinë e të gjitha burimeve të përdorura për blerjen e kësaj pasurie, kreu analizën financiare mbi mundësitë e subjektit për të investuar në këtë pasuri nga viti 2006 (kur është paguar kësti i parë) deri në vitin 2009 (kur është paguar kësti i fundit).

³¹ Pyetësori nr. 3, datë 4.10.2019.

³² Vërtetim page nr. ***prot., datë 3.5.2019, për shtetasen A.R.O.; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe paga *neto* mesatare e ***sh.a. për shtetasen A. Ç. (O.) nga tetori i vitit 2001 deri në shtator të vitit 2014; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare të shtetasit R.O. të njehsuar me origjinalin nga 1 janar 1999 – 31.8.2011; shkresë nr. ***prot., datë 13.9.2019, e ISSh-së Gjirokastër; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare të shtetasen A. T. O.për vitet 2004 dhe 2007; shkresë nr. ***prot., datë 27.9.2019, nga Bashkia Përmet për pagesë paaftësie për shtetasen J. O.; vërtetim i shoqërisë “P.A.” sh.p.k., për pagën mujore të shtetasit K. R. O.; vërtetim nr. *** prot., datë 15.5.2019, nga ISSh-ja, Drejtoria e Arkivit Qendror Tiranë.

³³ Aneks nr. 4/2, në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁴ Depozituar nga subjekti në pyetësorin nr. 2, datë 2.10.2019.

2.14 Nga analiza financiare, Komisionit i rezultoi se: (i) dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën prej 3.349.875 lekësh për të investuar në këtë pasuri, si dhe për të kryer shpenzimet e tjera familjare; (ii) dukej se kishte mospërputhje të deklaramit të subjektit në vitet 2006 – 2009, në lidhje me të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti, me dokumentacionin e lëshuar nga subjektet tregtare “P.A.” sh.p.k., “N.” sh.p.k., “E. S.” dhe “A.-S.” sh.p.k., ku ka punuar, me informacionin dhe dokumentacionin e depozituar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe, për pasojë, subjektit iu kalua barra e provës³⁵ për të argumentuar dhe provuar të kundërtën.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

2.15 Subjekti, në parashtrimet e saj, ka qartësuar punësimin e bashkëshortit në 4 shoqëritë punëdhënëse e sipërpërmendura, ku ka deklaruar se bashkëshorti kishte filluar punë në korrik të vitit 2002 në shoqërinë “P. A.” sh.p.k., me NIPT***, me objekt aktivitet në ndërtim, pjesëmarrje në procedura tenderimi për ndërtimin e rrugëve, ujësjellësve, kanale kullimi, punë hidraulike dhe punë publike të çdo lloji, restaurime, mirëmbajtje dhe riparime ndërtesash në përgjithësi, ndërtimin për llogari të saj ose të një pale të tretë të objekteve civile, etj., si dhe ka dhënë detaje mbi detyrat funksionale të bashkëshortit gjatë marrëdhënies së punësimit.

Subjekti ka renditur edhe objektet e ndërtimit ku bashkëshorti ka ushtruar detyrën dhe depozituar listëpagesa të punonjësve të tjerë si p.sh., për vitin 2002 në objektin e ndërtimit të rrugës Fushë-Arrëz-Shën Mëri-Kukës, ku pasqyrohet fakti se shtetasi R. D. me detyrë teknik, për vetëm 20 ditë kalendarike është paguar në shumën 90.375 lekë dhe në këtë kontekst ka pretenduar se bashkëshorti si inxhinier, referuar organigramës në kantier është në nivel më të lartë drejtimi se pozicioni i punës teknik dhe se ky i fundit nuk mund të paguhet më shumë se një inxhinier. Subjekti ka sqaruar mbi tenderimet e fituara nga kjo shoqëri në qytete të ndryshme të vendit, për kryerje punimesh të ndryshme, rehabilitime rrugësh, mbi aplikime dhe leje në lidhje me ndërtimin e dy strukturave turistike 5 kate + bodrum + papafingo në parcelën nr. 42, zona turistike Golem në truallin e pronarëve Sh.C., Q. A., K. L. dhe K. A. . Ka konfirmuar se me vendimin nr. ***, datë 10.6.2005, të KRRT-komuna Golem është miratuar kjo leje dhe inxhinieri zbatues në lidhje me realizmin e ndërtimit të dy objekteve ka qenë, pikërisht, bashkëshorti K. O., ku marrëdhënia e punës ka zgjatur deri ne muajin gusht të vitit 2008 me këtë shoqëri. Subjekti ka depozituar një sërë dokumentesh³⁶ për të provuar aktivitetin e shoqërisë ku bashkëshorti ka qenë i punësuar si inxhinier. Subjekti ka parashtruar se gjatë kësaj kohe subjekti në të cilin bashkëshorti ka qenë i punësuar ka fituar procedura tenderimi në lidhje me realizimin e punimeve në fushën e ndërtimit në shumën totale prej 555.847.899

³⁵ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafët 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

³⁶Takimi i datës 4.12.2002/në faqen e dytë të shkresës, ku pasqyrohet takimi rezultojnë si kontraktorë dhe përfaqësues të shoqërisë “P.A.” shtetasi A. D. dhe K. O.; shkresa e datës 16.12.2002, me nr. ref***, me anë të së cilës është dërguar lista e inxhinierëve në lidhje me kryerjen e punimeve në Rr. “****” dhe “****”, ku bashkëshorti K.O. rezulton se është inxhinier; takimi i datës 20.1.2003, i dërguar me shkresën me nr. ref ***, i dërguar shoqërisë “P.- ****” s.r.l., nga R.A. përfaqësues i shoqërisë “L. B. G.”. Në faqen e dytë të shkresës, ku pasqyrohet takimi rezultojnë si kontraktorë dhe përfaqësues të shoqërisë “P.A.” sh.p.k., shtetasi A.N., A. D., K.O., etj. Shkresa me nr. ref ***, drejtuar z. D.A., ku bashkëlidhur ndodhet shkresa me nr. ref. **, datë 27.3.2003, e bashkëshortit K. O., ku referohet problematika në lidhje me realizimin e punimeve në kohë dhe një preventiv në lidhje me dëmet që janë shkaktuar në rastin konkret në shumën 1.421.600 lekë, ku ky dëm i është shkaktuar shoqërisë për një periudhë kohore 10-ditore në vonesën e kryerjes së punimeve (gjithsej 6 fletë në gjuhën angleze). Shkresa me nr. ref***, datë 4.2.2003, e dërguar nga bashkëshorti R. A., me cilësinë e projekt-menaxherit të L. B. G., ku bashkëlidhur janë dërguar programi i punimeve që do të kryhen në lidhje me Rr. “****” (gjithsej 3 fletë), etj.

lekësh, pra, një shumë tepër e madhe të ardhurash që kanë qarkulluar dhe në raport me të ardhurat nxirret përfundimi edhe në lidhje me fitimin e shoqërisë.

Subjekti ka sqaruar se pavarësisht se punëdhënësi nuk e ka deklaruar bashkëshortin si punëmarrës në vitin 2002, provohet nga dokumentacioni i depozituar se ka qenë i punësuar në këtë kompani. Gjithashtu, ka parashtruar se më tej punëdhënësi ka deklaruar dhe paguar kontribute për bashkëshortin dhe për këtë ka bërë referencë VKM-të, vit pas viti, përfshirë edhe rritjen e pagës minimale në shkallë vendi.

Subjekti ka theksuar se në vitin 2007 për muajt mars-prill nga punëdhënësi është paguar në pagën *bruto* në masën 48.611 lekë (ku kjo shumë i korrespondon përcaktimeve të VKM-së nr. 285, datë 4.5.2007, “Për përcaktimin e pagës referuese mujore”, ku është hera e parë që prej ligjvënësit janë kategorizuar kategoritë e punëmarrëseve dhe është përcaktuar fakti se inxhinierët nuk mund të deklaroheshin me pagën nën 120.000 lekë/muaj bruto për tatimpagues të regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj, pra, është vendosur dyshemeja në lidhje me pagën që duhej të deklaroheshin inxhinierët e ndërtimit, dhe logjikisht fakti që nga ligjvënësi është parashikuar kategorizimi i pagave minimale për punëmarrësit ka lidhje, pikërisht, me informalitetin e krijuar nga punëdhënësit të cilët kanë pasur dhe kanë detyrimin për pagimin e detyrimeve shoqërore, shëndetësore dhe pagimin e tatimeve në lidhje me pagat që ata paguajnë dhe grupi i punës i ngritur për këtë shkak ka referuar dhe parashikimin në VKM-ne e sipërcituar).

Gjithashtu, subjekti ka cituar se ajo që vihet re nga kronologjia e pagesave nga punëdhënësi “P. A.” sh.p.k. të kryera pranë ISSh-së Tiranë është fakti se sa herë ka ndryshuar paga minimale, mbi bazën e të cilës duhej të paguhej detyrimi/kontributi, po në këtë mënyrë është ndryshuar dhe deklarimi i pagesës për bashkëshortin, ku kjo është një metodologji e ndjekur nga punëdhënësi dhe nuk lidhet me asnjë veprim të qëllimshëm apo dijeni prej bashkëshortit, i cili në këtë rast është i dëmtuar. Për më tepër, gjatë periudhës së detyrimit për aplikimin e pagës referencë të vendosur nga ligjvënësi, punëdhënësi nuk e deklaroi dhe nuk paguan më kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, duke ndërprerë dhe faktimin e marrëdhënies së punës gjatë periudhës së kohës 2007 – 2008, që përkon me ndërtimin e dy objekteve në Golem, Kavajë.

Në vijim të provave ka depozituar kundërçekun me nr. ***, datë 2.12.2003, të Bankës Amerikane (si një nga format e pagesës me të cilat i është dhënë paga bashkëshortit të subjektit referuar nenit 118 të Kodit të Punës), në të cilën është pasqyruar fakti se: “*K.O. - rrogat dhe shpenzime R. shuma 700.000 lekë*”, ku urdhërues i çekut është shtetasi A. N. administrator i shoqërisë “P. A.” sh.p.k.

Këtë veprim bankar, subjekti e ka konfirmuar dhe me *statement* e datës 18.11.2019 të “Intesa Sanpaolo Bank” ku pasqyrohet fakti se bashkëshorti ka tërhequr shumën e 700.000 lekë në datën 2.12.2003. Gjithashtu, me çekun nr. ***, datë 11.8.2003, provohet fakti se bashkëshorti ka tërhequr shumën prej 400.000 lekësh, si pagesë për pagat e tij, ku për këtë fakt disponon edhe nxjerrjen e llogarisë nga “Intesa Sanpaolo Bank” të datës 19.11.2019 ku provohet ky fakt, pra, tërheqja e kësaj shume nga bashkëshorti.

Pra, në total për vitin 2003, shprehet subjekti – provoj se bashkëshorti ka tërhequr shumën prej 1.100.000 lekësh, ku këtu përfshihen dhe shpenzimet që bashkëshorti ka pasur për shkak se kanë punuar në qytetin e Kukësit, në lidhje me mirëmbajtjen e rrugës dhe përshkrimi “R.” përkon me përdorimin e automjetit të tipit “Range Rover” në pronësi të shoqërisë “P.A.” sh.p.k.

Ndër të tjera, subjekti ka cituar ekzaktësisht: “... atëherë natyrshëm shtroj pyetjen në vitin 2003 provohet fakti se bashkëshorti im ka marrë jo vetëm pagën e tij në shumën e 960.000 lekë vjetore por nga shoqëria i është rimbursuar dhe shuma e shpenzimeve që ai ka pasur në kuadër të punës së tij (ku ka marrë në total shumën prej 1.100.000-lekë), ndërkohë nga shkresa me nr. *** prot., datë 15.5.2019, të ISHSH-Tiranë rezulton se për këtë vit kalendarik ai është siguruar vetëm në shumën e 105.207-lekë pagë neto, atëherë cila është e vërteta e pagave që ka pasur bashkëshorti im ajo që kam deklaruar unë në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën Vetting apo jo që pasqyrohet nga kontributet e derdhura nga shoqëria pranë ISSh-ja Tiranë? A mundet që një inxhinier që në vitin 2003 e ka pasur pagën e tij 80.000-lekë në muaj neto në vitet pasardhëse, ku referuar aktivitetit të punës, perfeksionimit të dijeve dhe aftësive te tij të marrë një page 10-herë më të ulët se ajo që ka marrë porsa ka përfunduar shkollën.”

Subjekti ka depozituar disa dokumente³⁷ për të provuar tërheqjen e pagave të përfituara nga kjo kompani në vitin 2003 dhe 2004, si dhe ka pretenduar që të merret në konsideratë paga që realisht ka marrë bashkëshorti, për sa kohë ka provuar mbi aktivitetin ekonomik të shoqërisë ku ka pasur një aktivitet për vetëm dy vite në shumën 555.847.899 lekë, mënyrën se si ka operuar shoqëria, organizimit të saj, duke paguar pagat me çeqe bankare që në vitin 2002, ku bashkëshorti provohet se ka marrë shumën e 2.180.000 lekë.

Gjithashtu, subjekti ka sqaruar edhe lidhur me pagesat e tatimit të bëra nga shtetasi A. N. për shkak të konfirmimit të çeljes dhe mbylljes së procedurës së likuidimit, si dhe ka parashtruar se të ndodhur në kushtet kur ishte e pamundur që shoqëria “P. A.” sh.p.k. të kryente pagesat e tatimit mbi të ardhurat personale të realizuara nga bashkëshorti, administratori dhe ortaku i shoqërisë, ka marrë përsipër pagimin e detyrimit tatimor duke rimbursuar shumën në llogarinë personale të bashkëshortit.

Subjekti ka referuar një sërë dispozitash ligjore që legjitimojnë pagesën e kryer nga administratori i shoqërisë.

Gjithashtu, ka cituar se në kushtet kur shoqëria nuk kishte mundësi teknike dhe ligjore të kryente pagesat dhe ky detyrim ishte marrë përsipër nga administratori dhe ortaku i shoqërisë

³⁷ “Intesa Sanpaolo Bank” në datën 19.11.2019, llogari në të cilat provohet fakti se në datën 11.8.2003, z. K. O. ka tërhequr shumën prej 400.000 lekësh referuar çekut bankar me nr. 224913 nga shoqëria “P.A.” sh.p.k. me administrator z. A.N., shumën prej 160.000 lekësh referuar çekut bankar me nr*** nga shoqëria “P.A.” sh.p.k. me administrator z. A. N. . Në datën 2.12.2003, z. K. O. ka tërhequr shumën prej 700.000 lekësh referuar çekut bankar me nr. 239910 nga shoqëria “P. A.” sh.p.k. me administrator z. A. N. ; në datën 14.4.2004, z. K. O. ka tërhequr shumën prej 120.000 lekësh referuar çekut bankar me nr. *** nga shoqëria “P.A.” sh.p.k. me administrator z. A.N.; në datën 30.8.2004 z. K. O. ka tërhequr shumën prej 100.000 lekësh referuar çekut bankar me nr***nga shoqëria “P. A.” sh.p.k. me administrator z. A.N.; në datën 23.9.2004 z. K. O.ka tërhequr shumën prej 200.000 lekësh referuar çekut bankar me nr. *** nga shoqëria “P. A.” sh.p.k. me administrator z. A. N.; në datën 28.10.2004 z. K. O. ka tërhequr shumën prej 500.000 lekësh referuar çekut bankar me nr. *** nga shoqëria “P. A.” sh.p.k. me administrator z. A.N.etj.

“P.A.” sh.p.k., e vetmja mundësi ligjore për të kryer dhe përmbushur detyrimin e tatimit ishte deklarimi në formularin DIVA për vitin më të hershëm të deklarimit – viti 2011.

Subjekti është shprehur se ligjvënësi ka përcaktuar detyrimin e individëve që në rastet kur punëdhënësi i tyre nuk ka paguar tatimin mbi të ardhurat personale, janë vetë ata që duhet të kryejnë deklarimin dhe duhet të paguajnë në të njëjtën kohë shumën e detyrimit për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi.

Ky është edhe rasti, kur në pamundësi të përmbushjes së detyrimit nga shoqëria deklarimi është kryer nga vetë personi. Subjekti i është referuar edhe vendimeve të Kolegjit dhe Komisionit, duke argumentuar në referim të tyre disa arsye logjike që shkojnë në favor të vërtetësisë dhe të provueshmërisë së ligjshmërisë së të ardhurave.

Në interpretimin logjik të vendimit të sipërcituar, ashtu edhe veprimeve të kryera nga shtetasi A. N., rezulton se ka paguar jo vetëm *principalin* e detyrimit për tatimin mbi të ardhurat, por ka paguar të gjitha penalitetet dhe kamatëvonesat për pagesë me vonesë të këtij detyrimi tatimor.

Subjekti ka sqaruar se nga përgjigjet e dhëna nga DPT-ja, pas kërkesës së Komisionit, ka rezultuar se DPT-ja e njeh si të vlefshëm deklarimin e formularit DIVA për vitin 2011, duke paguar jo vetëm *principalin* e detyrimit në shumën prej 252.137 lekësh, por edhe interesat e pagesës me vonesë të këtij detyrimi në shumën 132.269 lekë, si edhe penalitetit për pagesë me vonesë të detyrimit tatimor në shumën 60.218 lekë. Subjekti në referencë të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës ka deklaruar se provohet se janë përmbushur në mënyrë kumulative dy kushte: (a) titulli juridik i krijimit të pasurisë është i ligjshëm (veprim juridik i lejuar nga ligji); dhe (b) është përmbushur pagesa e detyrimeve ligjore eventuale (detyrimi tatimor është paguar ose është i përjashtuar me ligj).

DPT-ja, është përgjigjur se: “... llogaritja, deklarimi dhe pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga shtetasi A. N. nuk është bërë sipas kërkesave të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003.”

Subjekti ka parashtruar edhe lidhur me dëshminë e shtetasit A. N. nga ku rezultoi tërësisht e provuar se paga mujore neto e bashkëshortit për periudhën kohore 2002 – 2008 ka qenë në shumën 80.000 lekë, ka ricituar edhe pagesat me çeqe, si dhe ka pohuar se nuk kanë pasur dijeni se kontributet përgjatë kësaj periudhe ishin paguar vetëm për pagë minimale.

Lidhur me punësimin e bashkëshortit në dy kompanitë e tjera përkatësisht “N.” sh.p.k. dhe “A. S.” sh.p.k., subjekti ka parashtruar dhe provuar se ka depozituar paditë përkatëse duke thirrur në cilësinë e palës së paditur punëdhënësit me objekt detyrimin e tyre për të paguar kontributet e papaguara në favor të palës paditëse/punëmarrësit, ka depozituar paditë gjyqësore, si dhe vërtetimet përkatëse të regjistrimit të tyre në gjykatë.

Ndër të tjera, subjekti ka parashtruar se ka qenë detyrimi i punëdhënësve “E.- C. G.” sh.p.k., “A. R.” sh.p.k., “N.” sh.p.k. dhe “A.S.” sh.p.k. të llogarisin, mbajnë dhe transferojnë në organet tatimore shumën e tatimit mbi të ardhurat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për kontratat noteriale të punës, në bazë të së cilës këto shoqëri janë pajisur me licence profesionale në ndërtim.

Këto shoqëri nuk kanë prishur kontratën e punës dhe, njëkohësisht, nuk kanë kërkuar dhe deklaruar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Licencimit largimin si drejtues teknik të bashkëshortit dhe në të njëjtën kohë nuk është kryer asnjë veprim prej tij për largimin nga Drejtuesi Teknik në këto shoqëri, siç provohet edhe nga shkresa e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ky fakt provon fare qartë se përmbushet njëri nga dy kushtet kumulative në respektim të pikës 3, të nenit D, të Kushtetutës që tregon se titulli juridik i krijimit të pasurisë është i ligjshëm (veprim juridik i lejuar nga ligji) dhe kushti i dytë i pagimit të detyrimeve tatimore edhe pse nuk është përmbushur është përgjegjësi tërësisht e punëdhënësve sipas opinionit ligjor të DPT-së.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

2.16 Trupi gjykues, në analizë të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, provave të depozituara gjatë hetimit, pas rezultateve të tij dhe kryesisht pas riçeljes, si dhe përgjigjeve të dhëna në pyetësor, lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve për këtë pasuri, si dhe burimin e krijimit të saj, arsyeton si vijon:

- i. Subjekti e ka deklaruar saktësisht përshkrimin e kësaj pasurie, si dhe mënyrën e përfitimit të saj, si në deklaratën periodike vjetore për vitin 2006, ashtu edhe në deklaratën *Vetting*.
- ii. Subjekti ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie përkatësisht në deklaratën periodike për vitin 2006 dhe në deklaratën *Vetting*.

a) Nga hetimi rezultoi se në burimin e krijimit janë deklaruar të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në katër shoqëri punëdhënëse, përkatësisht: “P. A.” sh.p.k., “N.” sh.p.k., “E. S.E. M.” sh. p.k. dhe “A. S.” sh.p.k., si dhe dy huat e marra prindërve të bashkëshortit dhe motrës së tij.

Në këtë arsyetim, trupi gjykues ka trajtuar marrëdhënien e punësimit të bashkëshortit të subjektit me këto shoqëri, ligjshmërinë e krijimit të të ardhurave të përfituara nga ushtrimi i detyrës së tij si inxhinier ndërtimi, si dhe veprimet e ndërmarra nga subjekti po në favor të provueshmërisë së ligjshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave.

b) Për sa i përket huave të marra trupit gjykues nuk i kanë rezultuar problematika lidhur me mundësinë e krijimit të tyre nga huadhënësit dhe në këtë kontekst konkluzioni është i qartë për njërin prej burimeve të kësaj pasurie.

c) Në burimin e krijimit të kësaj pasurie, nuk është vlerësuar të vijohet arsyetimi i provueshmërisë së burimit të ligjshëm të të ardhurave të përfituara nga punësimi i bashkëshortit të subjektit në shoqërinë “E.S.E. M.” nga viti 2008 – 2012, pasi është ezauruar kjo çështje që në pasurinë nr. 1, ku këto të ardhura janë përdorur për këtë pasuri dhe për apartamentin e blerë në vitin 2011, në Golem.

ç) Ndërsa për të ardhurat nga punësimi në shoqërinë “P. A.” sh.p.k., gjatë hetimit me përmbylljen e rezultateve të hetimit, Komisionit i rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit kishte punuar pranë kësaj shoqërie në periudhën 2002 – 2008. Ky konfirmim bëhej nga vërtetimi i lëshuar nga administratori shoqërisë, shtetasi A.N., depozituar nga subjekti në

deklaratën *Vetting*. Ndër të tjera, dokumenti qartëson edhe pagën e përmuajshme të përfituar në shumën 80.000 lekë.

Ligjshmëria e të ardhurave të përfituara nga ky punëdhënës rezultoi se *impaktonte* analizën financiare për shkak se pasuria megjithëse ishte porositur në nëntor të vitit 2006, pagesat e kësteve të saj kishin vijuar edhe në vitet 2007, 2008 dhe 2009, përkatësisht në shumën 10.000 euro, 8.000 euro dhe 7.000 euro, ku subjekti rezultonte në pamundësi financiare në shumën 3.349.875³⁸ lekë.

d) Lidhur me punësimin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në shoqërinë “P.A.” sh.p.k., trupi gjykues merr në konsideratë disa faktorë të rezultuar pas rriçeljes së hetimit, të cilët ndikojnë dhe ndryshojnë konstatimet fillestare.

Bazuar në faktet dhe rrethanat se: (i) bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit kishte punuar pranë këtij punëdhënësi që prej vitit 2002, konfirmuar ky fakt me disa dokumente të shoqërisë ku citohen takime të njëpasnjëshme me aktorë të ndryshëm me qëllim arritjen e objektivitetit të punës së shoqërisë dhe, ku ndër të tjerë, z. K. O. identifikohet si pjesëmarrës në profilin e tij si inxhinier ndërtimi; (ii) duke konsideruar dhe vlerësuar si burim prove me shkresë, depozitimin nga subjekti të disa çeqeve të lëshuara nga punëdhënësi, administrator A.N., të cilat provonin pagesa të ndryshme në kohë të ndryshme në favor të bashkëshortit të subjektit, pavarësisht që referonin vitin 2002 dhe jo kohën për të cilën u hetua për shkak të krijimit të pasurisë, kohë në të cilën nis edhe martesë bashkëshortore (30.12.2005); (iii) nga identifikimi i shumë projekteve të hartuara dhe realizuara nga kjo shoqëri, konfirmohet edhe prezenca e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në detyrën e inxhinierit të ndërtimit; (iv) nga provueshmëria e profilit dhe ushtrimit të detyrës së tij, si inxhinier i licencuar, që do të thotë se kishte përmbushur kushtet dhe kriteret për të pasur një tagër të tillë dhe që për pasojë drejtpërdrejtë provohej se kishte ushtruar të paktën profesionin e tij për 5 vjet, sikurse kërkohej ligjërisht për tu licencuar, trupi gjykues vlerësoi se të gjithë këto komponentë ishin të mjaftueshëm për të trajtuar më tej ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara në raport me detyrimet tatimore të paguara nga punëdhënësi gjatë hetimit administrativ, si dhe për të pranuar kërkesën e subjektit për të pyetur me cilësinë e dëshmitarit shtetasin A.N. si administrator i shoqërisë punëdhënëse në kohën e përfitimit të kësaj pasurie.

- Lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues, duke vlerësuar fillimisht faktet që lidhen me anën subjektive të padijenisë së subjektit, për mospagim të plotë të detyrimeve tatimore nga punëdhënësi të tilla si: (i) punëdhënësi, për mospagim të detyrimeve ndaj punëmarrësit dënohej³⁹ për kundërvajtje administrative, veprim i cili po të kishte ndodhur, do të bëhej me dije punëmarrësit, çka nënkupton se njëkohësisht edhe do të shërbente si mënyrë njoftimi për të/punëmarrësin, pra si marrje dijeni, për mospagim

³⁸ Kjo balancë negative në rezultatet e hetimit, erdhi si rezultat edhe i moskonfirmimit të pagesave tatimore për të ardhurat e përfituara nga tri shoqëritë e tjera, “E.S.” sh.p.k., “N.” sh.p.k. dhe “A.S.” sh.p.k.

³⁹ Ligjvënësi përveçse ka përcaktuar se kush duhet të mbajë dhe derdhë në buxhetin e shtetit tatimin mbi të ardhurat personale sipas dispozitave të ligjit nr. 9920/2008, por ligjvënësi ka përcaktuar gjithashtu se kush është përgjegjës në rast të kundërvajtjeve administrative që lidhen me shkeljet e dispozitave për tatimin mbi të ardhurat, neni 14 “Kundërvajtjet administrative”. Në ligjin nr. 9920, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 177 “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave” në pikën 3 është parashikuar se “agjenti i mbajtjes së tatimit, agjenti i taksave apo i tarifave detyrohen të paguajnë gjobë në masën 100 % të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës nëse mban apo nuk deklaroi e paguan tatimin në burim apo tatimin, taksës ose tarifën e mbledhur.

të detyrimeve tatimore nga punëdhënësi; (ii) punëdhënësi nuk ka zgjedhur kalimin e pagës në favor të punëmarrësit, nëpërmjet sistemit bankar, por pagesat janë kryer në *cash*, çka tregon se objektivisht ka qenë e pamundur marrja dijani e punëmarrësit për mospagim të plotë të detyrimeve; (iii) punëdhënësi ka pranuar të shlyej detyrimet⁴⁰ megjithëse shoqëria ishte në likuidim e sipër dhe se pagesa e tatimit sipas informacionit të konfirmuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve⁴¹, ku konfirmohej se legjislacioni tatimor e njeh të drejtën e deklarimit me vonesë, duke paguar interesat dhe penalitetet (gjoba); (iv) punëdhënësi dëshmoi përpara trupit gjykues se punëmarrësi kishte marrë pagën neto në shumën 80.000 lekë, sikurse kishte deklaruar edhe subjekti në kohë reale në deklaratat periodike⁴²; si dhe (v) legjislacioni⁴³ ka rregulluar tavanin e pagës minimale për të cilën duhet të paguhet detyrimet tatimore për profilin e punës së inxhinierit të ndërtimit, krijon bindjen se subjekti ka qenë në kushtet e pamundësisë së marrjes dijani të mospërbushjes së detyrimeve nga punëdhënësi dhe për sa kohë që gjatë hetimit Komisioni nuk evidentoi ndonjë rrethanë të marrjes dijani, argumentet dhe provat shkojnë në favor të subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues vlerëson se mosveprimi në kohë nga punëdhënësi për pagimin e detyrimit tatimor por edhe mosushtrimi i detyrave nga inspektorët e tatimeve nuk mund të rëndojnë pozitën e bashkëshortit të subjektit dhe as ti atribuojë atij ndonjë përgjegjësi për shmangien e pagimit të tatimit mbi të ardhurat.

- Lidhur me ligjshmërinë e marrëdhënies së punës, trupi gjykues, duke vlerësuar faktet se: (i) subjekti ka deklaruar të ardhurat për bashkëshortin, në kohë reale⁴⁴; (ii) punëdhënësi dëshmoi përpara trupit gjykues se marrëdhënia e punësimit të bashkëshortit të subjektit ka vijuar prej vitit 2002 – 2008; (iii) pagesat e përfituara prej tij, janë bërë përmes çeqeve, si një nga mënyrat e parashikuara në nenin 118 të Kodit të Punës (referuar legjislacionit në kohën që ka ndodhur veprimi); (iv) janë derdhur kontributet nga punëdhënësi në favor të punëmarrësit, pavarësisht se vetëm për pagën minimale por që shërbejnë si *indicie* për të treguar se marrëdhënia e punësimit ka funksionuar; (v) legjislacioni⁴⁵ i kohës lejonte mënyrën e pagimit të pagës, sipas parashikimeve kontraktore dhe nuk bënte me përgjegjësi punëmarrësin, çmon se subjekti ka shpjeguar bindshëm marrëdhënien e punësimit me këtë shoqëri.

- Trupi gjykues arriti në këto konkluzione thelbësisht nga faktet e analizuara më sipër, si për ligjshmërinë e marrëdhënies së punës, ashtu edhe për pamundësinë e marrjes dijani, mbështetur

⁴⁰ Prej momentit kur bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit kategorizohet si person i lidhur, për shkak të këtij hetimi, pasi edhe nëse do të ishin shlyer detyrimet tatimore përpara vitit 2005 ato nuk do të ndikonin në vlerësimin e subjektit.

⁴¹ Shih shkresën nr. ***prot., datë 23.12.2019.

⁴² Bazuar në nenin 32/5 të ligjit nr.84/2016, deklaratimet tek ILDKPKI-ja shërbejnë si provë.

⁴³ VKM-ja nr. 285, datë 4.5.2007, “Për përcaktimin e pagës referuese mujore për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dhe të tatimit mbi të ardhurat personale sipas nomenklaturës së veprimtarisë ekonomike, për të punësuarit në sektorin jopublik”, ku prej ligjvënësit janë kategorizuar kategoritë e punëmarrëseve dhe është përcaktuar fakti se inxhinierët nuk mund të deklaroheshin me pagën nën 120.000 lekë/muaj *bruto* për tatimpagues të regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj.

⁴⁴ Kolegji i Posaçëm i Apelit për subjektin Bashkim Dedja në vendimin nr. 12, datë 17.12.2018, në paragrafin 24.11, ka arsyetuar se: “Sipas Komisionit, ‘Objekti i hetimit i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është kontrolli i pasurive të deklaruara gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të subjektit të rivlerësuar dhe jo kontrolli i deklaratave të pasurisë të bëra gjatë viteve, gjatë kryerjes së detyrës së parashikuar nga neni 179/b i Kushtetutës për subjektet e rivlerësimit [...]’ 4. Përkundrejt këtij arsyetimi të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit vlerëson se pavarësisht se është e vërtetë që objekti i vlerësimit të pasurisë nga Komisioni është deklarimi i pasurive që i përkasin subjektit të rivlerësimit në momentin e deklaratës *Vetting (ex nunc)*, deklaratimet periodike duhet të merren në konsideratë si prova në këtë vlerësim, për shkak se ato mund të hedhin dritë mbi burimet e krijimit të pasurisë dhe në këtë mënyrë edhe mbi ligjshmërinë e pasurisë.

⁴⁵ Neni 118 i Kodit të Punës, ku citohet: “...paga mund të paguhet edhe me çek bankar...kur kjo pagese nuk është parashikuar ose vendosur merret pëlqimi i punëmarrësit të interesuar...”.

edhe në parashikimet ligjore të kësaj fushe ku, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi punëdhënësi ka pasur detyrimin dhe përgjegjësinë për pagimin e tatimit dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore për punëmarrësit. Punëdhënësi duhet t'i paguajë punëmarrësit pagën sipas dispozitave të kontratës dhe konkretisht: (i) nenet 109, 110, 117 dhe 121 të Kodit të Punës; (ii) nenin 13 të ligjit nr. 7703/1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; (iii) nenet 6 dhe 8, të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003, "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në fuqi në kohën kur pretendohet se duhet të ishin derdhur detyrimet për kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore; (iv) ligjin nr. 7870, datë 13.10.1994, "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; (v) nenin 10 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar; si dhe (vi) udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, të ministrit të Financave.

✓ Në përfundim për këtë çështje, trupi gjykues vlerëson të aplikojë parimin e objektivitetit që lidhet me pamundësinë e subjektit për të provuar marrjen dijëni të mospagimit të detyrimeve në favor të tij. Në këtë kontekst, rrethanat faktike dhe ligjore diktojnë që proporcionalisht nuk gjendemi përpara arsyeve të mjaftueshme për të aplikuar ndonjë masë disiplinore të parashikuar në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016.

e. Ndërsa lidhur me pretendimet e subjektit mbi provueshmërinë e burimit të ligjshëm të të ardhurave të krijuara nga punësimi në dy shoqëritë e tjera "N." sh.p.k. dhe "A.S." sh.p.k., trupi gjykues arsyeton në të njëjtën linjë si më sipër për sa i përket disa fakteve që marrin vlerë për sa pretendohet nga subjekti dhe më konkretisht:

(i) deklarimin e subjektit në ILDKPKI, në kohë reale për të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti si punëmarrës në këto shoqëri; (ii) deklarimin e marrëdhënies kontraktore po në kohë reale; (iii) faktin se sipas parashikimeve kontraktore nënkuptohet që punëmarrësi ka përfituar të ardhurat nga paga sipas kontratave të punës, i janë bërë ndalesat përkatëse mbi pagën bruto dhe për sa kohë nuk u administrua asnjë dokument që të provonte prishjen e kontratave në mënyrë të njëanshme apo gjyqësisht, indirekt vlerësohet se ato i kanë prodhuar efektet e veta dhe se sikurse u citua më sipër përgjegjësia ka qenë mbi punëdhënësin përderisa nuk u provua marrja dijëni e punëmarrësit mbi mospagimet e detyrimeve në favor të tij; (iv) faktin se në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 8438/1999, *burimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës se ushtruar* dhe nenit 8 që përcakton se merren si të ardhura pagat dhe shërbimet e tjera, në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës, këto të ardhura duhet të konsiderohen të tatueshme dhe agjenti i mbajtjes së tatimit, sipas përcaktimit të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, është personi të cilit sipas legjislacionit tatimor i kërkohet të llogarisë, të mbajë tatimin në burim për një tatimpagues, të raportojë dhe ti transferojë këto tatime në buxhetin e Shtetit, duhet ti aplikohet sanksioni për kundërvajtjen administrative të kryer nga ana e tij dhe njëkohësisht të përmbushë pagesën e detyrimit tatimor; (v) faktin se nga provat e administruara rezulton se është përcaktuar paga që do të përfitonte punëmarrësi; (vi) faktin se është punëdhënësi ai që ka detyrimin për deklarimin, evidentimin, mbajtjen dhe derdhjen e detyrimeve si për tatimin mbi të ardhurat personale ashtu dhe të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore; si dhe (vii) faktin që subjekti ka reaguar me padi gjyqësore ndaj

punëdhënësve dhe se për to gjykata deri në përfundim të këtij hetimi nuk ka rezultuar që gjykata të ketë mbërritur në një vendimarrje.

- ✓ Trupi gjykues, nën këto argumente çmon se duke i qëndruar konkluzionit se për efekt të këtij vlerësimi, provueshmëria e burimit të ligjshëm të të ardhurave të përfituara, vijoi të mbetet në nivel deklarativ, parë nën dritën e objektivitetit, dhe proporcionalitetit, për sa kohë çështjet janë ende objekt gjyqësor, vlerëson se zgjidhja përfundimtare do të ishte e parakohshme.

Edhe pse duke moslogaritur në analizë financiare këto të ardhura, trupi gjykues konstaton se balanca negative shtrihet vetëm në vitin 2008 dhe pasqyron relativisht vlerë të ulët, që për nga pikëpamja e vlerësimit tërësor nuk merr peshë.

Në përfundim, për këtë pasuri, trupi gjykues vlerëson se subjekti:

- ✓ Ka kryer deklaram të saktë dhe ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie.
- ✓ Ka burime financiare të ligjshme për krijimin e saj për vitet 2006 – 2009, pavarësisht balancës negative prej 143.348 lekësh të rezultuar në vitin 2008, vlerë kjo që nëse do të përfshiheshin të ardhurat nga punësimi në shoqëritë për të cilat është ngritur padi gjyqësore, subjekti do të gjendej në balancë pozitive.

3. Apartament banimi me sipërfaqe 105,18 m², i ndodhur në Rr. “****” Tiranë, i porositur me kontratën për prenotim apartamenti nr. ***rep., nr. *** kol., datë 8.7.2016, te shoqëria “M.” sh.p.k. Vlera: 46.000 euro. Pjesa takuese: 50 %. Burimi i krijimit: të ardhura nga puna e bashkëshortit.

3.1 Subjekti në deklaratën *Vetting* për këtë pasuri ka sqaruar: “*Bashkëshorti ka lidhur kontratën e projektimit të datës 13.1.2015 me shoqërinë ‘****’ sh.p.k. me objekt kryerjen e studimit, projektit konstruktiv, etj., për kompleksin ku ndodhet ky apartament dhe pagesën për realizimin e kësaj kontrate projektimi e ka përdorur për shlyerjen e shumës prej 30.000 euro për këtë apartament të porositur. Ka mbetur pa u shlyer diferenca prej 16.000 euro. Bashkëlidhur po vë në dispozicion dokumentacionin bankar dhe kontratën e prenotimit të apartamentit nr. ***rep., dhe nr. *** kol., datë 8.7.2016.*”

3.2 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin përkatës⁴⁶.

3.3 Konkluzioni i ILDKPKI-së

- Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë për përfitimin e shumës 30.000 euro nga shoqëria “****” sh.p.k. për kryerjen e studimit, projektit konstruktiv, etj.

⁴⁶Kontratë prenotim apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.7.2016; kontratë projektimi nënshkruar në datën 13.1.2015; mandatbankar në “Tirana Bank”, datë 8.7.2016, për transferim të shumës 18.000 euro; mandatbankar pranë “Tirana Bank”, datë 25.5.2016; vërtetim nr. ***rep., datë 13.10.2016; nxjerrje e llogarisë në emër të K.O. pranë “Tirana Bank”, gjatë periudhës 11.5.2016 - 3.10.2016; bilancet vjetore të shoqërisë “****” sh.p.k., të viteve kalendarike 2013, 2014, 2015 dhe 2016 në dosjen e ILDKPKI-së.

- Është e paqartë vlera prej 1 euro/m² e kontratës së projektimit, datë 13.1.2015, ndërmjet “M.” sh.p.k., dhe “****” sh.p.k., me përfaqësues ligjor z. K. O., për projektimin e një kompleksi banimi në Tiranë.

- Është e paqartë marrëdhënia e bashkëshortit me shoqërinë e tij “****” sh.p.k., lidhur me kreditimin në favor të tij të shumës 7.750 euro, datë 25.5.2016 dhe të shumës 18.000 euro, datë 8.7.2016, me përshkrimin “kalim fondi tek pronari, hua”.

- Subjekti nuk ka deklaruar në rubrikën e “detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” të deklaratës së interesave private “periodike vjetore 2016” dhe deklaratës *Vetting*, të detyrimit financiar ndaj shoqërisë “M.” sh.p.k., në vlerën 16.000 euro.

3.4 Komisioni gjatë hetimit ka konstatuar se subjekti e deklaroi këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 me përshkrimin: *“porositur apartament banimi i ndodhur në Rr. ****, Tiranë, me sipërfaqe 105.18 m², në vlerën 46.000 euro”*.

3.5 Kjo pasuri konfirmohet me kontratë prentim apartamenti⁴⁷ nr. ****rep., nr. ****kol., datë 8.7.2016, me sipërmarrës shoqërinë “M.” sh.p.k., dhe porositës z. K.O. . Vlera: 46.000 euro.

3.6 Agjencia Shtetërore e Kadastrës, konkretisht: Drejtoria Vendore Kamzë, Vorë⁴⁸; Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1⁴⁹; Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2⁵⁰; Drejtoria Vendore Tirana Veri⁵¹; Drejtoria Vendore Tirana Jug⁵², nuk konfirmojnë pasuri në emër të subjektit të rivlerësimit apo të bashkëshortit.

3.7 Sipas kontratës së prentimit likuidimet janë parashikuar, si më poshtë:

- kësti i parë prej 12.000 euro, likuiduar në datën 25.5.2016, nëpërmjet “Tirana Bank”;
- diferenca prej 34.000 euro do të likuidohet me marrëveshje midis palëve brenda afatit të mbarimit të objektit.

3.8 Gjatë hetimit ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit është administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë “****” dhe se me shoqërinë “M.” sh.p.k., ka lidhur një kontratë projektimi⁵³, datë 13.1.2015, me afat 1-vjeçar. Vlera për projektin për fazën e projektzbatimit është parashikuar të jetë 1 euro/m² me TVSH. Më pas ky akt është shoqëruar edhe nga një aneks kontratë projektimi⁵⁴ e datës 3.2.2017 ku është përcaktuar saktë edhe vlera totale e kontratës prej 46.000 euro.

3.9 Shoqëria e bashkëshortit të subjektit me anë të 3 faturave ka faturuar të gjithë vlerën e kontratës, ndërsa shoqëria “M.” sh.p.k., ka likuiduar vetëm 2 prej tyre në shumën 30.000 euro.

3.10 Bashkëshorti i subjektit, për të likuiduar blerjen e këtij apartamenti, ka përfituar shumën 30.000 euro nga shoqëria “****” sh.p.k. dhe me këtë shumë ka likuiduar shoqërinë “M.” sh.p.k., për kontratën e prentimit të apartamentit.

⁴⁷ Aneks 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së

⁴⁸ Shkresë nr. ****prot., datë 6.6.2019.

⁴⁹ Shkresë nr. ****prot., datë 14.6.2019.

⁵⁰ Shkresë nr. ****prot., datë 18.6.2019.

⁵¹ Shkresë nr. ****prot., datë 17.6.2019, dhe shkresë nr. ****prot., datë 19.6.2019.

⁵² Shkresë nr. ****prot., datë 15.7.2019.

⁵³ Shkresë nga “M.” sh.p.k., datë 15.10.2019, së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur.

⁵⁴ Depozituar nga subjekti i rivlerësimit me pyetësorin nr. 3, datë 4.10.2019, në dosjen e Komisionit.

3.11 Pagesat janë kryer, si më poshtë:

- në datën 25.5.2016 është likuiduar shuma 12.000 euro;
- në datën 8.7.2016 është likuiduar shuma 18.000 euro.

3.11.i Në total rezultojnë të jenë paguar 30.000 euro dhe se për këtë pasuri, ka mbetur si detyrim ndaj firmës ndërtimore “M.” sh.p.k., diferenca prej 16.000 euro.

3.12 Komisioni hetoi mbi burimin e ligjshëm të këtyre shumave, duke mbajtur korrespondencë me institucionet financiare (bankat), si dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

3.12.i Nga *statement* bankar i “Tirana Bank”⁵⁵ në llogarinë personale të bashkëshortit rezultojnë transaksionet e mëposhtme:

- në datën 25.5.2016 janë transferuar 4.250 euro nga “****” me përshkrimin: *pagesë dividendi për 2013*;
- në datën 25.5.2016 janë transferuar 7.750 euro nga “****” me përshkrimin: *kalim fondi te pronari hua*;
- në datën 8.7.2016 janë transferuar 18.000 euro nga “****” me përshkrimin: *kalim fondi te pronari hua*.

3.12.ii Në lidhje me shumën 4.250 euro, si pagesë e dividendit për vitin 2013, Komisionit gjatë hetimit i rezultoi se shoqëria “****” sh.p.k. ka paguar nga llogaria e saj në BKT⁵⁶ në datën 30.7.2014, për zyrën e tatim taksave, shumën 66.694 lekë, me përshkrimin tatim mbi *dividend* për vitin 2013. Në bazë të tatimit të paguar, shuma që duhet të përfitonte ortaku si e ardhur nga dividendi është në vlerën 600.244 lekë. Pavarësisht se tatimi është paguar në vitin 2014, shpërndarja e dividendit është bërë në vitin 2016 dhe ky detyrim prej 600.244 lekë ndaj ortakut është pasqyruar edhe në pasqyrat financiare⁵⁷ të vitit 2014, 2015 dhe 2016.

3.12.iii Në lidhje me shumat 7.750 euro dhe 18.000 euro si hua ndaj pronarit (bashkëshorti i subjektit), nga analizimi i pasqyrave financiare të shoqërisë “****” sh.p.k. rezulton se në pasqyrat financiare të vitit 2016, në pasqyrën e aktiveve, *zëri të drejta dhe detyrime ndaj ortakut*, pasqyrohet shuma 4.582.173 lekë, që janë huat e pronarit ndaj shoqërisë.

- Nën konstatimet e mësipërme në raport me dokumentacionin provues, deklaratimet e subjektit në deklaratën periodike dhe në pyetësor, trupi gjykues arrin në konkluzion se:

- ✓ Të ardhurat e përfituara në shumën 30.000 euro nga 3 transaksionet e kryera nga shoqëria “****” sh.p.k. gjatë vitit 2016, për llogari të bashkëshortit të subjektit janë krijuar me burime të ligjshme.
- ✓ Nga analiza financiare e kryer për vitin 2016 nuk kanë rezultuar problematika, pasi pothuajse e gjithë shuma e paguar për këtë pasuri është marrë hua.
- ✓ Subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe të plotë lidhur me ekzistencën e kësaj pasurie, si dhe ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të saj.

⁵⁵ Shkresë nr. ***prot., datë 28.5.2019.

⁵⁶ Shkresë nr. ***prot., datë 9.10.2019.

⁵⁷ Shkresë nr. ***prot., datë 13.6.2019, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.

Mbi të ardhurat e përfituara nga punësimi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në shoqëri të ndryshme, i deklaruar si burimi kryesor i krijimit të pasurive në deklaratën Vetting

4. Komisionit, për shkaqet dhe arsyet e sipërpërmendura në hetim të burimit të ligjshëm të të ardhurave nga punësimi për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, fillimisht në rezultatet e hetimit, i rezultuan diferenca të konsiderueshme mes deklarimeve periodike dhe konfirmimit zyrtar nga ISSh-ja lidhur me pagesat e kontributeve dhe organet tatimore. Në të tilla kushte, subjektit iu kalua barra⁵⁸ e provës: (i) dukej se kishte mospërputhje midis shumës së të ardhurave të deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike vjetore të përlogaritura në shumën 16.862.049 lekë, me shumën e të ardhurave të konfirmuara për të cilat rezultoni të paguara detyrimet tatimore në shumën 1.805.842 lekë; (ii) dukej se nuk provohej me dokumentacion justifikues burimi i ligjshëm i shumës prej 15.002.927 lekësh, si diferencë e krijuar mes të ardhurave të deklaruara dhe atyre të konfirmuara, për të cilat ishin paguar detyrimet tatimore; (iii) dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 6.976.837 lekë për investimet e kryera në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, përgjatë viteve 2004 – 2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, në parashtrimet e saj, ka kundërshtuar balancën negative, ka dhënë shpjegime mbi të ardhurat e punësimit të bashkëshortit të saj për secilin punëdhënës duke sqaruar mbi ligjshmëritë e tyre, ka kryer rilogaritje dhe ka pasqyruar analiza financiare, si dhe ka depozituar dokumentacion që kryesisht është cituar dhe argumentuar më sipër në hetimin e burimit të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme.

Më konkretisht ka parashtruar, si vijon: *“Në lidhje me punëdhënësin ‘E.-C. G.’ sh.p.k. të ardhurat e deklaruara në deklaratat periodike vjetore për pagën nga ky subjekt në shumën e 576.000 lekë i referohen të ardhurave nga paga bruto dhe jo përfitimit të pagës neto, ndërkohë nga ana e Komisionit në tabelën nr.10 shuma e përfituar nga kjo shoqëri në masën e 302.592 lekë i referohet të ardhurave neto nga paga të realizuara nga ky subjekt. Për këtë arsye Komisioni në tabelën nr. 9 në vlerësimin tim duhet të ndryshojë shumën 576.000 lekë me shumën neto të pagave që i korrespondojnë kësaj të ardhure në vlerën bruto të saj.*

Për punëdhënësin ‘P. A.’ sh.p.k. nga ana e bashkëshortit tim në deklaratën individuale vjetore të të ardhurave të vitit 2011 janë deklaruar të ardhurat bruto nga paga për periudhën 1.1.2006 – 31.8.2008, në shumën 3.037.512 lekë të pagës neto 2.560.000 leke në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë dhe pagesën e detyrimit për TAP (tatimin mbi të ardhurat personale) në shumën 252.137 lekë.

*Kjo shumë, së bashku me detyrimet për gjokat dhe interesat, i është paguar në llogarinë personale me nr. *** në BKT nga administratori dhe ortaku i shoqërisë ‘P.A.’ sh.p.k. bashkëshortit tim dhe në kuptim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 përbëjnë të ardhura të ligjshme, të tatuara dhe në zbatim të paragrafit 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës këto*

⁵⁸ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafët 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

janë të ardhura të ligjshme, që burojnë nga një marrëdhënie e ligjshme siç është ajo e punësimit dhe duhet të merren në analizë nga ana e Komisionit.

Për këtë fakt ju vë në dispozicion deklaratën individuale vjetore të të ardhurave për vitin 2011, transfertën bankare datë 15.11.2019, ku pasqyrohet fakti që z. A. N. ka transferuar shumën e detyrimit tatimor në llogarinë personale të bashkëshortit tim pranë BKT-së Tiranë, urdhërpagesën e tatimit mbi të ardhurat individuale të vitit 2011 të datës 15.11.2019, të paguar pranë 'Credins Bank' nga bashkëshorti im, shtetasi K.O. .

Në lidhje me subjektin E. M., Person Fizik, sqaroj se për bashkëshortin tim, nga ky subjekt, është paguar tatimi në burim mbi të ardhurat personale për periudhën 2008 – 2012, në shumën 5.125.653 lekë neto, duke zbritur tatimin në burim të mbajtur nga këto të ardhura. Për këtë fakt ju vë në dispozicion shkresën me nr. ***prot., datë 11.11.2019, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, ku pasqyrohet ky fakt. Në lidhje me konstatimet që nuk janë respektuar parashikimet e nenit 118 të Kodit të Punës sqaroj se ashtu sikurse kam sqaruar edhe më lart nuk është një marrëdhënie pune, por është shërbim që është ofruar nga bashkëshorti im.

Në lidhje me punëdhënësin 'E.-C.G.' sh.p.k. të ardhurat e deklaruara në deklaratat periodike vjetore për pagën nga ky subjekt në shumën e 576.000 lekë i referohen të ardhurave nga paga bruto dhe jo përfitimit të pagës neto, ndërkohë nga ana e Komisionit, në tabelën nr. 10 shuma e përfituar nga kjo shoqëri në masën 302.592 lekë i referohet të ardhurave neto nga paga të realizuara nga ky subjekt. Për këtë arsye, Komisioni, në tabelën nr. 9 në vlerësimin tim duhet të ndryshojë shumën 576.000 lekë me shumën neto të pagave që i korrespondojnë kësaj të ardhure në vlerën bruto të saj.

Në lidhje me punëdhënësin '***' nga ana e Komisionit është konstatuar se të ardhurat neto nga paga, të deklaruara në deklaratat periodike vjetore nga ana ime janë në shumën 680.300 lekë, ndërkohë Komisioni pasqyron në tabelën nr. 10 të ardhura nga paga neto në shumën e 510.346 lekë. Sqaroj se që prej muajit tetor të vitit 2013 deri në muajin dhjetor të vitit 2016, paga bruto mujore e deklaruar nga kjo shoqëri për bashkëshortin tim është në shumën 22.000 lekë, që i korrespondon një page neto në shumën 19.536 lekë. Të ardhurat e tatueshme bruto për këtë periudhë janë në vlerën 858.000 lekë, që i korrespondojnë të ardhurave neto nga paga në vlerën e 761.904 lekë. Për këtë arsye, ndërmjet tabelave nr. 9 dhe nr. 10 në vlerësimin tim nuk duhet të ketë diferencë ndërmjet të ardhurave të deklaruara me të ardhurat e tatueshme për këtë periudhë kohe. Siç rezulton edhe nga tabelat nr. 9/1 dhe nr.10/1, shuma e të ardhurave të deklaruara nga ana ime në deklaratat periodike vjetore dhe provat e tjera të paraqitura është 16.079.937 lekë dhe shuma e të ardhurave të konfirmuara për të cilat janë paguar detyrimet tatimore është 13.764.934 lekë dhe jo 1.805.842 lekë siç është konkluduar nga hetimi administrativ.

Diferenca për të cilën nuk provohet pagimi i detyrimeve të sigurimeve shoqërore shëndetësore dhe detyrimet tatimore është 2.315.003 lekë dhe jo 15.002.927 lekë siç konstatohet nga Komisioni, si diferencë e krijuar ndërmjet të ardhurave të deklaruara dhe atyre të konfirmuara, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Diferenca 2.315.003 lekë rezulton të jetë nga të ardhurat nga pagat që bashkëshorti im ka realizuar në punëdhënësit 'N.' sh.p.k.,

‘A.-S.’ sh.p.k., ‘A. R.’ sh.p.k. dhe pjesërisht ‘E. C.’ sh.p.k., me cilësinë e drejtuesit teknik në këto shoqëri.

Referuar analizës financiare për mundësitë financiare për periudhën 2004-2016 rezulton se kam pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për investimet në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, përveç viteve 2008 që rezulton -141,621 lekë dhe 2011 që rezulton -80,151 lekë. Pamundësia financiare që rezulton në vitet 2008 dhe 2011 ekziston pasi janë marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e ligjshme për të cilat janë paguar detyrimet tatimore përkatëse.

Edhe nëse e marrim të mirëqenë këtë analizë financiare, e cila është në vlerë totale -221.772 lekë në 15 vite punë, këto diferencë janë të papërfillshme në raport me të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, ju bëj me dije se shpenzimet jetike dhe shpenzime TIMS sipas ILDKPKI-së nuk janë një vlerë fikse dhe absolute, por janë të përafërta dhe mesatare.”

Mjafton që shpenzimet jetike sipas ILDKPKI-së, në vlerën 409.860 lekë dhe shpenzime TIMS në vlerën 194.628 lekë, në vitin 2008 të ulen në masën me 25 % vlera negative 143.348 lekë zerohet dhe subjekti del me vlerë pozitive. Edhe në vitin 2011 mjafton që shpenzimet jetike sipas ILDKPKI-së, në vlerën 546.480 lekë dhe shpenzime TIMS në vlerën 73.437 lekë, në vitin 2011 të ulen në masën me 15 % vlera negative -80,151 lekë zerohet dhe subjekti del me vlerë pozitive.

Subjekti, në shpjegimet e saj, i është referuar edhe arsytimit të vendimeve⁵⁹ të formës së prerë të Komisionit lidhur me balancat negative të konstatuara në shuma të papërfillshme.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues ka argumentuar gjerësisht mbi ligjshmëritë e krijimit të të ardhurave nga punësimi i bashkëshortit të subjektit në pasuritë e sipërpërmendura, për shkak se, sikurse është cituar edhe më sipër janë krijuar nga punësimi i subjektit të rivlerësimit dhe kryesisht nga punësimi i bashkëshortit të saj.

Për këtë arsye, trupi gjykues nuk vlerëson të ripërsëritet për secilën prej marrëdhënies kontraktore, duke pasqyruar konkluzionet specifike në bazë edhe të argumentimeve të lartpërshkruara, të cilat konsiderohen si të përfshira në vlerësimin e përgjithshëm të problematikave në analizë.

Konstatimi i Komisionit, në rezultatet e hetimit administrativ, ka pasur vlerë të caktuar deri në riçeljen e hetimit, pasi me njohjen dhe vlerësimin e rrethanave dhe provave të reja të depozituara, nga rillogaritjet e kryera, trupi gjykues konstatoi se mospërputhjet midis shumës së të ardhurave të deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike vjetore të përlllogaritura në shumën 15.902.049 lekë⁶⁰ për vitet 2006 – 2016 dhe atyre të konfirmuara në vlerën 9.180.049 lekë, rezultuan vetëm në shumën 6.722.000 lekë, për shkak se pjesa tjetër u ligjërua nga konfirmimi i pagimit të detyrimeve tatimore përkatëse. Kjo diferencë vjen kryesisht për: (i) faktin se subjekti, në deklaratat periodike për shoqërinë private të bashkëshortit, ka deklaruar

⁵⁹Vendimi nr. 91, datë 20.12.2018; vendimi nr. 153, datë 7.6.2019 ; vendimi nr. 188, datë 24.7.2019.

⁶⁰ Janë zbritur të ardhurat nga paga e vitit 2005 në shumën 960.000 lekë për bashkëshortin, pasi subjekti ka lidhur martesë më 30.12.2005, sipas certifikatës së martesës.

si të ardhur edhe fitimin e realizuar nga kjo shoqëri, por realisht fitimi i realizuar nuk mund të konsiderohet si e ardhur për sa kohë që nuk rezulton që të jetë shpërndarë dividend. Trupi gjykues ka përfshirë në të ardhurat e realizuara vetëm dividendin e shpërndarë nga shoqëria e bashkëshortit në vitin përkatës, i cili është konfirmuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, bilancet e shoqërisë si edhe nga *statement* bankar; si dhe nga (ii) mospërfshirja në analizë e të ardhurave të realizuara nga shoqëritë, për të cilat subjekti ka ngritur padi gjyqësore. Në këtë rrjedhë logjike u provua me dokumentacion justifikues edhe burimi i ligjshëm i shumës prej 9.180.049 lekësh si diferencë e krijuar mes të ardhurave të deklaruara dhe atyre të konfirmuara për të cilat ishin paguar detyrimet tatimore.

Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzion se:

- ✓ Subjekti, në tërësi, ka pasur mundësi financiare për të mbuluar investimet e kryera në pasuri të paluajtshme apo të luajtshme përgjatë viteve 2004 – 2016, si dhe ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të tyre, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Balanca negative e shpërndarë në katër vjet, përkatësisht: në vitin 2008 në shumën 143.348 lekë; në vitin 2011 në shumën 280.151 lekë; në vitin 2013 në shumën 19.153 lekë; si dhe në vitin 2015 në shumën 316.903 lekë, për të cilën/at, trupi gjykues, - duke mbajtur në vëmendje dhe aplikuar parimin e proporcionalitetit, - çmon se ato nuk janë të mjaftueshme për të aplikuar ndonjë masë, sipas nenit 61 (3) të ligjit nr.84/2016.

5. Llogari depozitë bankare në “Bankën Kombëtare Tregtare” (BKT), nr. i llogarisë * (nr. reference***). Vlera: 2.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %. Burimi i krijimit: të ardhura nga puna e bashkëshortit dhe kursime nga paga e subjektit në shumën 500.000 lekë.**

5.1 Subjekti, për këtë pasuri në deklaratën *Vetting*, ka sqaruar: “*Me vendimin nr. 3060, datë 23.11.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur detyrimin e Komunës Rrashbull për pagimin e shumës prej 3.625.365,13 lekësh, paditësve K.O. dhe E.M. . Kjo shumë është vlera e punës së tyre për projekt-zbatimin për veprën ‘Rikonstruksion i rrugës Kryqëzimi i Vrinas-Rruga e Fllakës’ dhe në këtë shumë bashkëshorti im ka përfituar 50 % të saj (1.812.683 lekë) dhe ortaku i tij E. M. ka përfituar 50 % (bashkëlidhur vendimi nr. ***, datë 23.11.2012, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe vërtetimi nr. ***prot., datë 23.1.2017, i përmbauesit gjyqësor S. T. H.).*”

5.2 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin përkatës⁶¹.

5.3 Gjatë hetimit administrativ Komisionit i ka rezultuar se subjekti e deklaroi këtë llogari kursimi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014.

5.4 Komisioni hetoi mbi burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave.

5.5 Subjekti, në datën 2.10.2019, ka depozituar në pyetësin nr. 2 vendimin nr. ***, datë 23.11.2012, të formës së prerë, për përfitimin e shumës 3.625.365,13 lekë nga bashkëshorti K. O. dhe shtetasi E. M. .

⁶¹Vërtetim nr. *** prot., datë 24.1.2017, nga Banka Kombëtare Tregtare; Kontrata e depozitës bankare me Bankën Kombëtare Tregtare, nënshkruar më 30.7.2014; vërtetim nr. *** prot., datë 23.1.2017 nga Zyra e Përmbaimit; vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës administruar në Aneksin nr. 4/4, në dosjen e ILDKPKI-së.

5.6 Nga *statement* i BKT-së, në llogarinë personale të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, rezulton se në datën 12.5.2014 i është transferuar shuma prej 1.500.000 lekësh nga shtetasi E. M. me përshkrimin “pagesë për projektin e rrugës ‘Sh. V.’, marrë me vendim gjykate”.

5.6.i Subjekti është pyetur në lidhje me këtë transaksion dhe, në përgjigjen⁶² e dhënë, ka sqaruar se shuma e depozituar është si rezultat i ekzekutimit të vendimit gjyqësor të sipërpërmendur, e cila, fillimisht, përmes procesverbalit të nënshkruar nga përmbaruesi gjyqësor, ka kaluar nga llogaria e tij te shtetasi E. M. si një ndër palët ndërgjyqëse së bashku me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit dhe se më pas ky shtetas ka kaluar me transaksion bankar për llogari të z. K. O., shumën prej 1.500.000 lekësh, ndërsa pjesën tjetër prej 312.683 lekësh ia ka dhënë *cash*.

5.7 Gjithashtu, në po të njëjtën llogari z. K.O. i është transferuar, në datën 23.7.2014, shuma prej 500.000 lekësh nga subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), me përshkrimin “transferim fondi brenda familjes”. Llogaria nga e cila janë transferuar fondet është një llogari page në “Raiffeisen Bank”, ku gjatë hetimit për të nuk kanë rezultuar dyshime.

5.8 Këto shuma, në total prej 2.000.000 lekësh, në datën 30.7.2014 janë investuar në depozitë me afat 5-vjeçar.

5.9 BKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 11.6.2019 konfirmon depozitën bankare në shumën 2.000.000 lekë.

✓ Për sa më sipër, trupi gjykues konstaton se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e administruar nga banka.

6. Llogari bankare në “Raiffeisen Bank” me nr. klienti ***. Vlera: 149.209,38 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i krijimit: të ardhura nga puna (bashkëlidhur formulari i nxjerrjes së llogarisë i datës 20.1.2017, i “Raiffeisen Bank”, dega Durrës).

6.1 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrjen e llogarisë në emër të znj. Enkeleda Osmani (Xhengo) në “Raiffeisen Bank”, për periudhën 1.1.2016-31.12.2016. Gjendja në llogari rezulton në shumën 149.209 lekë.

6.2 Komisioni, nga analizimi i dokumentacionit të administruar nga “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 27.5.2019, ka konstatuar se në emër të znj. Enkeleda Osmani (Xhengo) konfirmohet llogari page me gjendje në datën 26.1.2017, në shumën 120.585,38 lekë.

✓ Në analizë të dokumentacionit të administruar, trupi gjykues vëren se ndryshimi i gjendjes vjen për shkak se deklarimi i subjektit i referohet gjendjes së datës 31.12.2016, ndërsa data e dorëzimit të deklaratës *Vetting* i përket datës 26.1.2017 dhe, për pasojë, nuk konstatohen problematika.

7. Automjet tip “Audi A2”, viti i prodhimit 2001, me targa *, blerë nga shtetasi A.S., me kontratën e shitblerjes nr*** rep., nr. *** kol., datë 16.4.2011 (bashkëlidhur kontrata e**

⁶²Referojuni pyetësorit nr. 4, datë 16.10.2019, në dosjen e Komisionit.

shitblerjes së automjetit me nr. ***rep., dhe nr. *** kol., datë 16.4.2011). Vlera: 3.000 euro. Burimi i krijimit: të ardhura nga puna. Pjesa takuese: 100 %.

7.1 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin përkatës⁶³.

7.2 Nga hetimi administrativ ka rezultuar se subjekti e deklaroi këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 me përshkrimin “blerë automjet i tipit ‘Audi A2’, me targa ***, me burim krijimi të ardhurat dhe kursimet. Vlera e mjetit: 3.000 euro.”

7.3 Kjo pasuri konfirmohet me kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.4.2011, me palë shitëse shtetasin A. S. dhe blerës Enkeleda Osmani (Xhengo), në vlerën 3.000 euro.

7.4 DPSHTRr-ja⁶⁴ e konfirmon këtë automjet në pronësi të subjektit të rivlerësimit deri në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, pasi në datën 22.12.2017 automjeti është shitur.

7.5 Komisioni kreu analizën mbi mundësitë financiare të subjektit për të investuar në këtë pasuri. Analiza ka të njëjtin arsyetim me atë të pasurisë nr. 1, pasi ky automjet është blerë vetëm 5 ditë më vonë, sesa apartamenti i detajuar në tabelën nr. 1.

7.6 Duke qenë se për pasurinë e parë subjekti, fillimisht, rezultoi në pamundësi financiare, po ashtu gjendej në të njëjtat kushte edhe për krijimin e kësaj pasurie të luajtshme, meqenëse investimi për blerjen e automjetit ishte kryer vetëm 5 ditë më vonë, nga blerja e apartamentit/pasuria nr. 1, duke mos pasur asnjë ndryshim në të ardhurat familjare përveçse këtij shpenzimi dhe, për pasojë, subjektit iu kalua barra⁶⁵ e provës se dukej se nuk kishte pasur mundësi financiare për të blerë automjetin në shumën 3.000 euro ose 414.900 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, në parashtrimet e saj, ka sqaruar se: “... me paraqitjen e provave në pasurinë nr. 1, ku kam analizuar aftësinë pagueuse dhe mundësinë financiare duke cituar dhe provat e reja për kohën që bashkëshorti kryente shërbime për shtetasin E. M., Person Fizik, referuar faktit se krahas marrëdhënieve kontraktuale ka pasur edhe marrëdhënie shoqërore, të cilat datonin që prej kohës kur bashkëshorti dhe shtetasi E. M. kanë qenë miq fakulteti, banojnë në të njëjtin pallat dhe në të njëjtën hyrje (por, aktualisht, është emigrant në SHBA) dhe në biseda ai ka shprehur idenë që donim të blinim një automjet, por ishim në pamundësi financiare, ai ka propozuar parapagimin e të ardhurave nga shërbimi që bashkëshorti im do të kryente në lidhje me projektet që do duhej të realizonin gjatë kësaj kohe (E. kishte marrë përsipër realizimin e tyre me subjekte të ndryshëm dhe, konkretisht, projekti për subjektin porositës shoqërinë ‘***’ sh.p.k., objekt 5 kat+1 kat nëntokë dhe projekti për subjektin porositës shoqërinë ‘L.’ sh.p.k. – godinë banimi dhe shërbimesh 7+9 kate dhe 1 kat nëntokë, të konfirmuara këto projekte nga Komuna Kashar me shkresën nr. *** prot., datë 19.6.2019 dhe Njësia Administrative Dajt me shkresën nr***prot., datë 25.6.2019) dhe kështu ka ndodhur.

⁶³Kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. ***kol., datë 16.4.2011, administruar në Aneksin nr. 4/6, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶⁴ Shkresë Nr. ***prot., datë 31.05.2019

⁶⁵ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafët 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Pra, pagesa që unë kam kryer në lidhje me blerjen e këtij automjeti i është dhënë parapagim, cash, bashkëshortit tim nga shtetasi E. M. . Në lidhje me këtë fakt unë ju vë në dispozicion pasqyrën e llogarisë personale të datës 13.4.2011, ku pasqyrohet fakti se E. M. i ka dhënë parapagim në lidhje me shërbimet që do të kryente K. O. shumën prej 500.000 lekë.

*Për periudhën dhjetor-mars 2011, bashkëshorti im ka përfituar të ardhura nga subjekti E. M., Person Fizik, me NIPT ***, pagat për-muaj, shpërblimin në vlerën 300.000 lekë, që pas marrjes së këtij shpërblimi ne vendosëm të blinim edhe apartamentin në Golem dhe parapagimin për të ardhurat mujore në vlerën 500.000 lekë. Nga referimi që E. M. i bën bashkëshortit, detyrimi për tatimin në burim për të gjitha të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti im është paguar brenda periudhës që ne kemi përfituar këto të ardhura.*

Referuar ligjit nr. 8438, 'Për tatimin mbi të ardhurat personale' dhe udhëzimit nr. 5, përcaktohet se çdo subjekt, i cili kryen pagesat e parashikuara në nenin 33 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, 'Për tatimin mbi të ardhurat' i ndryshuar, deklaron dhe paguan tatimin e mbajtur në burim, në masën e përcaktuar në legjislacionin e kohës së shumave bruto të pagesave, deri në datën 20 të muajit që pason muajin e pagesës. Përmbushja e pagesës së kryer nga E.M., Person Fizik, në periudhën që referon ai, tregon faktin se bashkëshorti ka përfituar në mënyrë të ligjshme të gjithë shumën e të ardhurave të realizuara në këtë periudhë kohore."

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues vlerëson të mos përsëritet në vlerësimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklaramit të kësaj pasurie dhe burimit të ligjshëm të krijimit të saj, pasi ka arsytuar gjerësisht në provueshmërinë e të ardhurave të siguruara nga puna e bashkëshortit të subjektit në pasurinë e parë, burime për të cilat u provua plotësisht ligjshmëria e tyre dhe që impaktojnë po ashtu edhe në blerjen e kësaj pasurie të luajtshme. Por në këtë vlerësim, trupi gjykues shton edhe argumentin tjetër, sikurse ka cituar po në pasurinë e parë, i cili ka të bëjë me pagat shtesë që ka përfituar bashkëshorti i subjektit në shoqërinë "E.S. E. M.", në vitin 2011. Konkretisht, trupi gjykues në përlllogaritjet financiare sikurse përfshiu në analizë në pasurinë nr. 1, shumën e të ardhurave shtesë në masën 400.000 lekë, për të cilën rezultoi se ishte paguar tatimi në burim edhe në analizën financiare të kësaj pasurie duke përdorur të njëjtin arsyetim përfshin shumën prej 500.000 lekësh, të përfituar nga subjekti si e ardhur shtesë mbi pagë, pikërisht përpara krijimit të kësaj pasurie.

Trupi gjykues ka argumentuar në detaje në pasurinë nr. 1, arsyen e marrjes në konsideratë të këtyre shumave, pikërisht, në muajt e parë të vitit 2011 dhe, për këtë shkak, nuk çmon të përsëritet më tej.

- ✓ Në kushte të tilla, trupi gjykues çmon se subjekti, ka kryer deklaramit të mjaftueshëm lidhur me këtë pasuri dhe burimin e krijimit të saj, ka pasur mundësi financiare, si dhe ka provuar burimin e ligjshëm të blerjes së automjetit.

8. Automjet tip “Audi A4”, viti i prodhimit 2002, me targa *, blerë nga shtetasi N. Z., me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. ***kol., datë 27.9.2013. Vlera: 400.000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhura nga shitja e automjetit me targa ***, si dhe kursime nga puna.**

8.1 Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, por vetëm në deklaratën *Vetting*.

8.2 Kjo pasuri konfirmohet me kontratë shitblerjeje automjeti⁶⁶ nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.9.2013, me palë shitëse shtetasin N.Z. dhe blerës shtetasin K. O., në vlerën 400.000 lekë.

8.3 Me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.2.2013 konfirmohet shitja e automjetit me targa ***, në shumën 3.000 euro me palë shitëse shtetasin K. O. (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit) dhe palë blerëse shtetasin L. S..

8.4 DPSHTRr-ja e konfirmon automjetin tip “Audi A4” në pronësi të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, si dhe shitjen e automjetit me targa ***.

8.5 Komisioni kreu analizën financiare, nga ku: (1) dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 19.153 lekë për të blerë automjetin dhe për të përballuar shpenzimet familjare; (2) dukej se subjekti kishte kryer deklaram të pasaktë, pasi në deklaratën periodike të vitit 2013 nuk kishte deklaruar blerjen e këtij automjeti, por e kishte deklaruar atë vetëm në deklaratën *Vetting*; dhe se (3) dukej se subjekti kishte kryer deklaram të pasaktë, pasi në deklaratën periodike të vitit 2013 nuk kishte deklaruar shitjen e automjetit me targa ***, të ardhura të deklaruara se i ka përdorur si burim krijimi për këtë pasuri, por e kishte deklaruar këtë shitje vetëm në deklaratën *Vetting* dhe, për pasojë, iu kërkua të japë shpjegime për pikën 2 dhe 3.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti në parashtrimet e saj është shprehur se: *“Konstatimi i Komisionit është i drejtë lidhur me mosdeklarimin e blerjes së automjetit të tipit ‘Audi A4’, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, nga shtetasi N. Z., me kontratën e shitblerjes nr. ***rep., nr. *** kol., datë 27.9.2013, në vlerën 400.000 lekë dhe shitjen e automjetit me targa ***me kontratën e shitblerjes nr***rep., nr. *** kol., datë 14.2.2013, në shumën 3.000 euro me palë shitëse shtetasin K.O. (bashkëshorti im) dhe palë blerëse shtetasi L. S. . Kjo ka ndodhur për shkak të harresës dhe përpilimit të deklaratës periodike vjetore në momentin e fundit.*

*Referuar faktit se të dyja këto veprime juridike, të kryera nga bashkëshorti im, i kam deklaruar në deklaratën *Vetting* (e cila përbën dokument zyrtar në referim të parashikimeve të ligjit nr. 84/2016) kjo është një harresë nga ana ime në lidhje me deklaratën e vitit 2013, pasi ato janë veprime që janë kryer përpara një noteri, të ligjshme, të dorëzuara në DPSHTRr Tiranë dhe dihet botërisht që këto veprime (shitblerja e automjeteve të kryera brenda të njëjtit vit financiar 2013) janë të aksesueshme nga kushdo. Gjithashtu, në mbështetje të parashtrimeve kam referuar vendime⁶⁷ të formës së prerë të Komisionit dhe të paankimuar nga Komisioneri, ku analizohet mosdeklarimi dhe fshehja e pasurisë. Nga analiza financiare sipas prapësimeve të mia, duke marrë në konsideratë ndryshimin e likuiditetit sipas deklarimeve të mia -98,385 jo*

⁶⁶ Aneks nr. 4/9, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶⁷ Vendimi nr. 49 datë, 25.7.2018.

sipas raportit +351,238 lekë, rezultoj se kam pasur mundësi financiare në shumën +430,464 lekë për të blerë automjetin dhe për të përballuar shpenzimet familjare.

Për më tepër, konstatimi nga ana juaj se nuk kam pasur mundësi për të blerë automjetin tip 'Audi A4' vit prodhimi 2002, me targa *** nuk qëndron, pasi ky automjet është blerë në datën 27.9.2013, në shumën 400.000 lekë me burim krijimi të ardhurat nga shitja e automjetit tip 'Mercedes Benz' me targa ***, në datën 14.2.2013, në shumën 3.000 euro (420.630 lekë)."

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në arsyetimin e këtij konstatimi, fokusohet pikërisht në pikat për të cilat i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime, më konkretisht në mosdeklarimet në deklaratën periodike të vitit 2013 për shitjen e automjetit dhe blerjen e pasurisë së deklaruar në deklaratën *Vetting*. Në këtë kontekst, trupi gjykues, për të provuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve lidhur me këtë pasuri, trajton në harmoni të gjitha të dhënat e grumbulluara. Sigurisht që hetimi paraprihet nga deklarimet në deklaratën *Vetting* dhe në këtë drejtim rezultoi se subjekti ka deklaruar saktësisht pasurinë. Por, në vijim, në raport me këtë deklaram Komisioni verifikon edhe deklaramin e bërë në kohë reale. Duke qenë se pasuritë reciprokisht shitur dhe blerë, nuk ishin pasqyruar në deklaratën periodike, indirekt konstatohet se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në vitin 2013. Duke i lexuar shpjegimet e subjektit në raport edhe me konfirmimin zyrtar të DPSHTRr-së, ku konfirmohen qartësisht nëpërmjet kontratave noteriale, shitja dhe blerja e automjeteve, duke vlerësuar faktin që nga analiza financiare nuk janë evidentuar problematika në vitin 2013, si dhe duke konsideruar deklaramin e bërë në mënyrë të saktë dhe të plotë në deklaratën *Vetting*, trupi gjykues çmon se:

- ✓ Subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën për vitin 2013 lidhur me shitjen e automjetit me targa *** dhe blerjen e pasurisë së deklaruar në deklaratën *Vetting*, automjet tip "Audi A4", viti i prodhimit 2002, me targa ***.

Detyrime financiare

9. Hua e marrë nga prindërit e bashkëshortit. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer në vlerën 5.000 euro. Sqarim: kjo hua është marrë për blerjen e apartamentit në Kashar-Tiranë, siç është sqaruar më sipër.

9.1 Në analizimin e pasurisë nr. 2 në këtë relacion është shpjeguar edhe huaja e marrë nga prindërit e bashkëshortit në shumën 10.000 euro. Gjatë hetimit ka rezultuar se huaja e dhënë provohej me burime të ligjshme.

9.2 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 subjekti deklaroi shlyerjen e shumës 5.000 euro pa deklaruar burimin e saj, si dhe gjendjen e mbetur në vlerën 5.000 euro. Komisioni e ka pyetur subjektin lidhur me burimin e krijimit të kësaj shume për shlyerjen e huas, të marrë nga prindërit e bashkëshortit, nga ku ka deklaruar⁶⁸ se burimi i krijimit të kësaj shume janë të ardhurat e realizuara nga paga e subjektit dhe bashkëshortit në vitin 2012 dhe pakësimi i gjendjes *cash*.

⁶⁸ Pyetësor nr. 2, datë 2.10.2019.

9.2.i Komisionit i ka rezultuar se subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore për vitin 2012 se bashkëshorti ka qenë i punësuar në shoqëritë “A. R.” sh.p.k., me të ardhura vjetore në shumën 576.000 lekë dhe në “E. S.” me të ardhura vjetore në shumën 1.200.000 lekë.

9.2.ii Komisioni hetoi për krijimin e këtyre të ardhurave, duke qenë se informacioni i pasqyruar në vërtetimet e punësimit nuk ishte i plotë. Komisioni iu drejtua Institutit të Sigurimeve Shoqërore me të gjithë listën e shoqërive për të konfirmuar punësimin dhe tatimet e paguara për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit.

9.2.iii ISSH - Drejtoria Rajonale Vlorë⁶⁹ për punëdhënësin “A. R.” sh.p.k., me NIPT ***, ka informuar se u krye verifikimi në Arkivën e DRSSH-së dhe rezulton se: *“Kemi listëpagesa për vitin 2012 janar-dhjetor, por emri nuk figuron”*.

9.2.iv Ndërsa, ISSH - Drejtoria e Arkivit Qendror⁷⁰ për punëdhënësin “E.S.”, me NIPT ***, ka informuar se për periudhat: *“janar - qershor 2011, janar - qershor 2012, tetor - dhjetor 2012 nuk i figuron emri në listëpagesa. Për periudhën korrik - dhjetor 2011, korrik - shtator 2012, deri tani administrojmë të dhëna”*.

9.2.v Gjithashtu, Komisioni kërkoi informacion edhe nga dy shoqëritë punëdhënëse (sipas adresave të pasqyruara në QKB), për të cilat ka administruar kthimin⁷¹ e kërkesës me postë me shënimin “i panjohur”.

9.3 Komisioni kreu analizën e vitit 2012 për të parë mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit për të shlyer këtë pjesë të detyrimit, duke u bazuar në të ardhurat e konfirmuara nga institucionet përkatëse.

Nga analiza financiare dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 479.610 lekë për të shlyer një pjesë të huas dhe për të përballuar shpenzimet e tjera të vitit dhe, mbi këtë konstatim, subjektit iu kalua barra⁷² e provës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, në parashtrimet e saj, ashtu sikurse ka pasqyruar qëndrimin në të gjitha pasuritë e mësipërme edhe në këtë rast ka shpjeguar mbi provueshmërinë e burimit të ligjshëm të të ardhurave të përfituara nga punësimi i bashkëshortit të saj.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të fakteve të konstatuara dhe parashtrimeve të subjektit, arsyeton si vijon:

Nisur nga fakti që subjekti ka deklaruar si burim për shlyerjen e huas të ardhurat nga paga e saj dhe e bashkëshortit, si dhe pakësimin e gjendjes *cash* të siguruar nga një vit më parë, analiza përqendrohet në provueshmërinë e burimit të ligjshëm të të ardhurave të siguruara nga punësimi i bashkëshortit dhe në pakësimin e gjendjes *cash* të pretenduar.

⁶⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 10.10.2019.

⁷⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 12.9.2019.

⁷¹ Protokolluar në Komision me nr***, datë 24.10.2019 për shoqërinë “A. R.” dhe nr. ***, datë 24.10.2019 për shtetasin E. M. .

⁷² Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafët 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Duke qenë se bashkëshorti i subjektit rezulton që në këtë vit kalendarik të ketë qenë i punësuar pranë dy shoqërive dhe, konkretisht, në “ES.E.M.” me të ardhura vjetore në shumën prej 1.200.000 lekësh dhe në “A. R.” sh.p.k., me të ardhura vjetore në shumën 576.000 lekë, trupi gjykues çmon të mos ripërsëritet në vlerësimin e ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, për sa kohë ka detajuar në pasuritë e mësipërme ku janë përdorur pikërisht këto burime financiare. Për rrjedhojë, Njësia e Shërbimit Ligjor kreu rillogaritjet financiare duke përfshirë të ardhurat e bashkëshortit nga shoqëria “E. S.”, pasi u provua burimi i ligjshëm i të ardhurave nëpërmjet tatimit në burim të paguar, si dhe duke përfshirë po ashtu edhe të ardhurat e siguruara nga shoqëria “A.R.” sh.p.k., për shkaqet dhe arsytet e bëra me dije. Ndërsa, në lidhje me pretendimin e përfshirjes në analizë financiare të pakësimit të gjendjes *cash* nga viti i mëparshëm, trupi gjykues ka konkluduar për këtë çështje, më sipër, në këtë vendimmarrje dhe, për pasojë, nuk merr në konsideratë si burim krijimi gjendjen *cash* të pretenduar. Megjithatë, nga analiza financiare subjekti rezulton në balancë pozitive.

Në kushte të tilla, trupi gjykues çmos se:

- ✓ Subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për të shlyer huan në shumën 5.000 euro dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare përgjatë vitit 2012.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (referuar si “DSIK”), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte, nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë 27.10.2017, të deklasifikuar me vendim të KDZH-së nr. ***, datë 31.7.2019 për subjektin e rivlerësimit, ku ka konstatuar se *nga hetimi nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.*

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo).

Komisioni, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të rivlerësimit për kontrollin e figurës, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), arrin nivel të besueshëm, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Raporti i vlerësimit profesional është mbështetur në: formularin e vetëdeklarimit; tri dokumente ligjore të përzgjedhura nga subjekti; të dhëna e dokumente që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosje penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe në të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorive të Rretheve Gjyqësore, etj.

Raporti i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të rivlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- d) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

1. Dokumenti ligjor: kërkesë për sigurim prove, me objekt “pyetjen e bashkë të pandehurit S. (E.) V.”, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “vjedhje me armë e kryer në bashkëpunim” e parashikuar nga nenet 140 dhe 25 të Kodit Penal, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

Ky dokument është përgatitur⁷³ dhe përpiluar në kuadër të procedimit penal nr. *** të vitit 2015, në ngarkim të të pandehurit S. (E.) V., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “vjedhje me armë e kryer në bashkëpunim” e parashikuar nga nenet 140 e 25, të Kodit Penal, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

2. Dokumenti ligjor/diskutim përfundimtar “mbi procedimin penal nr. ***, viti 2013” datë 12.6.2014, i Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Ky dokument është përgatitur⁷⁴ dhe përpiluar në kuadër të procedimit penal nr. 2107 të vitit 2013, në ngarkim të të pandehurve E. V. dhe Th. Ll., të akuzuar për kryerjen e veprave penale “vrasje në rrethana cilësuese”, “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit, në vende publike” dhe “moskallëzim i krimit” të parashikuara nga nenet 79/a/1, 278/4 dhe 300/1 të Kodit Penal.

3. Dokumenti ligjor/kërkesë për gjykimin e çështjes penale me nr. *** të vitit 2016, përgatitur⁷⁵ nga prokurori Enkeleda Osmani (Xhengo), subjekt rivlerësimi, dhënë për të pandehurit V. K., S. S., etj., të akuzuar për veprat penale “prostitucion”, “shfrytëzim të prostitucionit” dhe

⁷³ Për më tepër lidhur me analizimin e çështjes referojuni raportit të KLP-së, në dosjen e Komisionit.

⁷⁴ Për më tepër lidhur me analizimin e çështjes referojuni raportit të KLP-së, në dosjen e Komisionit.

⁷⁵ Për më tepër lidhur me analizimin e çështjes referojuni raportit të KLP-së, në dosjen e Komisionit.

“mbajtje e lokaleve për prostitucion”, parashikuar nga nenet 113/1, 113/2, 114, 115 dhe 25 të Kodit Penal.

➤ **Përshkrimi i pesë dosjeve për prokurorin Enkeleda Osmani (Xhengo), të përzgjedhura me short**

Në lidhje me pesë dosjet në raportin e KLP-së nuk janë evidentuar problematika, ndërsa Komisioni, pas verifikimit të dokumentacionit të administruar, ka vlerësuar të qartësojë disa konstatime që pasqyrohen më poshtë në rivlerësimin profesional.

➤ **Të dhëna nga burime arkivore**

1. Nga verifikimi i të dhënave nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë si dhe të burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme rezulton se subjekti Enkeleda Osmani (Xhengo):

1.1 Nuk ka pasur masa disiplinore.

1.2 Nuk ka të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta.

1.3 Nuk ka të dhëna të dokumentuara (biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike) të përfshirjes së saj në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale).

1.4 Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë me shkresat nr. *** prot., datë 19.4.2019 dhe nr. *** prot., datë 4.4.2019 Prokuroria e Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, është informuar se në ngarkim të subjektit Enkeleda Osmani (Xhengo) janë regjistruar kallëzimet penale, si vijon:

- kallëzim penal nr. ***, datë 1.2.2018, nga shtetasi E. M., për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal në datën 12.2.2018;
- kallëzim penal nr. ***, datë 19.10.2018, nga shtetasi S. H., për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal në datën 5.11.2018;
- kallëzim penal nr. ***, datë 30.4.2019, nga shtetasi A. M., për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal në datën 13.5.2019 dhe kallëzimi penal⁷⁶ nr*** të vitit 2019;
- kallëzim penal⁷⁷ nr. *** të vitit 2018, të shtetasit H. K.;
- kallëzim penal nr. *** të vitit 2018 dhe 13 të vitit 2019, i kryer nga shtetasi F.Ç., për të cilët ka rezultuar se është vendosur “mosfillim i procedimit penal”.

1.5 Sektori Protokoll-Arkiv në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr.***prot., datë 9.5.2019, ka bërë me dije se nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e kallëzimeve dhe procedimeve penale të Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton se ka çështje apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e

⁷⁶ Për analizën e mëtejshme të çështjes referojuni raportit të KLP-së.

⁷⁷ Për analizën e mëtejshme të çështjes referojuni raportit të KLP-së.

ankesave, në mënyrë manuale, për periudhën 2006 – 2019, rezulton se ekziston një ankesë: praktika nr. *** e vitit 2017, nga shtetasi S.H. . Por, nga shkresa bashkëlidhur kësaj praktike rezulton se kjo ankesë i është përcjellë për kompetencë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës në ngarkim të prokurorit A.C. nga shtetasi S. H. . Nga korrespondenca me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, informohet se me këtë numër protokolli, nga Prokuroria e Përgjithshme është përcjellë kallëzimi i bërë nga shtetasi S. H. ndaj prokurorit të Prokurorisë Tiranë z. A. C.. Subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo) ka qenë prokurori i çështjes, e cila ka disponuar me vendim mosfillimi të datës 20.9.2017.

1.6 Pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënive me Publikun ka të dhëna për vlerësimin e punës së këtij prokurori, të kryer nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 42, të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i shfuqizuar si dhe urdhrin nr. ***, datë 19.11.2012, “Për miratimin e rregullores për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”.

Analiza e gjetjeve⁷⁸

Në këtë seksion janë analizuar aftësitë profesionale, aftësitë organizative, etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale për të cilat nuk kanë rezultuar problematika.

C/1 RIVLERËSIMI PROFESIONAL

Komisioni, pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga KLP-ja, dhe dosjeve ku është bazuar ky raport ka konstatuar se:

1. Në lidhje me kallëzimin penal nr. ***, datë regjistrimi 20.4.2015, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, që i përket vendimit “mosfillimi i procedimit penal” (dosja nr.1, që i përket pesë dosjeve të përzgjedhura me short) nuk ka të dhëna nëse është ushtruar ankim në gjyqësor dhe nëse po, çfarë është vendosur. Komisioni, për këtë, i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë aktin përkatës.

1.1 Subjekti ka sqaruar se në lidhje me vendimin e mosfillimit nr. ***, datë 20.4.2015 nuk është ushtruar ankim duke e konfirmuar këtë fakt me shkresën nr. *** prot., datë 3.3.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

2. Për sa i përket vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***, regjistruar në datën 18.10.2012, pasqyruar si dosja nr. 3 (si një ndër pesë dosjet e shortuara), Komisionit i ka rezultuar si vijon:

- Fillimisht kjo çështje është regjistruar pa autor në datën 18.10.2012.

- Pasi është konfirmuar nga DPSHTRr-ja, pronësia e automjetit (me targa ***, e shtetasit E.V.), me të cilin është kryer aksidenti dhe pasi është pyetur edhe shtetasi E.V. (si pronar i automjetit me të cilin është kryer aksidenti), për të dytën herë në datën 17.6.2013, nuk rezultojnë të jenë kryer veprime të tjera në adresë të këtij shtetasi, ndërsa në vendimin e pushimit datë 18.4.2014, ndër të tjera, citohet se “... nga veprimet e sipërcituara ka rezultuar se nga autori i kësaj

⁷⁸Nën këtë titull referojuni raportit të KLP-së.

ngjarjeje janë konsumuar elementët e kundërvajtjes penale të ‘largimit nga vendi i aksidentit’, të parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal dhe se pushimi ka ardhur si rezultat i miratimit të ligjit nr. 22, datë 10.4.2014, “Për amnistinë”.

- Po ashtu, në tërësi, nuk janë kryer veprime hetimore edhe përgjatë katër muajve të parë të vitit 2014 as edhe për të aksidentuarin.

- Megjithëse aktekspertimi “mbi shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor” është realizuar në datën 3.6.2013 dhe shtetasi E.V. është pyetur në datën 17.6.2013, pushimi i çështjes penale nr. ***, viti 2012 ka ardhur vetëm pas rreth 10 muajve.

Për sa konstatohet nga aktet e fashikullit hetimor: (i) se targa e automjetit me të cilin është kryer aksidenti është dhënë nga i aksidentuari prej kryerjes së aksidentit në tetor të vitit 2012; (ii) se pronësia e automjetit është vërtetuar nga DPSHTRr-ja me vënien në dispozicion të praktikës; (iii) se ekspertimi autoteknik i kryer për automjetin sipas pyetjeve të shtruara dhe konkluzioneve të nxjerra mbi shkeljet e konstatuara daton shumë më herët se vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit; (iv) se prej qershorit të vitit 2013 kur shtetasi E. V. është pyetur për të dytën herë dhe të fundit, nuk rezultojnë të jenë kryer hetime të mëtejshme ndaj këtij shtetasi.

Komisioni konkludon se duket se është devijuar kryerja e hetimeve ndaj shtetasit E. V. për një periudhë 10-mujore, qershor 2013 – prill 2014, pa dhënë argumente apo arsye dhe, se për pasojë, duket se veprimet apo mospveprimet kanë ndikuar në favorizimin e këtij shtetasi deri në vendimmarrjen e marrë në zbatim të ligjit “Për amnistinë” dhe, për këtë shkak, i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

2.1 Subjekti, në prapësime, ndër të tjera, ka theksuar se ka ndërmarrë njëmbëdhjetë veprime hetimore ku njëri prej tyre nuk është përfunduar për shkak të mosjelljes së përgjigjes nga shoqëria celulare “****”, kërkesë që i është përcjellë me shkresën me nr. *** prot., datë 27.9.2013, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës. Të gjitha këto hetime janë kryer në funksion të verifikimit të rrethanave që është kryer ngjarja, të verifikimit të deklarimit të shtetasit E.V., si dhe identifikimit të personit që ka njoftuar Sallën Operative për ngjarjen e ndodhur, me qëllim që të pyetjesh për të dhënë fakte apo shpjegime që do të ndikonin në zbardhjen e ngjarjes, identifikimin e autorit dhe gjetjen e pyetjen e të dëmtuarit. Gjithashtu, ka referuar një sërë dispozitash procedurale penale për të pasqyruar detyrimet e saj si prokurore në kryerjen e hetimeve të plota, sigurimin e provave të cilat më pas konkludojnë në regjistrimin e emrit të personit të dyshuar si autor i veprës penale dhe me pas në avancimin procedural, që ka lidhje me njoftimin e akuzës.

Subjekti ka parashtruar në mënyrë të detajuar arsyet se përse procedimi penal është pushuar, pasi gjatë kohës që nuk kanë përfunduar hetimet, pasi pritej përgjigjja e shoqërisë celulare “****”, kërkuar me shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2013, si dhe kryerjen e kërkimeve për gjetjen e shtetasit A. S., është miratuar ligji nr. 22, datë 10.4.2014, “Për amnistinë” ligj, i cili nuk e lejonte hetimin e mëtejshëm të këtij procedimi penal pasi e amnistonte ndjekjen penale.

Informacioni i kërkuar shoqërisë celulare daton që në shtator të vitit 2013, ndërkohë që ligji nr. 22/2014 është miratuar në prill dhe znj. Enkeleda Osmani (Xhengo) si prokurore nuk kishte kurrësi mundësi të dinte se përgjigjja e shoqërisë deri në këtë datë nuk do të sillej dhe do të çonte në pushimin e këtij procedimi penal.

Konstatimet e Komisionit, për faktin se prej subjektit nuk janë kryer veprime hetimore për një periudhë prej 10-muajsh, nuk qëndrojnë pasi ka orientuar në kryerjen e hetimeve dhe me veprime të tjera hetimore, të cilat i ka cituar edhe më sipër (gjithsej 12 veprime hetimore) dhe në asnjë moment nuk e ka favorizuar shtetasin E.V., por përkundrazi ka verifikuar çdo pretendim të ngritur prej tij.

3. Për sa i përket dokumentit ligjor procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 1.9.2016, me të pandehur z. V. Sh., i akuzuar për veprën penale “drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, dërguar për gjykim të drejtpërdrejtë në datën 2.9.2016 (cituar si dosja nr. 4, si një ndër pesë dosjet e shortuara), ashtu sikurse ka pasqyruar KLP-ja në raportin e saj edhe Komisioni konstaton se vendimi, i cili i është njoftuar të pandehurit nuk ka të përcaktuar në akt datën e njoftimit dhe për të qartësuar këtë konstatim i është kërkuar subjektit të japë shpjegime bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

3.1 Subjekti, në prapësime, ka saktësuar se: *“... në lidhje me këtë konstatim të KLP-së dhe të Komisionit ju sqaroj se nuk është e vërtetë që nuk është shënuar data e njoftimit të ‘vendimi për njoftim akuze’ pasi në f. 33 të fashikullit hetimor ndodhet ky akt procedural, ku data e njoftimit të tij është 2.9.2016, e cila përkon me kryerjen e të gjitha veprimeve hetimore pasi çështja është dërguar me formën e gjykimit të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.”*

Subjekti ka depozituar edhe fashikullin penal nr. ***, ku në f. 33 të tij ndodhet akti procedural “vendim për njoftim akuze” i datës 2.9.2016, në dy fletë i firmosur prej saj dhe të pandehurit V. Sh. .

4. Ndërsa, në çështjet e tjera, Komisionit nuk i kanë rezultuar problematika për t’u analizuar në kuadër të përmbushjes së aftësive të kriterit profesional.

5. Komisioni konstaton se në adresë të subjektit të rivlerësimit janë depozituar 7 (shtatë) kallëzime kryesisht “për shpërdorim detyre”, për të cilët nga organi i akuzës për të gjitha rastet është vendosur “mosfillim i procedimit penal”.

Është e natyrshme që kallëzuesit (ku disa prej tyre kanë depozituar edhe denoncime për subjektin, për të cilat arsyetohet në vijim në rubrikën përkatëse) edhe më parë e kanë kallëzuar subjektin, të paktën një rast kallëzimi ndaj një të treti me arsyet dhe pretendimet e tyre për kryerje shkeljesh, për të cilën subjekti i rivlerësimit është shprehur me vendimmarrje.

✓ Në konkluzion, trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe të dokumentacionit të depozituar, konkludon se subjekti ka dhënë shpjegime bindëse lidhur me problematikat e konstatuara dhe, për pasojë, nuk evidentohen rrethana që mund të ndikojnë në aftësitë profesionale të subjektit.

➤ **Në lidhje me denoncimet⁷⁹ e depozituara në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016**

1. Denoncim⁸⁰ i shtetasit T. Q.

⁷⁹ Vërehet se disa prej denoncuesve janë cituar edhe në raportin profesional të pasqyruar në këtë vendimmarrje, të cilët kanë paraqitur kallëzime pranë organit të prokurorisë.

⁸⁰ Denoncim nr. *** prot., datë 30.5.2019, në dosjen e Komisionit.

Denoncuesi, në parashtrimet e tij, ankohet se ka depozituar kallëzim pranë organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe se kallëzimi ka kaluar në prokurorë të ndryshme, e së fundi, te subjekti i rivlerësimit në këtë rast. Në vijim të parashtrimeve të tij ankohet se nuk ka asnjë informacion mbi kallëzimin e depozituar në një kohë që pretendon se subjekti i rivlerësimit e ka thirrur për takim dhe nuk e ka pritur. Po ashtu, në denoncim bën me dije se kallëzimi ka ardhur si rezultat i kanosjes deri edhe për vrasje për qëllime pronësore nga shtetasi, ka qenë i kanosur deri për vrasje edhe nga shtetasi I. H. . Në të tilla kushte, subjektit iu kërkua të japë shpjegime dhe të depozitonte dokumentacionin përkatës.

1.1 Subjekti, në prapësimet e saj në lidhje me këtë denoncim, ka sqaruar se mbi bazën e kallëzimit të shtetasit T. Q., në datën 3.9.2018 është regjistruar procedimi penal nr*** për kundërvajtjen penale “vetëgjyqësisë”, të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Hetimet, në këtë procedim penal, nuk kanë përfunduar ende, ku ky fakt provohet me shkresën nr. *** prot., datë 3.3.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe referuar nenit 279 të Kodit të Procedurës Penale aktet hetimore janë sekrete. Subjekti ka depozituar shkresën e cituar më sipër.

✓ Në konkluzion, trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe të shkresës së depozituar, çmon argument ligjor pretendimin e saj për sa kohë çështja është në hetim e sipër.

2. Denoncime⁸¹ të shtetasit V. Ç.

Denoncuesi ka depozituar një listë ku ka renditur një numër subjektësh rivlerësimi, ku, ndër të tjerë, pasqyrohet edhe znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), por në përmbajtje të denoncimit nuk parashkruan asnjë fakt konkret apo problematikë indirekte për këtë subjekt rivlerësimi, si dhe nuk depoziton asnjë akt (vendime etj.) ku të pasqyrohen veprime të kryera prej saj.

✓ Nga shqyrtimi i parashtrimeve në denoncime, si dhe nga dokumentacioni i administruar, u vërejt se nuk rezultuan shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme apo korruptive nga subjekti i rivlerësimit.

3. Denoncim⁸² i shoqërisë “P. D.” sh.a.

Sipas këtij denoncimi, denoncuesit kërkojnë që të hetohet subjekti i rivlerësimit lidhur me aftësitë profesionale, pasurinë dhe si person që merret me korrupsion.

Komisioni i ka kërkuar informacion për disa denoncues dhe vlerësim të çështjeve KLP⁸³-së. Ndër të tjera, ky i fundit ka sqaruar lidhur me këtë denoncim se vendimi i mosfillimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit ndaj kallëzimit të bërë nga përfaqësues të kësaj shoqërie, është shfuqizuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin e saj nr. ***, datë 14.10.2016, i cili ka mbetur në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Durrës. KLP-ja ka vënë në dispozicion edhe fashikullin hetimor që i përket këtij procedimi penal.

Komisioni, nga analizimi i bërë fashikullit hetimor, ka konstatuar si vijon:

⁸¹ Denoncimet nr. *** prot., datë 11.7.2019 dhe nr. ***, datë 31.7.2019, në dosjen e Komisionit.

⁸² Denoncim nr*** prot., datë 31.1.2019 me denoncues shtetasit Sh. K. dhe N. G. .

⁸³ Referojuni shkresës “kthim-përgjigje” nr. *** prot., datë 20.6.2019, në dosjen e Komisionit.

- Nga aktet e administruara nuk figuron kallëzimi penal nr. ***, datë 16.2.2016 (i cituar pasi me këto të dhëna pasqyrohet në arsyetimin e vendimit të mosfillimit të dhënë nga subjekti në datën 15.3.2016).

- Në fashikullin hetimor është i administruar vetëm vendimi i mosfillimit të procedimit penal, i arsyetuar nga subjekti i rivlerësimit.

- Referuar arsyetimit të vendimit konstatohet se kallëzimi i shtetasve N. G. dhe Sh. K. është bërë për veprat penale “vjedhje”, “korrupsion pasiv në sektorin privat” dhe “shpërdorim detyrë”, bazuar në nenet 134, 164/b dhe 248 të Kodit Penal.

- Në fashikull janë administruar edhe tri vendime mosfillimi të procedimit penal, përkatësisht: nr. ***, viti 2013; nr. ***, viti 2013; dhe nr. ***, datë 13.01.2016, që nuk i përkasin subjektit të rivlerësimit.

- Një vendim gjyqësor i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nr. ***, datë 19.3.2015 sipas të cilit është shfuqizuar një tjetër vendimi mosfillimi (i pa administruar në këtë fashikull) që i përket kallëzimit (i pa administruar në këtë fashikull) penal nr. ***, datë 10.5.2013.

➤ Nisur nga arsyetimi i vendimit të mosfillimit të subjektit të rivlerësimit, datë 15.3.2016, është konstatuar se:

- fillimisht sqarohen pjesë nga përmbajtja e kallëzimit, pretendimet e kallëzuesve, pozicionet e tyre në këtë shoqëri etj.;
- më tej, pasqyrohet se këta shtetas kallëzojnë shtetasit I. dhe B.B.për vjedhje të shumave të lekëve të shoqërisë, pasurive të saj dhe për procedura në lidhje me ndarjen e shoqërisë “P. D.”;
- në arsyetim spikat identifikimi se në lidhje me këto raste ka edhe procese gjyqësore civile pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe se për sa i përket kallëzimeve të bëra nga këta shtetas rezulton se nga prokuroria më parë janë marrë vendime për mosfillimin e procedimit penal nr. ***, viti 2013; nr. ***, viti 2013 dhe nr. ***, datë 13.1.2016;
- subjekti arsyetohet se në këtë çështje nuk kemi të bëjmë me elementë të ndonjë vepre penale, por me një marrëdhënie juridiko – civile dhe se për zgjidhjen e saj palët duhet t’i drejtohen gjykatës.

Për sa më sipër:

- ✓ Dukej se subjekti, në këtë rast, nuk kishte përmbushur rolin dhe funksionin e saj bazuar në parashikimet ligjore të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, për të mbledhur provat dhe ndërmarrë logjikisht hetimin.
- ✓ Dukej se subjekti përzierte çështjen penale me atë civile, kur nëpërmjet vendimit, orienton palët se çfarë duhet të bëjnë, ndërsa nuk pasqyron ndonjë proces civil konkret, si dhe nuk rezulton të ketë administruar asnjë padi apo akt tjetër të procesit/eve civil që janë zhvilluar apo janë në gjykim e sipër.
- ✓ Dukej se në vendimmarrje ishte ndikuar nga të tjerë vendimi i mosfillimit (sikurse i ka cituar), të cilët janë të administruar në fashikullin hetimor, por që nuk trajtojnë të njëjtën vepër penale dhe, për më tepër, në to rezultonin të jenë akuzuar të tjerë persona dhe, për pasojë, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

➤ Në lidhje me vijimësinë e vendimit të mosfillimit datë 15.3.2016, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit

- Vendimi i mosfillimit të procedimit penal për kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2016, i dhënë nga subjekti i rivlerësimit është ankimuar nga përfaqësuesit e kësaj shoqërie (denoncuesit).
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin e saj nr. ***, datë 14.10.2016 ka shfuqizuar këtë vendim.
- Në analizë të arsytimit të bërë nga gjykata, ndër të tjera, citohet se prokuroria:
 - ka zhvilluar një hetim të mangët;
 - ka vepruar në kundërshtim me pikën 1, të nenit 151, të Kodit të Procedurës Penale dhe nenin 152 të këtij Kodi, duke anashkaluar dokumentacionin shkresor të paraqitur nga pala kallëzuese nëpërmjet të cilave pretendojnë se janë kryer veprat penale;
 - përpara se të konkludonte me mosfillimin e çështjes duhej të bënte verifikime për të sqaruar nëse qëndrojnë pretendimet e paraqitura në kallëzim, lidhur me veprimet e paligjshme të ngritura ndaj shtetasve B.;
 - duhej të merrte deklaramet e personave të kallëzuar për mënyrën se si janë tërhequr shumata e të hollave nga llogaria e shoqërisë.

- Vendimi, i sipërcituar i gjykatës, i ankimuar nga subjekti i rivlerësimit, ka mbetur në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 10.11.2017.

Në referim, për sa më sipër, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe mbi ecurinë e procesit pas kthimit për vijimin e hetimeve të këtij procedimi penal.

3.1 Subjekti, në prapësimet e saj, ndër të tjera, ka parashtruar se: *“... për sa i përket faktit të përmendur në raport prej Komisionit se unë kam marrë vendim mosfillimi në datën 15.3.2016 sqaroj se unë nuk kam hetuar asnjë material verifikues apo procedim penal për shoqërinë ‘P. D.’ sh.a., shtetasit N. G. apo Sh.K., fakt që provohet nga shkresa nr. ***prot., datë 3.3.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe në këto kushte shkeljet e evidentuara prej Komisionit nuk qëndrojnë, pasi unë nuk kam hetuar asnjë material hetimor në këtë periudhë kohe dhe të kem marrë vendim në datën 15.3.2016.”* Subjekti ka qartësuar se i vetmi procedim që ka hetuar për një periudhë kohe, pasi është zëvendësuar më pas, është procedimi penal nr. ***, i cili është bashkuar me procedimin penal nr***. Subjekti ka depozituar të gjithë dokumentacionin përkatës mbi të cilin ka parashtruar shpjegimet e saj.

✓ Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të depozituar, ka riverifikuar trajtimin e çështjes, si dhe dokumentacionin e administruar në raport me atë të depozituar nga subjekti dhe, në përfundim, konkludon se qëndron pretendimi i subjektit se nuk ka qenë prokuror i çështjes objekt denoncimi, por thjesht dhe vetëm ka përfaqësuar organin e akuzës në procesin gjyqësor të vijuar.

4. Denoncim⁸⁴ i shtetasit F.Ç.

Ankimi i denoncuesit, sikurse në këtë denoncim, është edhe pjesë e analizës së KLP-së në raportin e saj të cituar në pikën 1.4, më sipër, konkretisht në rubrikën “Të dhëna nga burime arkivore”. Denoncuesi, në tërësi, ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit parapraakisht për çështjen penale që ka ndjekur lidhur me kallëzimin e bërë ndaj denoncuesit, gjyqtarja V. H., me akuzën “fyerje e gjyqtarit”, parashikuar nga neni 318 i Kodit Penal dhe, po ashtu, edhe lidhur me kallëzimin që më tej ka bërë ndaj subjektit të rivlerësimit, për të cilën ka depozituar edhe kallëzimin përkatës nën akuzën “korrupsion pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, etj.

- nga verifikimi i akteve të administruara në fashikullin e prokurorit, që i përket kallëzimit nr. ***, ndër të tjera, konstatohet edhe urdhri i regjistrimit të procedimit penal nr. ***, nga subjekti i rivlerësimit;
- në datën 16.10.2018 subjekti i rivlerësimit, me cilësinë e prokurores, i ka njoftuar denoncuesit akuzën duke e marrë si të pandehur, nga ku rezulton se ka nënshkruar dhe nuk ka dhënë shpjegime kur është pyetur, pasi ka cituar se nuk ka marrë avokat. (referojuni procesverbalit datë 19.10.2018);
- në datën 9.11.2018, subjekti i rivlerësimit ka hartuar aktin “njoftim të përfundimit të hetimeve”;
- po në datën 9.11.2018, subjekti i rivlerësimit e ka ftuar të pandehurin për paraqitje në organin e prokurorisë në datën 16.11.2018 (pas urdhrimit për paraqitje të OPGJ me iniciale K. GJ., datë 1.11.2018);
- në datën 16.11.2018 (pasi ishte njoftuar përfundimi i hetimeve), subjekti është rimarrë në pyetje, fakt i cili nuk pasqyrohet në arsyetimin e kërkesës (datë 26.11.2018) për gjykimin e çështjes penale drejtuar gjyqësorit;
- në datën 26.11.2018, subjekti i rivlerësimit ka dërguar për gjykim çështjen penale nr. *** dhe, njëkohësisht, në të njëjtën datë ka njoftuar edhe denoncuesin;
- denoncuesi pretendon se ka dërguar brenda afatit 10-ditor një memo (nga data 16.11.2018 kur dhe citon se janë përfunduar hetimet dhe se sipas procedurave i është lënë afat 10 ditë për të paraqitur me shkrim pasi nuk kishte mundësi të parashtronte në deklaratime) në adresë të organit të prokurorisë, ku ka kërkuar edhe të tjera hetime shtesë.

Për sa më sipër, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime, nisur edhe nga parashikimet e bëra në nenin 327/ 2,3,4,6/b të Kodit të Procedurës Penale.

4.1 Subjekti, në prapësimet e saj, ndër të tjera, ka parashtruar rrethanat dhe faktet mbi këtë çështje të denoncuar, sikurse janë cituar edhe nga Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ. Subjekti ka sqaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e denoncuesit, pasi i janë dhënë të gjitha të drejtat i është rimarrë deklarimi si i pandehur në prani të av. Sh.H., të zgjedhur prej tij personalisht dhe nga Oficeri i Policisë Gjyqësore është firmosur më pas procesverbali i përfundimit të hetimeve. Gjithashtu, janë bërë njoftimet përkatëse duke përfshirë edhe njoftimin e akuzës dhe pyetjen e të pandehurit që është pikërisht njoftimi i vendimit të

⁸⁴ Denoncim nr. *** prot., datë 11.12.2018, në dosjen e Komisionit.

përfundimit të hetimeve, akt i cili i është komunikuar të pandehurit pasi është ripyetur si i pandehur në prani të mbrojtësit të tij, ku dhe kanë firmosur të dy. Fakti që të dyja këto akte janë përpiluar brenda të njëjtës datë, ripyetja si i pandehur dhe më pas njoftimi i përfundimit të hetimeve i është komunikuar në të njëjtën datë, nuk do të thotë që janë kryer veprimet hetimore ashtu sikurse pretendon denoncuesi.

Për sa i përket pretendimit në lidhje me memon e dërguar, subjekti ka sqaruar se referuar faktit se në aktin e njoftimit të përfundimit të hetimeve prej të pandehurit dhe mbrojtësit është kërkuar ballafaqimi me viktimën e veprës penale, si dhe shpallja e moskompetencës tokësore të këtij procedimi penal, pavarësisht, se nuk është paraqitur në formën e kërkuar prej saj me vendimin e datës 20.11.2018 është vendosur mospranimi i këtyre dy kërkesave referuar nenit 110/2 të Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu, çështja është dërguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës për t'u dërguar për gjykim në një tjetër trupë gjyqësore prej gjyqtarit hetues në datën 26.11.2018, referuar shkresës me nr. *** prot., të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës.

Subjekti ka sqaruar edhe lidhur me veprimet e kryera pas, në përputhje me ndryshime e bëra në Kodin e Procedurës Penale dhe më në detaje ka parashtruar lidhur me veprimet e ndërmarra prej saj në zhvillimin e seancës gjyqësore.

Gjithashtu, ka qartësuar se pretendimi i denoncuesit nuk qëndron pasi është rrëzuar prej gjyqtarit të seancës paraprake dhe, për këtë, ka depozituar me cilësinë e provës edhe vendimin nr. ***, datë 21.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Subjekti ka depozituar disa vendime gjyqësore të dhëna ndaj denoncuesit, mbi kërkesat e tij për përjashtim gjyqtari, si dhe kopje të fashikullit hetimor.

- ✓ Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve dhe të dokumentacionit të depozituar, konkludon se subjekti ka dhënë shpjegime bindëse bazuar në prova dhe ligj dhe, në këtë kontekst, nuk evidentohen rrethana që mund të ndikojnë në aftësitë profesionale të subjektit.

5. Denoncim⁸⁵ i shtetasit E. M.

Denoncuesi ankohet ndaj disa subjekteve të rivlerësimit duke cituar edhe subjektin e rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo) për paaftësi, por nuk jep raste konkrete të evidentuara apo dokumentacion mbështetës për të provuar pretendimet e tij.

- ✓ Në të tilla kushte, trupi gjykues vëren se nuk ka *indicie* që mund të ndikojnë në aftësitë profesionale të subjektit.

6. Denoncim⁸⁶ i shtetasit F. D..

Denoncuesi, në ankimin e tij, ankohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë hetim mbi akuzat e kallëzuara prej tij në adresë të shtetases Z. S., me detyrë gjyqtare e Gjykatës së Apelit Tiranë, për veprën penale “shpërdorim detyre” etj.

Nga aktet e depozituara rezulton se subjekti i rivlerësimit në datën 17.1.2018 ka vendosur “mosfillim të procedimit penal nr. ***” (mbi bazë të kallëzimit të shtetasit F. D.).

⁸⁵ Nr. ***prot., datë 8.2.2018, në dosjen e Komisionit.

⁸⁶ Nr. *** prot., datë 27.2.2018, në dosjen e Komisionit.

Vendimi është ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, nga ku ka rezultuar se është lënë në fuqi vendimi i mosfillimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit.

Aktualisht, denoncuesi ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit gjyqësor.

✓ Në të tilla kushte, trupi gjykues vëren se deri aktualisht nuk ka *indicie* që mund të ndikojnë në aftësitë profesionale të subjektit.

7. Denoncime⁸⁷ të shtetasit S. H.

Sikurse konstatohet edhe në të dhënat e burimeve arkivore është pasqyruar kallëzimi penal nr. *** i vitit 2018 të këtij denoncuesi ndaj subjektit të rivlerësimit, ku ndër të tjera, është cituar se:

Nga kallëzimi rezulton se shtetasi S. H. ka bërë kallëzim penal kundrejt shtetases Enkeleda Osmani (Xhengo), me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Ky kallëzim penal është bërë për veprat penale “shpërdorim detyre” e parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal që lidhet me një vendimmarrje arbitrare nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me kallëzimin e bërë nga shtetasi S.H. .

Denoncuesi ankohet nën pretendimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka dashur qëllimisht të hetojë edhe më konkretisht, megjithëse ankohet ndaj disa subjekteve të rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, citon edhe ankimin e tij nga vendimi i mosfillimit të procedimit penal nr. ***, datë 21.9.2017. Nga aktet e depozituara rezulton se nuk është administruar ky vendim dhe, njëkohësisht, nuk jepet informacion në lidhje me ushtrimin e të drejtës ankimore të denoncuesit ndaj këtij vendimi. Për sa më sipër, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime duke saktësuar edhe mbi ecurinë e këtij procesi deri aktualisht.

7.1 Subjekti, në prapësimet e saj, në lidhje me këtë denoncim ka sqaruar se me vendimin e datës 20.9.2017 është vendosur mosfillimi i materialit hetimor, i regjistruar mbi bazën e kallëzimit të shtetasit S. H. ndaj Prokurorit A. C., për veprën penale ‘shpërdorim detyre’, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ky vendim i është njoftuar me shkresën nr. *** prot., datë 21.9.2017 dhe prej tij nuk është ushtruar ankim ndaj vendimit të mosfillimit, referuar edhe shkresës me nr. ***prot., datë 3.3.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Subjekti ka depozituar dosjen e mosfillimit nr. ***dhe shkresën nr. *** prot., datë 3.3.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

✓ Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, nga verifikimi i dokumenteve të depozituara, si dhe nisur nga fakti i mosushtrimit të ankimit nga denoncuesi ndaj vendimmarrjes, nuk konstaton ndonjë problematikë ligjore që mund të ndikojë në aftësitë profesionale të subjektit.

8. Denoncim⁸⁸ i shtetasit A. L. dhe i shtetasit A.⁸⁹ L. .

Në lidhje me këta denoncues, nisur nga pretendimet dhe aktet e depozituara, nga shqyrtimi i tyre, sikurse është shprehur edhe KLP-ja në opinionin e dërguar, Komisioni nuk ka konstatuar problematika.

⁸⁷ Denoncime nr. *** prot., datë 12.4.2018 dhe nr. *** prot., datë 10.4.2018, në dosjen e Komisionit.

⁸⁸ Denoncim nr.***prot., datë 5.2.2019, në dosjen e Komisionit.

⁸⁹ Denoncim nr. ***prot., datë 13.5.2019, në dosjen e Komisionit.

9. Denoncim⁹⁰ i shtetasit B. M.

Denoncuesi ankohet për moskryerje të veprimeve hetimore pothuajse prej një viti nga subjekti i rivlerësimit, ndaj shtetasve Xh. M. dhe E. H., duke e lidhur këtë edhe me dëmin që i shkaktohet shoqërisë “H.” sh.p.k., ku denoncuesi pasqyron se është administrator i kësaj të fundit. Denoncuesi nuk ka depozituar dokumentacion. Për sa më sipër, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime duke saktësuar edhe mbi ecurinë e këtij procesi deri aktualisht.

9.1 Subjekti, në prapësimet e saj, ndër të tjera, ka parashtruar se mbi bazën e kallëzimit të këtij shtetasi, në datën 3.9.2018 është regjistruar procedimi penal nr. *** për veprën penale ‘mashttrim në pasoja të rënda’, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Ky procedim penal është akoma në hetim, pasi nuk kanë përfunduar të gjitha veprimet hetimore, ku ky fakt provohet nga shkresa me nr. *** prot., datë 3.3.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe, referuar nenit 279 të Kodit të Procedurës Penale, aktet hetimore janë sekrete.

- ✓ Në konkluzion, trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe shkresës së depozituar, çmon argument ligjor pretendimin e saj për sa kohë çështja është në hetim e sipër.

10. Denoncim⁹¹ i shtetasit S.T.

Denoncuesi, në parashtrimet e tij, ankohet se subjekti i rivlerësimit me pa të drejtë ka përfshirë edhe shtetasen E.H. sikur të ishte në proces gjyqësor me familjen T. dhe T. për çështje pronësore, ndërsa denoncuesi pretendon se një fakt i tillë nuk ekziston. Denoncuesi citon dy kallëzime kundër shtetasës E. H., përkatësisht në datat 21.5.2019 dhe 29.5.2019 duke cituar, ndër të tjera se: *“prokurorja Enkeleda Xhengo ka mashtruar, se kallëzuesi S. T. nuk ka lajmëruar gjykatën ...”*. Denoncuesi ka pasqyruar edhe kallëzimin penal nr***, datë 27.5.2019 të pushuar; ka cituar mosfillimin e procedimit penal nr. ***, datë 31.5.2019, të kundërvajtjes penale “kanosje” se fakti nuk përbën vepër penale. Për sa më sipër, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime duke përcaktuar se në çfarë faze janë aktualisht kallëzimi/et me parashtrimet e pretenduara.

10.1 Subjekti, në prapësimet e saj, ndër të tjera, ka parashtruar se në datën 27.5.2019, prej saj është vendosur mosfillimi i materialit kallëzues me nr. ***, material që është regjistruar mbi bazën e kallëzimit të shtetasit S.T. ndaj shtetasës E. H. për kundërvajtjen penale “kanosje”, të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, për shkak se fakti nuk përbënte vepër penale.

Subjekti shprehet se: *“Ky vendim ju është komunikuar me shkresën nr.*** prot., datë 31.5.2019 dhe ndaj tij nuk është ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, fakt që provohet nga shkresa me nr. *** prot., datë 3.3.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.”* Subjekti ka depozituar si provë shkresën me nr. ***prot., datë 3.3.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

- ✓ Trupi gjykues në analizë të shpjegimeve të subjektit, nga verifikimi i dokumenteve të depozituara, si dhe nisur nga fakti i mosushtrimit të ankimit nga denoncuesi ndaj

⁹⁰ Denoncim nr. *** prot., datë 19.2.202, në dosjen e Komisionit.

⁹¹ Denoncim nr. *** prot., datë 19.6.2019, në dosjen e Komisionit.

vendimmarrjes, nuk konstaton problematika ligjore që mund të ndikojë në aftësitë profesionale të subjektit.

11. Denoncim⁹² i shtetasit A. M.

Denoncuesi ankohet për veprime të subjektit të rivlerësimit të kryera në abuzim me detyrën, veprime për falsifikim të një dokumenti zyrtar nga personi që ka për detyrë ta lëshojë atë, si dhe për favorizim për interesa joligjore për persona të veçantë në dëm të palëve të dëmtuara. Në tërësi kërkon të vlerësohet për aftësitë profesionale pasi pretendon mbi to për veprimet e kryera në tri rastet e paraqitura më poshtë.

Denoncuesi ka sqaruar se ka paraqitur tri procese të ndara me cilësinë e një qytetari për të cilat pretendon dhe kërkon t'i bëjë prezent se nga subjekti është abuzuar me detyrën në dëm të palëve të dëmtuara me qëllim të përfitimeve personale duke favorizuar shkelës të ligjit.

Në çështjen e parë (që i përket kallëzimit nr***të organit të prokurorisë nga subjekti i rivlerësimit për të cilin është proceduar deri në kërkesën për gjykim në organin gjyqësor, ku ndër të tjerë, është renditur edhe denoncuesi) denoncuesi trajton kallëzimin e KLSH-së drejtuar organit të prokurorisë, ku subjekti ushtron funksionin, për shkak të disa shkeljeve të konstatuara, më konkretisht për lidhje të kontratave të sponsorizimeve të të tretëve nga Autoriteti Portual Durrës, në kundërshtim me ligjin dhe, më tej, rendit shkelje të natyrës procedurale të kryera nga subjekti, si p.sh. zëvendësimin e të akuzuarve konkret të renditur nga KLSH-ja, për shkeljet e kryera, pa vendimin përkatës, pra, pa një vendim mosfillimi apo pushimi të procedimit penal, moskryerjen e njoftimit kallëzuesit që, në këtë rast, është KLSH-ja me qëllim shmangien e të drejtës për të ushtruar kjo e fundit ankim etj.

Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit ka dërguar kërkesën për gjykim në datën 26.4.2019, ku, ndër të tjerë, ka dërguar në cilësinë e të pandehurit edhe denoncuesin nën akuzën e shpërdorimit të detyrës.

Çështja e dytë, për të cilën ankohet denoncuesi, i përket kallëzimit penal nr. ***, të vitit 2016 me objekt “kanosje” dhe “përdorim me keqdashje të thirrjeve telefonike” dhe “fyerje” të parashikuar nga nenet 84, 119 dhe 275 të Kodit Penal, për të cilin denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka vendosur me pa të drejtë “mosfillim i këtij procedimi penal”, pa bërë verifikimin telefonik dhe përmbajtjen e mesazheve të tyre për më tepër edhe pa kryer verifikime nëse ishin në kushtet e kanosjes. Denoncuesi ka pretenduar se subjekti nuk ka arsyetuar drejtë, ndërsa ka cituar se kanosja do të provohej nëse krahas fjalëve kërcënuese do të ishin përdorur edhe sende, të cilat krijojnë bindjen e vërtetë se jeta e kallëzuesit apo familjarëve të tij ishte në rrezik. Në vijim, denoncuesi qartëson se çështja pasi është pushuar nga subjekti i rivlerësimit, për shkak të mosankimit të bërë nga kallëzuesi, ky i fundit ka ribërë kallëzimin⁹³ e tij dhe një tjetër prokurore ka dërguar çështjen për gjykim, nga ku gjykata ka vendosur dënimin e të akuzuarës. Nën këtë argument, denoncuesi pretendon se janë mbajtur dy qëndrime të ndryshme për të njëjtën çështje penale.

Në lidhje me çështjen e tretë denoncuesi pretendon për vendim të padrejtë (pushimin e procedimit penal) të dhënë nga subjekti i rivlerësimit mbi kallëzimin e shtetas L.Sh. duke

⁹² Denoncim nr***prot., datë 1.7.2019, në dosjen e Komisionit.

⁹³ Kallëzim nr. ***.

argumentuar se ky vendim është prishur nga Gjykata e Apelit Durrës dhe është kthyer për hetime të mëtejshme. Ndërsa pretendon se nga subjekti i rivlerësimit është thirrur për të kryer aktekspertim një ekspert i kallëzuar, pikërisht, nga shtetasi Z. S., i cili është në konflikt me shtetasen L.Sh..

Denoncuesi ka depozituar raportin e auditimit të KLSH-së për Autoritetin Portual Durrës; kërkesën datë 8.4.2019 drejtuar APD-së për pajisje me dokumentacion dhe kthim-përgjigje e këtij autoriteti; si dhe kërkesën e shoqatës shqiptare të grave të diplomuara universitare, datë 13.10.2014 etj.

Për sa më sipër, dukej se nuk ishin kryer hetime të plota në lidhje me çështjen e dytë të prezantuar nga denoncuesi për shkak se nga ribërja e ankimit ndaj vendimit të subjektit, një tjetër subjekt rivlerësimi kishte dërguar çështjen për gjykim dhe se në këtë gjykim e akuzuara ishte dënuar. Po ashtu, dukej se nuk ishin kryer hetime të plota edhe në çështjen e tretë të denoncuar dhe për këto arsye, subjektit iu kërkua të japë shpjegime.

11.1 Subjekti, në prapësimet e saj, ndër të tjera, ka parashtruar se në datën 26.5.2016, prej saj ishte vendosur mosfillimi i materialit kallëzues, pasi nuk rezultonte e konsumuar kundërvajtja penale “kanosje” e parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, për shkak se krahas fjalëve kërcënuese nuk ishin përdorur edhe sende, të cilat të krijojnë bindjen e vërtetë se jeta e S. apo e familjarëve të tij ishte në rrezik. Në rastin konkret, S. ka deklaruar se përveç fjalëve kërcënuese e fyese në telefon, në asnjë moment nuk ka parë që G. të kishte pasur në dorë ndonjë send apo mjet që të krijonte bindjen se jeta e tij apo e familjarëve të tij ishte në rrezik.

Edhe për sa i përket kundërvajtjes penale “përdorim me keqdashje të thirrjeve telefonike” e parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal ka rezultuar se arsyeja për të cilën G. i ka bërë telefonata në numrin e telefonit celular S. nuk ka qenë që t’i prishë atij qetësinë, por pagimi i shumës së të hollave që ai i kishte dhënë hua.

Subjekti ka sqaruar se ka ndjekur procedurën e njoftimit të vendimit dhe se ky vendim nuk është ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, ku ky fakt provohet me shkresën nr. *** prot., datë 3.3.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale (para ndryshimit me ligjin nr. 23/2017) nga ana e ligjvënësit është parashikuar se: Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit brenda 5 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit. Pra, nuk është e vërtetë që ky vendim është ankimuar edhe nga prokurorja tjetër është dërguar për gjykim kjo çështje penale, e regjistruar tashmë pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Subjekti ka sqaruar se në datën 27.12.2017 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës është regjistruar procedimi penal nr. *** për kundërvajtjen penale “përdorim me keqdashje i thirrjeve telefonike”, të parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal ndaj shtetasen N.H., procedim penal, i cili është hetuar nga prokurore T.Rr. .

Në datën 4.1.2018 kjo çështje është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe kjo e fundit me vendimin nr. ***, datë 12.4.2019 ka vendosur “ndryshim i kualifikimit ligjor” nga “përdorim me keqdashje i thirrjeve telefonike” në atë të “vetëgjyqësia” dhe dënimin e shtetasen N.H.me 1 muaj burgim dhe në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal pezullimin e

ekzekutimit të dënimit me burgim për 2 muaj, vendim i cili është ankimuar në Gjykatën e Apelit Durrës referuar shënimit të bërë prej kryesekretarisë së gjykatës, në faqen e parë të vendimit, pasi e pandehura ka kërkuar pafajësi, pra, ky vendim penal nuk është i formës së prerë.

Subjekti ka sqaruar se nuk kanë lidhje procedimet me njëri-tjetrin, pasi janë iniciuar mbi shkaqe dhe arsye të ndryshme, pasi vendimi i marrë nga subjekti dhe i paankimuar datonte prej vitit 2016, pra, më parë vendimit të radhës së marrë në vitin 2017.

Subjekti ka sqaruar edhe në lidhje me pretendimin se prej saj është thirrur për të kryer aktekspertim një ekspert i kallëzuar.

Subjekti ka argumentuar lidhur me të gjitha veprimet hetimore të procedimit penal nr. ***regjistruar për veprat penale “shpërdorim detyre” dhe “ndërtim i paligjshëm”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 199/a të Kodit Penal, ku në datën 22.2.2019 me shkresën nr. ***prot., datë 5.3.2019, kjo çështje penale është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, çështje e cila vazhdon ende gjykimin dhe seanca e ardhshme gjyqësore është caktuar në datën 21.4.2020, ora 10:00, pasi nga gjyqtari i seancës paraprake në aplikim të nenit 332/ç, të Kodit të Procedurës Penale është vendosur plotësimi i hetimeve.

Subjekti ka kundërshtuar se kjo çështje penale është pushuar prej saj dhe pas prishjes së saj nga Gjykata e Apelit Durrës e ka regjistruar, por ka shpjeguar se është gjyqtari i seancës paraprake ai që ka urdhëruar kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore duke mos e dërguar çështjen për gjykim në një tjetër trup gjyqësor.

Me vendimin e datës 24.10.2018 është vendosur kryerja e aktit të riekspertimit teknik ndërtimi, ku nga eksperti me aktin e datës 1.11.2018 është kryer akti i riekspertimit prej ekspertit A.L., kohë në të cilën ndaj këtij eksperti në dijeninë time (është shprehur subjekti) nuk ka pasur asnjë procedim penal.

Subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 3.3.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, si dhe dokumentacionin referues mbi shpjegimet e dhëna.

- ✓ Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të detajuara të subjektit dhe të dokumentacionit të administruar, vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime bindëse, në përputhje me provat dhe ligjin e aplikueshëm, të cilat nuk mbështesin pretendimet e denoncuesit.

VLERËSIM TËRËSOR I ÇËSHTJES

Trupi gjykues, referuar Aneksit të Kushtetutës, nenit 51, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriteret e rivlerësimit, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, në provat e administruara, në shpjegimet e subjektit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo):

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, çmon se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e saj nuk ka cënuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, pas propozimit të relatores, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë” duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikave 1 dhe 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin e subjektit të rivlerësimi, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 20.7.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Suela ZHEGU
Anëtare

MENDIM PARALEL

1. Unë, komisionere Suela Zhegu, po parashtoj sa më poshtë argumentet e një arsytimi paralel lidhur me vendimin nr. 275, datë 20.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj subjektit të rivlerësimit, Znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), me detyrë prokurore në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës.

2. Fillimisht, theksoj faktin se kam votuar për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Znj. Enkeleda Osmani (Xhengo).

3. Kam ndarë mendim të ndryshëm me shumicën e trupit gjykues, në lidhje me të ardhurat neto të bashkeshortit për punësimin pranë shoqërisë "P.", si dhe për punësimet pranë shoqërive private për të cilat subjekti ka ngritur padi civile, si qëndrim ky i mbajtur edhe në vendime të mëparshme.

4. Referuar pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, "Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj".

5. Referuar pikës 20, të Udhëzimit të ILDKPKI nr. 4095, datë 10.10.2016 në zbatim të nenit D të aneksit të Kushtetutës së republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr.84/2016, ku parashikohet se: "deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga pagat të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor për të ardhurat neto nga institucioni pranë të cilit kanë qenë dhe janë punësuar subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë.

6. Konkretisht, në lidhje me punësimin pranë "P.A." sh.p.k., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se, bashkëshorti për vitet 2002 – 2008, ka përfutuar nga shoqëria të ardhura në shumën 5,840,000 lekë. Për të provuar mardhenien e punësimit dhe të ardhurat mujore nga ky punësim subjekti ka depozituar një Vërtetim të nënshkruar dhe vulosur nga ish administratori i shoqërisë z. A.N. ku ndër të tjera thuhet se ... "*Z. K. O., ka punuar pranë shoqërisë sonë, me profesion inxhinier ndërtimi, nga periudha korrik 2002 deri në gusht 2008 dhe se është angazhuar me kohë të plotë me detyra të ndryshme ...me pagë mujore 80 000 lekë*".

7. Nga ana e Subjektit pretendohet për një marrëdhënie pune relativisht e gjatë në kohë mes palëve punëdhënës e punëmarrës, dhe nuk është depozituar asnjë marrëdhënie kontraktuale punësimi me shkrim, sipas parashikimeve të neneve 12, 21 (kryesisht pika 4), etj., të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.

8. Nga hetimi i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, por edhe pas lënies së barrës së provës, nuk u provua që bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit:

i. të kishte përfutuar rregullisht pagesa neto mujore për gjithë periudhën e punësimit, të marra nëpërmjet sistemit bankar, apo me një nga mënyrat e parashikuara në nenin 118 të Kodit të Punës.

ii. të ishin paguar sig/shoq dhe detyrimet tatimore për të gjithë periudhën e punësimit në këtë kompani.

9. Sipas të dhënave të marra nga ISSH, punëdhënësi ka rezultuar se ka paguar detyrime tatimore për punëmarrësin, gjatë viteve 2003 - 2007 (me shkëputje) për paga bruto që variojnë nga 9.403

lekë deri në 48.611 lekë, shuma të cilat nuk përputhen me pagën mujore të deklaruar sipas vërtetimit të shoqërisë, prej 80.000 lekë/muaj.

10. Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se bashkëshortit të subjektit ka raste që nuk i figuron emri në listëpagesat e shoqërisë “P.A.” sh.p.k., dhe nuk janë paguar kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për gjithë periudhën e punësimit të deklaruar pranë kësaj shoqërie.

11. Ish administratori i shoqërisë “P. A.” sh.p.k. (i pyetur në cilësinë e dëshmitarit) ka deklaruar se pagesat e detyrimit tatimor për b/shortin e subjektit janë bërë në statusin e një individi të thjeshtë dhe jo në emrin e shoqërisë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar, sipas formularit DIVA, rezulton se këto pagesa janë bërë vetëm për tatimin mbi të ardhurat dhe jo për të gjithë llojet e detyrimit tatimor (ku përfshihen detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore), për të ardhurat nga punësimi, siç parashikon legjislacioni tatimor. Pagesa e kryer për tatimin mbi të ardhurat për vitet 2006, 2007 dhe 2008 dhe jo për të gjitha vitet e punësimit, është kryer për sistemimin e balancave negative të rezultateve të hetimit.

12. Për një vlerësim sa të saktë e të drejtë për pozitën financiare të subjektit, gjykoj se mungesa e provave sa më sipër cituam, ka sjellë pamundësinë për t’i konsideruar të ardhura të ligjshme. Të ardhura të ligjshme në kuptim të ligjit, do të konsiderohen vetëm të ardhurat për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, pra ato të konfirmuara nga ISSH.

13. Pavarësisht efektit negativ që mbartin këto të ardhura të bashkëshortit të subjektit në analizën financiare për periudhën 2002-2008, konkludoj se në vlerësim tërësor të çështjes, janë të pamjaftueshëm për ta shkarkuar subjektin, për këtë arsye kam votuar për konfirmimin në detyrë të subjektit.

Anëtare e trupit gjykues

Suela Zhegu

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta